

UDHËZUES STUDIMOR PËR PJESËMARRËSIT NË KURSIN

PËR MARRËDHËNIET MARTESORE DHE FAMILJARE



UDHËZUES STUDIMOR PËR PJESËMARRËSIT NË KURSIN

PËR MARRËDHËNIET
MARTESORE DHE FAMILJARE

Botuar nga
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Salt Lake City, Utah

Komente dhe Sugjerime

Komentet dhe sugjerimet tuaja rreth këtij udhëzuesi studimor do të vlerësohen së tepërmi. Ju lutemi dërgojini këto sugjerime në adresën:

Curriculum Planning
50 East North Temple Street, Floor 24
Salt Lake City, UT 84150-3200
USA

E-mail: cur-development@ldschurch.org

Ju lutemi shkruani emrin, adresën, lagjen dhe kunjin tuaj. Mos harroni të shkruani titullin e udhëzuesit studimor. Më pas ofroni komentet dhe sugjerimet tuaja rreth pikave të forta të udhëzuesit studimor dhe drejtimet në të cilat ai mund të përmirësohet.

© 2000, 2006 by Intellectual Reserve, Inc.

Të gjitha të drejtat rezervohen.

Printed in Germany

Aprovimi në gjuhën angleze: 8/97

Aprovimi për përkthim: 8/97.

Përkthim i *Marriage and Family Relations: Participant's Study Guide*

Albanian

PËRMBAJTJA

“Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”	iv
Hyrja	v
Rishikimi i Kursit për Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare	vii

PJESA A: FORCIMI I MARTESËS

1. “Familja është qendrore në planin e Atit Qiellor”	3
2. Zhvillimi i Unitetit në Martesë	8
3. Kultivimi i Dashurisë dhe Miqësisë në Martesë	12
4. Përgjigjia ndaj Sfidave në Martesë	16
5. Përgjigjia ndaj Sfidave me anë të Komunikimit Pozitiv	18
6. Forcimi i Martesës nëpërmjet Besimit dhe Lutjes	21
7. Fuqia Shëruese e Faljes	25
8. Administrimi i Financave të Familjes	28

PJESA B: PËRGJEGJËSITË E PRINDËRVE PËR TË FORCUAR FAMILJEN

9. “[Fëmijët] Janë një Trashëgimi që Vjen nga Zoti”	35
10. Rolet e Shenjta të Etërve dhe Nënave (Pjesa 1: Rolet e Etërve)	40
11. Rolet e Shenjta të Etërve dhe Nënave (Pjesa 2: Rolet e Nënave)	44
12. T’i Mësojmë Fëmijët nëpërmjet Shembullit dhe Udhëzimit	49
13. T’u Mësojmë Fëmijëve Parimet e Ungjillit (Pjesa 1)	55
14. T’u Mësojmë Fëmijëve Parimet e Ungjillit (Pjesa 2)	60
15. T’i Udhëheqim Fëmijët në Marrjen e Vendimeve	66
16. Lutja Familjare, Studimi Familjar i Shkrimeve të Shenjta dhe Mbrëmja Familjare	70

FAMILJA

NJË PROKLAMATË DREJTUAR BOTËS

PRESIDENCIA E PARË DHE KËSHILLI I TË DYMBËDHJETË APOSTUJVE
TË KISHËS SË Jezu KRISHTIT TË SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME

NE, PRESIDENCIA E PARË DHE KËSHILLI i të Dymbëdhjetë Apostujve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, solemnisht shpallim se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përvetshëm të fëmijëve të Tij.

TË GJITHA QENIET NJERËZORE, meshkuj dhe femra, janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. Gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme.

NË MBRETËRINË PARATOKËSORE, bijtë dhe bijat shpirtërore e njihnin dhe e adhuronin Perëndinë si Atin e tyre të Amshuar dhe e pranuan planin e Tij, me anë të të cilit fëmijët e Tij mund të merrnin një trup fizik, mund të fitonin përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe së fundi, mund të arrinin destinacionin e tij ose të saj si një trashëgimtar i jetës së përjetshme. Plani hyjnor i lumturisë bën të mundur që marrëdhëniet familjare të vazhdojnë përtej varrit. Ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që janë në dispozicion në tempujt e shenjtë, bëjnë të mundur që individët të kthehen në praninë e Perëndisë dhe që familjet të bashkohen përjetësisht.

URDHËRIMI I PARË QË PERËNDIA i dha Adamit dhe Evës ishte rreth potencialit të tyre si burrë e grua për të qenë prindër. Ne deklarojmë se urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e tij që të shumohen dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm. Ne më tej deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte.

NE DEKLAROJMË se mënyra me anë të së cilës krijohet jeta e vdekshme është caktuar dhe drejtuar nga Perëndia. Ne pohojmë shenjtërinë e jetës dhe rëndësinë e saj në planin e përjetshëm të Perëndisë.

BASHKËSHORTI DHE BASHKËSHORTJA kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre. 'Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga

Zoti' (Ps. 127:3). Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore, për t'i mësuar ata ta duan dhe t'i shërbejnë njëri-tjetrit, për të zbatuar urdhërimet e Perëndisë dhe për të qenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë. Bashkëshortët dhe bashkëshortet, nënat dhe etërit, do të mbahen përgjegjës përpara Perëndisë për plotësimin e këtyre detyrimeve.

FAMILJA SHUGUROHET NGA PERËNDIA. Martesa midis burrit dhe gruas është thelbësore në planin e Tij të përjetshëm. Fëmijët kanë të drejtën të linden nga prindër brenda lidhjeve të martesës dhe të rriten nga një atë dhe një nënë të cilët i nderojnë me besnikëri të plotë besëlidhjet e martesës. Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht. Martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, faljes, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese. Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë. Paaftësia, vdekja ose rrethana të tjera mund të bëjnë të nevojshme përshtatjen ose ndryshimin e këtyre roleve. Të afërm të tjerë duhet të ndihmojnë kur është e nevojshme.

NË PARALAJMËROJMË se individët që shkelin besëlidhjet e dëlirësisë, që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët, apo që dështojnë në përmbushjen e përgjegjësive të tyre familjare, do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë. Për më tepër, ne paralajmërojmë se shpërbërja e familjes do të sjellë mbi individët, komunitetet dhe kombet fatkeqësitë e parashikuara nga profetët e lashtë dhe modernë.

NE U BËJMË thirrje qytetarëve dhe zyrtarëve të përgjegjshëm të qeverive kudo që janë të nxisin ato masa të krijuara për të ruajtur dhe forcuar familjen si njësi themelore e shoqërisë.

Kjo proklamata u lexua nga Presidenti Gordon B. Hinkli si pjesë e mesazhit të tij në Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës të mbajtur më 23 shtator 1995, në Sollt Lejk Siti, Jutah.

HYRJE

Qëllimi i Këtij Kursi

Kursi për Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare ka për qëllim të ndihmojë anëtarët e Kishës të forcojnë martesën dhe familjen e tyre dhe të gjejnë gëzim në marrëdhëniet e tyre familjare. Ai ndahet në dy pjesë. Pjesa A, “Forcimi i Martesës,” u vjen veçanërisht në ndihmë çifteve të martuar dhe anëtarëve të cilët po përgatiten për t’u martuar. Pjesa B, “Përgjegjësitë e Prindërve për të Forcuar Familjet,” i ndihmon prindërit dhe gjyshërit në përpjekjet e tyre për “t’i edukuar [fëmijët] në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Efesianëve 6:4).

Kursi bazohet mbi doktrinat dhe parimet që na mësojnë shkrimet e shenjta dhe profetët e apostujt e ditëve të mëvonshme. Ai thekson veçanërisht “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës,” e cila gjendet në faqen iv të këtij udhëzuesi studimor.

Për një përmbledhje të kursit, shikoni faqet vii–viii. Referojuni kësaj përmbledhjeje shpesh për të rishikuar doktrinat dhe parimet që keni mësuar dhe për t’u përgatitur për mësimin e ardhshëm.

Frekuentimi i Kursit Sipas Nevojave Tuaja

Ju keni mundësinë të merrni pjesë në këtë kurs sipas nevojave tuaja individuale. Për shembull, në qoftë se jeni i/e martuar, por nuk keni fëmijë, mund të zgjidhni të merrni pjesë në tetë mësimet e para, por jo në tetë mësimet e fundit. Në qoftë se jeni prind i vetëm, mund të vendosni të merrni pjesë vetëm në mësimet e pjesës B.

Pjesëmarrja në Kurs

Duke zgjedhur të merrni pjesë në këtë kurs, ju keni treguar dëshirën për të forcuar familjen tuaj. Me qëllim që të përfitoni sa më tepër nga ky kurs, ju duhet të kontribuoni në diskutimet që zhvillohen në klasë, të përdorni këtë udhëzues studimor dhe të përipiqeni të zbatoni doktrinat dhe parimet që mësoni.

Kontributi në Diskutimet e Zhvilluara në Klasë

Ndërsa ju dhe pjesëmarrësit e tjerë kontribuoni në diskutimet e zhvilluara në klasë, do të mund të ftoni ndikimin e Frymës së Shenjtë dhe do të mësoni dhe

lartësoni njëri-tjetrin. Zoti tha: “Caktoni mes jush një mësues dhe mos jini të gjithë zëdhënës në të njëjtën kohë; por njëri duhet të flasë në një kohë dhe të gjithë të dëgjojnë thëniet e tij, që kur të gjithë të kenë folur, të gjithë të jenë lartësuar prej gjithçkaje dhe që cilido të ketë një privilegj të barabartë” (DeB 88:122).

Të gjithë ata që marrin pjesë në këtë kurs mund të mësojnë nga njëri-tjetri, pavarësisht nga përvojat e tyre me martesën apo rritjen e fëmijëve. Përvoja juaj në klasë do të jetë më e vlefshme nëse ndani përvoja që lidhen me mësimet dhe dëgjoni me respekt kur të tjerët bëjnë të njëjtën gjë. Ndërsa dëshmoni për të vërtetat që diskutohen, ju mund të forconi dëshminë tuaj dhe dëshmitë e të tjerëve. Megjithatë, duhet të jeni të kujdesshëm të mos diskutoni rreth përvojave intime ose të shenjta që nuk janë të përshtatshme për t’u diskutuar në klasë. Ju gjithashtu duhet të jeni të vetëdijshëm ndaj kohës së kufizuar të zhvillimit të kësaj ore mësimi dhe të tregoheni të kujdesshëm ndaj mësuesit dhe pjesëmarrësve të tjerë.

Përdorimi i Këtij Udhëzuesi Studimor

Pas çdo mësimi, përdoreni këtë udhëzues studimor gjatë javës për të rishikuar atë që keni mësuar. Udhëzuesi studimor përmban “Ide për Zbatim,” të cilat janë sugjerime për t’iu ndihmuar të jetoni sipas doktrinave dhe parimeve që keni mësuar në çdo mësim. Çdo mësim shoqërohet gjithashtu me një ose dy artikuj nga Autoritetet e Përgjithshme të Kishës. Nëse jeni të martuar, mund të përfitoni së tepërmi nga leximi dhe diskutimi i artikujve me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

Disa nga artikujt janë dhënë fillimisht si diskutime në konferencat e përgjithshme dhe në veprimtari të tjera, ndërsa artikujt e tjerë janë shkruar për revistat e Kishës. Duke qenë se janë marrë nga botime të ndryshme, modifikime të vogla të këtyre artikujve kanë qenë të nevojshme për t’iu përshtatur formatit të këtij udhëzuesi studimor. Për shembull, nga bisedat e konferencave të përgjithshme janë hequr fjalët e hapjes dhe disa tituj e citime janë ndryshuar. Mësimet nuk u është bërë asnjë ndryshim.

Zbatimi i Doktrinave dhe Parimeve që do të Mësoni

Nuk mjafton vetëm ta mësosh ungjillin. Që ungjilli të ketë efekt në jetën tuaj, ju duhet të jetoni atë që mësoni. Presidenti Harold B. Li, Presidenti i 11-të i Kishës, këshilloi:

“Të gjitha parimet dhe ordinancat e ungjillit janë në një farë kuptimi, veçse ftesa për të mësuar ungjillin nëpërmjet praktikimit të mësimave të tij. Askush nuk e kupton parimin e së dhjetës deri sa ta paguajë të dhjetën. Askush nuk e kupton parimin e Fjalës së Urtësisë deri sa ta zbatojë Fjalën e Urtësisë. Fëmijët, ose edhe të rriturit, nuk binden për parimin e së dhjetës, Fjalës së Urtësisë, mbajtjes të shenjtë të ditës së Shabatit, ose lutjes vetëm duke dëgjuar dikë të flasë për këto parime. Ne e mësojmë ungjillin duke e jetuar atë...”

... Me të vërtetë ne asnjëherë nuk dimë asgjë rreth mësimave të ungjillit deri sa të kemi provuar bekimet që vijnë nga të jetuarit e secilit parim“ (*Stand Ye in Holy Places* [1974], 215).

Burime të Tjera

Burimet e mëposhtme të botuara nga Kisha japin informacion të mëtejshëm mbi temat e diskutuara në këtë kurs. Këto burime mund t’i gjeni në qendrat shpërndarëse të Kishës. Ju mund t’i merrni këto botime dhe t’i përdorni në shtëpinë tuaj.

- *Libri Udhëzues i Familjes* (31180). Ky udhëzues përshkruan organizimin e familjes, jep informacion rreth mësimit të ungjillit në shtëpi dhe jep një përmbledhje të procedurave për ordinancat dhe bekimet e priftërisë.
- Artikuj rreth martesës dhe familjes në revistat e Kishës.
- *Family Home Evening Resource Book* [Libri Burimor për Mbrëmjen Familjare] (31106). Ky libër i ndihmon prindërit dhe fëmijët të përgatisin mësim për mbrëmjet familjare (faqe 3–160, 173–232). Ai përmban ide për ta bërë mbrëmjen familjare të suksesshme (faqe 163–70) dhe përfshin sugjerime për t’u mësuar fëmijëve parime dhe përgjegjësi specifike (faqe 235–62). Ky libër përmban gjithashtu ide për aktivitete familjare (faqe 265–340).
- *Teaching, No Greater Call* [Mësimdhënia, s’ka Thirrje më të Madhe] (36123). Ky burim përmban

parime dhe sugjerime praktike për t’i ndihmuar anëtarët e Kishës të përmirësohen si mësues të ungjillit. Pjesa D, “Teaching in the Home” [Mësimdhënia në Shtëpi] (faqe 125–48), është veçanërisht e vlefshme për prindërit.

- *Libri Udhëzues i Mësimdhënies* (34595). Ky udhëzues ofron sugjerime për të përmirësuar mësimdhënien e ungjillit dhe mësimin e tij.
- *Për Forcën e Rinisë* (34285). Ky pamflet paraqet përmbledhtazi standardet e Kishës për takimet, veshjen dhe paraqitjen e jashtme, miqësinë, ndershmërinë, fjalorin, median, shëndetin mendor dhe fizik, muzikën dhe vallëzimin, pastërtinë seksuale, sjelljen gjatë ditës së Shabatit, pendimin, denjësinë dhe shërbimin.
- *A Parent’s Guide* [Udhëzuesi i Prindit] (31125). Kjo broshurë përmban sugjerime për t’i ndihmuar prindërit t’u mësojnë fëmijëve rreth intimitetit fizik.
- *Guidebook for Parents and Guardians of Handicapped Children* [Udhëzuesi për Prindërit dhe Kujdestarët e Fëmijëve me të Meta Fizike e Mendore] (31123). Ky udhëzues ofron këshilla për familjet me fëmijë me të meta. Ai gjithashtu përmban informacion rreth materialeve të botuara nga Kisha për t’i ndihmuar prindërit dhe të tjerët që mësojnë fëmijët me të meta.
- *Cornerstones of a Happy Home* [Gurëthemet e Një Shtëpie të Lumtur] (33108). Ky pamflet përmban një bisedë të dhënë nga Presidenti Gordon B. Hinkli, në kohën që shërbente si Këshilltar i Dytë në Presidencinë e Parë.
- *Being a Righteous Husband and Father* [Të Jeshë një Bashkëshort dhe Baba i Drejtë] (35402). Ky pamflet përmban një bisedë të dhënë nga Presidenti Hauard W. Hanter, Presidenti i 14-të i Kishës.
- *One for the Money: Guide to Family Finance* [Së Bashku për Përdorimin e Parave: Udhëzues për Financën Familjare] (33293). Ky pamflet nga Plaku Marvin J. Ashton i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve, ofron sugjerime praktike rreth administrimit të financave të familjes.

PËRMBAJTJA E KURSIT PËR MARRËDHËNIET MARTESORE DHE FAMILJARE

PJESA A: FORCIMI I MARTESËS

MËSIMI 1: “FAMILJA ËSHTË QENDRORE NË PLANIN E KRIJUESIT”

Profetët e ditëve të mëvonshme shpallin rëndësinë e përjetshme të martesës dhe familjes.

Martesa e përjetshme mund të sjell gëzim dhe beki-me të mëdha në këtë jetë dhe gjatë gjithë përjetësisë.

Kursi për Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare është hartuar për të na ndihmuar të gjejmë gëzim në marrëdhëniet tona familjare.

Shtëpitë tona mund të jenë “një copëz qielli” kur ndërtojmë “mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë”.

MËSIMI 2: ZHVILLIMI I UNITETIT NË MARTESË

Zoti i ka urdhëruar bashkëshortët e bashkëshortet të jenë një.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet ta vlerësojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të bëjnë të mundur që karakteristikat dhe aftësitë e tyre individuale të plotësojnë njëri-tjetrin.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të jenë besnikë ndaj njëri-tjetrit.

MËSIMI 3: KULTIVIMI I DASHURISË DHE MIQËSISË NË MARTESË

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të kultivojnë dashurinë për njëri-tjetrin.

Shprehjet e dashurisë dhe mirësisë e mbajnë gjallë dashurinë dhe miqësinë në një martesë.

Intimiteti i duhur në një martesë është shprehje e dashurisë.

Çiftet e martuara duhet të përpiqen të kenë dashuri hyjnore, dashurinë e pastër të Krishtit.

MËSIMI 4: PËRGJIGJIA NDAJ SFIDAVE NË MARTESË

Të gjithë çiftet e martuar ndeshen me sfida.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet mund të kapërcejnë në çdo sfidë nëse ata e shikojnë martesën si një marrëdhënie besëlidhjeje.

Kur përballemi me sfida, mund të zgjedhim t’u përgjigjemi me durim dhe dashuri dhe jo me irritim ose zemërim.

MËSIMI 5: PËRGJIGJIA NDAJ SFIDAVE ME ANË TË KOMUNIKIMIT POZITIV

Midis çdo çifti të martuar ekzistojnë ndryshime në mendime.

Bashkëshortët e bashkëshortet duhet të kërkojnë cilësitë e admirueshme tek njëri-tjetri.

Komunikimi pozitiv ndihmon në parandalimin dhe zgjidhjen e vështirësive.

MËSIMI 6: FORCIMI I MARTESËS NËPËRMJET BESIMIT DHE LUTJES

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të punojnë së bashku për të rritur besimin e tyre në Jezu Krisht.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet bekohen kur luten së bashku.

MËSIMI 7: FUQIA SHËRUESE E FALJES

Shpirti i faljes midis një bashkëshorti dhe bashkëshorteje sjell paqe dhe një ndjenjë mirëbesimi dhe sigurie.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të kërkojnë faljen e njëri-tjetrit për të metat e tyre dhe të bëjnë përpjekje të sinqerta për t’u përmirësuar.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të përpiqen ta falin njëri-tjetrin.

MËSIMI 8: ADMINISTRIMI I FINANCAVE TË FAMILJES

Administrimi i duhur i financave është thelbësor për një martesë të lumtur.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të punojnë së bashku për të ndjekur parimet bazë të administrimit të parave.

MËSIMI 9: “[FËMIJËT] JANË NJË TRASHËGIMI QË VJEN NGA ZOTI”

Ati Qiellor ua beson fëmijët e Tij shpirtërorë prindërve tokësorë.

Prindërit duhet të përpiqen të plotësojnë nevojat individuale të çdo fëmije.

Fëmijët kanë të drejtën të kenë një marrëdhënie të dashur me prindërit e tyre.

Abuzimi me fëmijët është një krim para Perëndisë.

Fëmijët sjellin gëzim të madh në jetën e prindërve të tyre.

MËSIMI 10: ROLET E SHENJTA TË ETËRVE DHE NËNAVE (PJESA 1: ROLET E ETËRVE)

Etërit dhe nënat duhet të punojnë së bashku për t'i siguruar çdo fëmije një mburojë besimi.

Etërit duhet të kryesojnë me dashuri dhe drejtësi.

Etërit duhet të sigurojnë domosdoshmëritë e jetesës dhe mbrojtjen për familjen e tyre.

MËSIMI 11: ROLET E SHENJTA TË ETËRVE DHE NËNAVE (PJESA 2: ROLET E NËNAVE)

Nënat marrin pjesë në punën e Perëndisë.

Nënat janë kryesisht përgjegjëse për rritjen e fëmijëve të tyre.

Etërit dhe nënat duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë.

MËSIMI 12: T’I MËSOJMË FËMIJËT NËPËRMJET SHEMBULLIT DHE UDHËZIMIT

Prindërit janë përgjegjës për të mësuar fëmijët e tyre.

Prindërit mund të marrin frymëzim kur i mësojnë fëmijët e tyre.

Prindërit i mësojnë fëmijët nëpërmjet shembullit dhe udhëzimit.

MËSIMI 13: T’U MËSOJMË FËMIJËVE PARIMET E UNGJILLIT (PJESA 1)

Mësimet e prindërve mund t'i ndihmojnë fëmijët të qëndrojnë të fortë në besim.

Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve parimet dhe ordinancat e para të ungjillit.

Prindërit duhet “t'i mësojnë fëmijët e tyre të lutën dhe të ecin drejt përpara Zotit.”

MËSIMI 14: T’U MËSOJMË FËMIJËVE PARIMET E UNGJILLIT (PJESA 2)

Prindërit tregojnë dashuri për fëmijët e tyre kur i mësojnë ata.

Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve dhembshurinë dhe shërbimin.

Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve ndershmërinë dhe respektin për pronën e të tjerëve.

Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve rreth shpërblyemësimit të punës së ndershme.

Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve pastërtinë morale.

MËSIMI 15: T’I UDHËHEQIM FËMIJËT NË MARRJEN E VENDIMEVE

Fëmijët kanë nevojë për udhëheqje kur marrin vendime.

Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët ta ushtrojnë në mënyrë të drejtë zgjedhjen e lirë.

Prindërit duhet t'i lejojnë fëmijët të mësojnë nga pasojat e vendimeve të tyre të pamatura.

Prindërit duhet të tregojnë dashuri të vazhdueshme ndaj fëmijëve që shkojnë në udhë të gabuar.

MËSIMI 16: LUTJA FAMILJARE, STUDIMI FAMILJAR I SHKRIMEVE TË SHENJTA DHE MBRËMJA FAMILJARE

Lutja familjare, studimi familjar i shkrimeve të shenjta dhe mbrëmja familjare duhet të jenë përparësitë më të larta për çdo familjeje në Kishë.


Familjet marrin bekime të mëdha ku lutën së bashku.

Studimi familjar i shkrimeve të shenjta i ndihmon familjet të afrohen më pranë Perëndisë.

Mbrëmja familjare i ndihmon familjet të përforcohen ndaj ndikimeve të botës.

PJESA A

FORCIMI I MARTESËS



“FAMILJA ËSHTË QENDRORE NË PLANIN E KRIJUESIT”

1

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërën ose që të dy këto sugjerime.

- Rishikoni “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës” (faqe iv). Përcaktoni mënyra për ta ndjekur më mirë këtë këshillë profetike.
- Blini një poster të “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës” (35602 ose 35538) nga qendra shpërndarëse e Kishës. Vendoseni atë në një vend të dukshëm të shtëpisë tuaj.

PËR KËTË KOHË DHE PËR GJITHË PËRJETËSINË

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni dhe diskutojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

PËR KËTË KOHË DHE PËR GJITHË PËRJETËSINË

Plaku Boid K. Paker
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plani i Madh i Lumturisë

Të dashur vëllezër e motra, shkrimet e shenjta dhe mësimet e apostujve e profetëve flasin për ne në jetën para lindjes si bij e bija, fëmijë shpirtërorë të Perëndisë¹. Gjinia ekzistonte që më parë dhe nuk filloi me lindjen në vdekshmëri².

Në këshillin e madh të qiellit,³ u paraqit plani i Perëndisë:⁴ plani i shpëtimit⁵, plani i shëlbimit,⁶ plani i madh i lumturisë⁷. Plani na jep mundësinë e një prove; të gjithë duhet të zgjedhin midis së mirës dhe së ligës⁸. Plani i Tij na siguron një Shëlbues, një shlyerje, Ringjalljen dhe nëse bindemi, kthimin tonë në praninë e Perëndisë.

Kundërshtari u rebelua dhe hartoi një plan të vetin⁹. Atyre që e ndoqën atë iu hoq e drejta e një trupi të vdekshëm¹⁰. Prania jonë këtu na konfirmon se ne e miratuam planin e Atit tonë¹¹.

Qëllimi i vetëm i Luciferit është të kundërshtojë planin e madh të lumturisë, të shkatërrojë përvojat më të pastra, më të bukura dhe më të kënaqshme të jetës: romancën, dashurinë, martesën dhe të qenit prind¹². Hijet e dëshpërimit dhe fajit¹³ e ndjekin atë ngado. Vetëm pendimi mund të shërojë atë që ai dëmton.

Plani i Perëndisë Kërkon Martesën dhe Familjen

Plani i lumturisë kërkon bashkimin e drejtë të një mashkulli dhe një femre, një burri dhe një gruaje, një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje¹⁴. Doktrinën

na mësojnë si t'i përgjigjemi impulseve të fuqishme natyrore që shumë shpesh dominojnë mënyrën e sjelljes sonë.

Një trup i modeluar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë u krijua për Adamin¹⁵ dhe më pas ai u dërgua në Kopsht¹⁶. Në fillim Adami ishte vetëm. Ai mbante priftërinë,¹⁷ por, i vetëm ai nuk mund të përmbushte qëllimin e krijimit të tij¹⁸.

Asnjë burrë tjetër nuk do ta arrinte. As i vetëm, as me burra të tjerë Adami nuk mund të përparonte. As Eva nuk do të përparonte me një grua tjetër. Kështu ishte atëherë. Kështu është dhe sot.

Eva, një ndihmëse, u krijua. Martesa u vendos,¹⁹ sepse Adami u urdhërua të kapej pas *bashkëshortes* së tij (jo vetëm pas një *gruaje*) dhe “pas askujt tjetër”²⁰.

Mund të thuhet se një zgjedhje u vu para Evës²¹. Ajo duhet të lavdërohet për vendimin e saj. Më pas “Adami ra që njerëzit të mund të jenë”²².

Plaku Orson F. Uitni e përshkroi Rënien si të kishte “një drejtim të dyfishtë — poshtë dhe në të njëjtën kohë lart. Ajo e sollti njeriun në botë dhe vendosi këmbët e tij mbi rrugën e përparimit”²³.

Perëndia e bekoi Adamin dhe Evën “dhe u [tha] atyre: Jini të frytshëm dhe shumëzohuni”²⁴. Dhe kështu u krijua familja.

Perëndia i Vlerëson Burrat dhe Gratë në Mënyrë të Barabartë

Nuk ka asgjë në zbulesat që kemi marrë që të sugjerojë se të jesh burrë dhe jo një grua parapëlqehet më tepër në sy të Perëndisë, ose se Ai i vlerëson më tepër bijtë e tij sesa bijat e tij.

Të gjitha virtytet e përmendura në shkrimet e shenjta — dashuria, gëzimi, paqja, besimi, perëndi-shmëria, dashuria hyjnore — janë virtyte që i kanë si burrat ashtu edhe gratë,²⁵ dhe ordianca më e lartë e priftërisë në vdekshmëri i jepet vetëm një burri dhe një gruaje së bashku²⁶.

Pas Rënies, ligji i natyrshëm pati një sovranitet shumë më të gjerë mbi lindjen në vdekshmëri. Këto janë ato çka President J. Ruben Klark, i riu, i quajti “rrengjet” e natyrës,²⁷ të cilat shkaktojnë një sërë anomalish, mangësish dhe deformimesh. Megjithëse mund t’i duken të padrejta arsyetimit njerëzor, ato në një farë mënyre u përshtaten qëllimeve të Zotit për të vënë në provë njerëzimin.

Ndjekja e çdo instikti të denjë, përgjigjia ndaj çdo nxitjeje të drejtë, konsumimi i çdo marrëdhënieje lartësuese njerëzore jepet e miratohet në doktrinat e ungjillit të Jezu Krishtit dhe mbrohet me anë të urdhërimeve të zbuluara Kishës së Tij.

Rolet e Burrave dhe Grave

Po të mos ishin të ndyshëm në natyrë nga njëri-tjetri, Adami dhe Eva nuk do të mund të shumëzoheshin dhe të mbushnin tokën²⁸. Ndryshimet plotësuese janë kyçi i planit të lumturisë.

Disa role i përshtaten më mirë natyrës mashkullore dhe disa të tjera natyrës femërore. Si shkrimet e shenjta ashtu edhe vetë natyra e vendosin burrin si mbrojtësin dhe siguruesin e të mirave materiale²⁹.

Ato përgjegjësi të priftërisë që kanë të bëjnë me administrimin e Kishës domosdoshmërisht funksionojnë jashtë shtëpisë. Me anë të dekretit hyjnor, ato u janë besuar burrave. Kështu ka qenë që nga fillimi, sepse Zoti zbuloi se “urdhëri i kësaj priftërie u ngrit që të kalohej nga ati te biri . . . Ky urdhër u krijua në ditët e Adamit”³⁰.

Një burrë që mban priftërinë nuk ka epërsi mbi një grua për sa i përket plotësimit të kushteve për ekzaltim. Gruaja, nga natyra e saj, është gjithashtu bashkë-krijuese me Perëndinë dhe edukatorja kryesore e fëmijëve. Virtytet dhe cilësitë mbi të cilat varet përsosmëria dhe ekzaltimi i vijnë në mënyrë të natyrshme gruas dhe më pas përpunohen përmes martesës dhe amësisë.

Priftëria u jepet vetëm burrave të denjë në përputhje me planin e lumturisë që Ati ynë ka për ne. Me ligjet e natyrës dhe me fjalën e zbuluar të Perëndisë që punojnë së bashku në harmoni, thjesht funksionon më mirë kështu.

Priftëria mbart me vete një përgjegjësi të mrekullueshme. “Asnjë fuqi apo ndikim *nuk mund* ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësj-

lljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pa-shtirur; nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër”³¹.

Në qoftë se një burrë “[ushtron] kontroll apo sundim, apo detyrim . . . në çfarëdo shkallë padrejtësie,”³² ai dhunon “[betimin] dhe [besëlidhjen] të cilat i përkasin priftërisë”³³. Atëherë “qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet”³⁴. Në qoftë se nuk pendohet, ai do t’i humbasë këto bekime.

E ndërsa rolet e ndryshme të burrit dhe gruas janë vendosur në shpalljet e ekzaltuara çelestiale, ato tregohen më mirë në përvojat praktike, të zakonshme e të thjeshta të jetës familjare.

Kohët e fundit dëgjova një folës në mbledhjen e sakramentit të ankohej se nuk e kuptonte se pse nipërit e mbesat e tij gjithmonë thoshin se do të shkonin te shtëpia e *Gjyshes* dhe asnjëherë nuk thoshin te shtëpia e Gjyshit. Ja zbulova atij atë mister të madh: Gjyshërit nuk bëjnë ëmbëlsira!

Ligjet e Natyrës dhe Ligjet Shpirtërore Janë të Përbjeshme

Ligjet e natyrës dhe ligjet shpirtërore që qeverisin jetën janë krijuar që para themelimit të botës³⁵. Ato janë të përbjeshme, siç janë edhe pasojat e bindjes ose mosbindjes ndaj tyre. Ato nuk bazohen mbi gjykimet shoqërore ose politike. Ato nuk mund të ndryshohen. Asnjë presion, asnjë protestë, asnjë legjislacion nuk mund t’i ndryshojë ato.

Vite më parë mbikëqyrja seminaret e indianëve të Amerikës. Kur vizitova një shkollë në Albakurki, drejtori më tregoi për një incident që kishte ndodhur në një nga klasat e para.

Gjatë mësimit, një kotele po vinte rrotull nëpër klasë dhe u tërhiqte vëmendjen vogëlushve. E morën kotelen dhe e vunë para klasës që ta shikonin të gjithë.

Një nga të rinjtë tha: “Është kotele mashkull apo femër?”

Mësuesi, i papërgatitur për këtë lloj diskutimi, tha: “Nuk ka rëndësi, është thjesht një kotele.”

Por fëmijët ngulën këmbë dhe një djalë i vogël tha: “E di unë se si mund ta dallojmë nëse është një kotele mashkull ose femër.”

Mësuesi i zënë ngushtë, tha: “Pa hë, na trego se si mund ta dallojmë nëse është një kotele mashkull ose femër.”

Djali u përgjigj: “Mund ta hedhim në votë!”

Disa gjëra nuk mund të ndryshohen. Doktrina nuk mund të ndryshohet.

“Parimet që janë zbuluar,” tha Presidenti Uillford Udraft, “për shpëtimin dhe ekzaltimin e fëmijëve të

njerëzve . . . janë parime që nuk mund t'i asgjësoni. *Ato janë parime që asnjë marrëveshje e fshehtë burrash [ose grash] nuk mund t'i shkatërrojë.* Ato janë parime që nuk mund të vdesin kurrë . . . Ato janë të paarritshme nga ana e njeriut për t'u kontrolluar ose shkatërruar . . . E gjithë bota bashkë nuk ka fuqinë t'i shkatërrojë këto parime . . . Asnjë pikë e presje e këtyre parimeve nuk do të shkatërrohet ndonjëherë"³⁶.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, burrat u thirrën për të luftuar. Në ato situata të ngutshme, gratë dhe nënat në mbarë botën u tërhoqën në fuqinë punëtore si kurrë më parë. Ndikimi më shkatërrues i luftës u ndje në familje. Ai ndikim vazhdon të ndihet edhe në këtë brez.

Shumëzohuni dhe Mbushni Tokën

Në konferencën e përgjithshme të tetorit 1942, Presidencia e Parë u dha një mesazh "shenjtorëve të çdo vendi e klime," në të cilin thuhej: "Nëpërmjet virtytit të autoritetit që na është dhënë si Presidenci e Parë e Kishës, ne i paralajmërojmë njerëzit tanë."

Dhe vazhduan: "Midis urdhërimeve të para që i dha Adamit dhe Evës, Zoti tha: 'Shumëzohuni dhe mbushni tokën.' Ai e ka përsëritur atë urdhërim në kohën tonë. Ai ka zbuluar përsëri në këtë periudhë të fundit, parimin e përjetësisë së besëlidhjes së martesës . . .

Zoti na ka thënë se është detyra e çdo bashkëshorti dhe bashkëshorteje t'i bindet urdhërimit që iu dha Adamit për të shumëzuar dhe mbushur tokën, në mënyrë që legjione të tërë shpirtash të zgjedhur që po presin për tabernakullin e tyre prej mishi të mund të vijnë këtu dhe të përparojnë nën planin e madh të Perëndisë për t'u bërë shpirta të përkryer, sepse pa këto tabernakuj prej mishi ata nuk mund të përparojnë drejt destinacionit të caktuar nga Perëndia i tyre. Kështu, çdo bashkëshort dhe bashkëshorte duhet të bëhet një at dhe një nënë në Izrael për fëmijët e lindur nën besëlidhjen e shenjtë e të përjetshme.

Duke i sjellë në tokë këta shpirta të zgjedhur, çdo baba dhe çdo nënë merr përsipër ndaj këtij shpirti që i falën trupin dhe ndaj Vetë Zotit, duke përfutur kështu nga mundësia që Ai u ka ofruar, një detyrim të një lloji nga më të shenjtët, sepse fati i atij shpirti në përjetësitë që do të vijnë, bekimet apo ndëshkimet që do ta presin atë këtej e tutje, varen, në një shkallë të madhe, nga kujdesi, mësimet dhe edukimi që prindërit do t'i japin atij shpirti.

Asnjë prind nuk mund t'i shpëtojë atij detyrimi e asaj përgjegjësie dhe Zoti do të na kërkojë një llogari të rreptë për plotësimin e tyre. Asnjë detyrë më e lartë nga kjo nuk mund të ndërmerret nga njerëzit e vdekshëm."

Amësia Është një Thirrje e Shenjtë

Duke folur për nënat, Presidencia e Parë tha: "Amësia bëhet kështu një thirrje e shenjtë, një përkushtim i shenjtë për të zbatuar planet e Zotit, një përkushtim devotshmërie ndaj rritjes, edukimit dhe të ushqyerit në trup, mendje e shpirt i atyre që mbaj-tën gjendjen e tyre të parë dhe që erdhën në këtë tokë për gjendjen e tyre të dytë 'për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë' (Abrahami 3:25). Udhëheqja e tyre me qëllim që ta ruajnë gjendjen e tyre të dytë është puna e amësisë dhe 'ata që e ruajnë gjendjen e tyre të dytë, do të kenë lavdi të shtuar mbi kokat e tyre përherë e përgjithmonë' (vep. e cit.) [Abrahami 3:26].

Ky shërbim i shenjtë i amësisë mund të jepet vetëm nga nënat. Nuk mund t'i kalohet të tjerëve. Edukatorët nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë; as çerdhet publike nuk mund ta bëjnë këtë; as edhe ndihmëset e punësuar nuk mundën — vetëm nëna, e ndihmuar aq sa të jetë e mundur nga duart e dashura të babait, vëllezërve dhe motrave mund të japë masën e plotë e të nevojshme të kujdesit vigjilent."

Presidencia e Parë këshilloi se "ajo nënë që ia beson fëmijën e saj kujdesit të të tjerëve, që të mund të bëjë punë të tjera që nuk kanë të bëjnë më amësinë, qoftë për ar, për famë, ose shërbim qytetar, duhet të kujtojë se 'fëmija për të cilën nuk kujdeset kurrkush e turpëron nënën e vet.' (Fjalët e Urta 29:15). Në kohën tonë Zoti ka thënë se në qoftë se prindërit nuk u mësojnë fëmijëve të tyre doktrinën e Kishës 'mëkati qoftë mbi kokat e prindërve.' (DeB 68:25)

Amësia është pranë hyjnisë. Ajo është shërbimi më i lartë, më i shenjtë që mund të kryhet nga njerëzimi. Amësia e vendos gruan që e nderon thirrjen dhe shërbimin e saj të shenjtë pranë engjëjve"³⁷.

Ky mesazh dhe paralajmërim nga Presidencia e Parë nevojitet më tepër, jo më pak, sot, sesa në kohën kur u dha. Dhe asnjë zë nga cilado organizatë e Kishës ose nivel administrimi nuk barazohet me atë të Presidencisë së Parë"³⁸.

Çdo shpirti që nga natyra ose rrethanat nuk ka mundur të ketë bekimin e martesës dhe të të qenit prind, ose që jo për faj të vet i është dashur t'i rrisë fëmijët vetëm dhe të punojë për t'i mbështetur ata, nuk do t'i mohohet asnjë bekim në përjetësi — në qoftë se ata mbajnë urdhërimet"³⁹. Ashtu siç premtoi Presidenti Snou: "Kjo është e vërtetë dhe e sigurtë"⁴⁰.

Shëmbëlltyra e Thesarit dhe Çelësave

Po e mbyll me një shëmbëlltyrë.

Një herë një burrë mori si trashëgimi dy çelësa. I thanë se çelësi i parë do të hapte një qilar të cilën ai duhej ta mbronte me çdo kusht. Çelësi i dytë do të

hapte një kasafortë brenda qilarit ku ndodhej një thesar i çmuar. Ai do ta hapte këtë kasafortë dhe do të përdorte lirisht gjërat e çmuara që ruheshin në të. E paralajmëruan se shumë do të përpiqeshin t'ia grabisnin trashëgiminë. Atij iu premtua se nëse do ta përdorte thesarin denjësisht, ai do të shumohej dhe nuk do të mbarohej kurrë, madje as në gjithë përjetësinë. Ai do të vihej në provë. Në qoftë se do ta përdorte thesarin në të mirë të të tjerëve, bekimet dhe gëzimi i tij do të rriteshin.

Burri shkoi vetëm në qilar. Çelësi i parë hapi derën. Ai u përpoq ta hapte derën e thesarit me çelësin e dytë, por nuk mundi, sepse kasaforta kishte dy brava. Vetëm çelësi i tij nuk mundi ta hapte. Pavarësisht se sa shumë u mundua, nuk mundi ta hapte dot. Ai u habit. I kishin dhënë çelësat. Ai e dinte se thesari i përkiste me të drejtë. U qe bindur udhëzimeve, po prapëseprapë nuk mundi ta hapte kasafortën.

Pas disa kohësh në qilar erdhi një grua. Edhe ajo kishte një çelës. Çelësi i saj ishte shumë ndryshe nga çelësi që kishte ai. Çelësi i saj hapi bravën tjetër. Ai u ndje i përlurur të mësonte se nuk mundi ta merrte trashëgiminë e tij legjitime pa të.

Ata bënë një besëlidhje se së bashku do ta hapnin thesarin dhe, siç ishte udhëzuar, ai do të kujdesej për qilarin dhe do ta mbronte atë; ajo do të kujdesej për thesarin. Ajo nuk u shqetësua se ai, si ruajtësi i qilarit, mbante dy çelësa, sepse qëllimi i tij i vetëm ishte të përpiquej që ajo të ishte e sigurtë ndërsa kujdesej për atë që ishte më e çmuar për të dy. Së bashku ata e hapën kasafortën dhe morën trashëgiminë e tyre. Ata u gëzuan, sepse, siç u qe premtuar, ajo u shumua.

Me gëzim të madh ata zbuluan se mund t'ia kalonin thesarin brez pas brezi fëmijëve të tyre; secili do të mund të merrte një masë të plotë, të papakësuar deri në brezin e fundit.

Ndoshta disa nga pasardhësit e tyre nuk do të gjenin një shok/shoqe që do të kishte çelësin plotësues, ose dikë të denjë dhe të gatshëm për të mbajtur besëlidhjet që kishin të bënin me thesarin. Megjithatë, në qoftë se do të mbanin besëlidhjet, atyre nuk do t'u mohohej as edhe bekimi më i vogël.

Për shkak se disa i tunduan ta keqpërdornin thesarin e tyre, ata u kujdesën t'u mësonin fëmijëve rreth çelësave dhe besëlidhjeve.

Me kalimin e kohës, midis pasardhësve të tyre kishte disa që u mashtruan ose që ishin xhelozë ose egoistë, sepse njërit i qenë dhënë dy çelësa dhe tjetrit vetëm një. "Pse," arsyetonin egoistët, "nuk mundi të jetë thesari vetëm i imi që ta përdor si të dua?"

Disa u përpoqën të bënin një çelës të ri që t'i përngjante çelësit që u qe dhënë. Ndoshta, menduan ata, do të hapë të dy bravat. Dhe kështu kasaforta mbeti e mbyllur për ta. Çelësat që kishin rimodeluar nuk vlenin për asgjë dhe trashëgimia e tyre humbi.

Ata që e pranuan thesarin me mirënjohje dhe iu bindën ligjeve që kishin të bënin me të njohën gëzim të pakufijshëm gjatë jetës dhe gjithë përjetësisë.

Unë dëshmoj për planin e Atit tonë për lumturinë dhe dëshmoj në emër të Atij që kreu Shlyerjen, që ky plan të mund të përmbushet.

Nga një fjalim i Plakut Paker në konferencën e përgjithshme të Kishës në tetor 1993 (shih Conference Report, tetor 1993, 27-31; ose *Ensign*, nëntor 1993, 21-24).

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 76:24; shih gjithashtu Numrat 16:22; Hebrenjve 12:9.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 132:63; Presidencia e Parë, "The Origin of Man" (nëntor 1909), në James R. Clark, përmb., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 6 vols. (1965-75), 4:203; shih gjithashtu Spencer W. Kimball, "The Blessings and Responsibilities of Womanhood," *Ensign*, mars 1976, 71; Gordon B. Hinckley, në Conference Report, tetor 1983, 115; ose *Ensign*, nëntor 1983, 83.
3. Shih *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, zgjedh. Joseph Fielding Smith (1976), 348-49, 357, 365.
4. Shih Abrahami 3:24-27.
5. Shih Jaromi 1:2; Alma 24:14; 42:5; Moisiu 6:62.
6. Shih Jakobi 6:8 (LiM); Alma 12:25-36; 17:16; 18:39; 22:13-14; 39:18; 42:11, 13.
7. Alma 42:8.
8. Shih Alma 42:2-5.
9. Shih 2 Nefi 9:28; Alma 12:4-5; Helamani 2:8; 3 Nefi 1:16; Doktrina e Besëlidhje 10:12, 23; Moisiu 4:3.
10. Shih *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, 181, 297.
11. Shih *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, 181.
12. Shih 2 Nefi 2:18; 28:20.
13. Shih Alma 39:5; Moroni 9:9.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:2; 131:2; 1 Korintansve 11:11; Efesianëve 5:31.
15. Shih Moisiu 6:8-9.
16. Shih Moisiu 3:8.
17. Shih Moisiu 6:67.
18. Shih Moisiu 3:18.
19. Shih Moisiu 3:23-24.
20. Doktrina e Besëlidhje 42:22.
21. Shih Moisiu 4:7-12.
22. 2 Nefi 2:25.
23. *Cowley and Whitney on Doctrine*, përmb. Forace Green (1963), 287.
24. Moisiu 2:28; shih gjithashtu Zanafilla 1:28; 9:1.
25. Shih Galatasve 5:22-23; Doktrina e Besëlidhje 4:5-6; Alma 7:23-24.
26. Shih Doktrina e Besëlidhje 131:2.

27. Shih "Our Wives and Our Mothers in the Eternal Plan" (fjalim dhënë në konferencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, 3 tetor 1946), në *J. Reuben Clark: Selected Papers on Religion, Education, and Youth*, red. David H. Yarn Jr. (1984), 62.
28. Shih Zanafilla 1:28, shënimi 28c (në Biblën në anglisht).
29. Shih Doktrina e Besëlidhje 75:28; 1 Timoteut 5:8.
30. Doktrina e Besëlidhje 107:40-41; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 84:14-16.
31. Doktrina e Besëlidhje 121:41-42; shkronjat kursive janë shtuar.
32. Doktrina e Besëlidhje 121:37.
33. Doktrina e Besëlidhje 84:39.
34. Doktrina e Besëlidhje 121:37.
35. Shih *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, 308, 367.
36. *The Discourses of Wilford Woodruff*, përzgjedh. G. Homer Durham (1946), 25-26; shkronjat kursive janë shtuar.
37. Në Conference Report, tet. 1942, 7, 11-12.
38. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:8-9, 22, 91.
39. Shih Doktrina e Besëlidhje 137:7-9.
40. "Discourse by President Lorenzo Snow," *Millennial Star*, 31 gusht 1899, 547.

ZHVILLIMI I UNITETIT NË MARTESË

2

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Lexoni fragmentet e mëposhtme të shkrimeve të shenjta rreth unitetit: 1 Korintasve 1:9-10; Filipianëve 1:27; Mosia 18:21; Doktrina e Besëlidhje 38:27. Meditoni se si këto fragmente mund të gjejnë zbatim në marrëdhënien midis burrit dhe gruas.
- Diskutoni me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj kërkesat që ju të dy keni për kohën tuaj, përfshirë këtu detyrimet shoqërore, profesionale, si edhe detyrimet që keni ndaj komunitetit dhe Kishës. Kushtojini kohë të kuptuarit të nevojave të njërit-tjetrit dhe sigurohuni që detyrimet që keni të mos ndërhyjnë me besnikërinë tuaj ndaj njërit-tjetrit.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni e diskutojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

QË NE TË MUND TË JEMI NJË

Plaku Henri B. Ajring
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Nëse Nuk Jeni Një, Nuk Jeni të Mitë”

Shpëtimtari i botës, Jezu Krishti, tha për ata që bëhen pjesë e Kishës së Tij: “Unë ju them, jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë” (DeB 38:27). Dhe në krijimin e burrit dhe gruas, uniteti midis tyre në martesë nuk u dha si një shpresë; ai ishte një urdhërim! “Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm” (Zanafilla 2:24). Ati ynë Qiellor dëshiron që zemrat tona të jenë të lidhura së bashku. Uniteti në dashuri nuk është thjesht një ideal. Është një domosdoshmëri.

Kërkesa që të jemi një nuk është vetëm për këtë jetë. Ky unitet duhet të jetë pa fund. Martesa e parë u krye nga Perëndia në kopshtin [e Edenit] kur Adami dhe Eva ishin ende të pavdekshëm. Që në fillim, Ai vendosi tek burrat e gratë një dëshirë për t’u bashkuar së bashku si burrë e grua përgjithmonë për të banuar në familje në një unitet të përkryer e të drejtë. Ai vendosi brenda fëmijëve të Tij dëshirën për të jetuar në paqe me të gjithë ata që i rrethojnë.

Por pas Rënies u bë e qartë se të jetuarit në unitet nuk do të ishte i lehtë. Tragjedia gotiti pa vonuar. Kaini vrau Abelin, vëllain e tij. Fëmijët e Adamit dhe Evës ishin bërë subjekt i tundimeve të Satanit.

Me mjeshtëri, urrejtje dhe dinakëri, Satani ndjek qëllimin e tij. Qëllimi i tij është i kundërt me qëllimin e Atit tonë Qiellor dhe Shpëtimtarit. Ata duan të na japin një unitet të përkryer dhe lumturi të përjetshme. Satani, armiku i tyre dhe i yni, e ka njo-hur planin e shpëtimit që para Krijimit. Ai e di se vetëm në jetën e përjetshme mund të vazhdojnë ato marrëdhënie të shenjta e të gëzueshme familjare. Satani do të na ndajë nga njerëzit tanë të dashur dhe të na lërë në një gjendje të mjeruar. Është ai që mbjell farat e mosmarrëveshjes në zemrat e njerëzve me shpresën që të na ndajë dhe të na largojë nga njërit-tjetri.

Të gjithë ne e kemi provuar si unitetin ashtu edhe ndarjen. Ndonjëherë në familje dhe ndoshta edhe në rrethana të tjera, kemi përjetuar çaste jete kur dikush, me dashuri e sakrificë, ka vënë interesat e një tjetri përpara interesave të veta. Dhe të gjithë ne dimë diçka nga trishtimi dhe vetmia që ndiejmë kur jemi të ndarë dhe të vetmuar. Nuk është e nevojshme të na thuhet se kë duhet të zgjedhim. Ne e dimë. Por kemi nevojë për shpresën se mund të provojmë unitet në këtë jetë dhe të jemi të përgatitur për ta pasur atë përgjithmonë në botën që do të vijë. Ne gjithashtu duhet të dimë se si mund të na vijë ai bekim i madh që të mund të dimë se ç’duhet të bëjmë.

Shpëtimtari e Bën të Mundur Unitetin

Shpëtimtari i botës foli për atë unitet dhe se ne duhet të ndryshojmë natyrën tonë për ta bërë të

mundur këtë. Ai na e mësoi qartë këtë në lutjen që dha në mbledhjen e fundit me Apostujt para vdekjes së Tij. Ajo lutje e bukur qiellore gjendet e shkruar në librin e Gjonit. Kishte ardhur koha që Ai të përballlej me sakrificën e tmerrshme për të gjithë ne, që do ta bënte të mundur jetën e përjetshme. Ai do të largohet nga Apostujt që kishte shuguruar, të cilët i donte dhe të cilëve do t'u linte çelësat për të udhëhequr Kishën e Tij. Dhe kështu Ai iu lut Atit të Tij, Biri i përkryer i lutet Prindit të përkryer. Në fjalët e Tij vërejmë se si familjet do të bëhen një, ashtu siç do të bëhen një edhe të gjithë fëmijët e Atit tonë Qjellor që ndjekin Shpëtimtarin dhe shërbëtorët e Tij:

“Sikurse ti më ke dërguar mua në botë, po ashtu unë i kam dërguar ata në botë.

“Dhe unë për ta po shenjtëroj vetveten, që edhe ata të jenë të shenjtëruar në të vërtetë.

Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre,

që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar” (Gjoni 17:18-21).

Në ato pak fjalë Ai e bëri të qartë se si ungjilli i Jezu Krishtit mund të bëjë të mundur që zemrat të bëhen një. Ata që do të besojnë të vërtetën që Ai mësoi mund të pranojnë ordinancat dhe besëlidhjet e ofruara nga shërbëtorët e Tij të autorizuar. Më pas, me anë të bindjes ndaj këtyre ordinancave dhe besëlidhjeve, natyra e tyre do të ndryshojë. Në këtë mënyrë Shlyerja e Shpëtimtarit bën të mundur që të shenjtërohemi. Kështu ne mund të jetojmë në unitet, ashtu siç duhet të jetojmë, që të kemi paqe në këtë jetë dhe të banojmë me Atin dhe Birin e Tij në përjetësi.

Shërbesa e apostujve dhe profetëve në atë kohë, ashtu si edhe sot, ishte që t'i sillnin fëmijët e Adamit dhe Evës në një unitet të besimit në Jezu Krisht. Qëllimi përfundimtar i asaj që ata mësuuan, dhe i asaj që ne mësojmë sot, është të bashkojë familjet: bashkëshortët, bashkëshortet, fëmijët, nipërit e mbesat, paraardhësit dhe më në fund të gjithë familjen e Adamit dhe Evës që do ta ndjekë atë qëllim.

Shpirti Çon në Unitetin me të Tjerët

Ju e mbani mend se Shpëtimtari u lut: “Dhe unë për ta” — duke folur për Apostujt — “po shenjtëroj vetveten, që edhe ata të jenë të shenjtëruar në të vërtetë” (Gjoni 17:19). Fryma e Shenjtë është një shenjtëruues. Ne mund ta kemi atë si shoqëruesin tonë, sepse Zoti e rivendosi Priftërinë Melkizedeke me anë të Profetit Jozef Smith. Çelësat e asaj priftërie janë në tokë sot. Njëpërmjet fuqisë së saj ne mund të

bëjmë besëlidhje që na lejojnë të kemi me vete vazhdimisht Frymën e Shenjtë.

Atje ku njerëzit kanë atë Shpirt me ta, aty mund të presim të ketë harmoni. Shpirti vendos dëshminë e së vërtetës në zemrat tona dhe kjo i bashkon ata që ndajnë mes tyre të njëjtën dëshmi. Shpirti i Perëndisë nuk sjell kurrë grindje (shih 3 Nefi 11:29). Ai kurrë nuk krijon ndjenja dallimi midis njerëzve të cilat çojnë në konflikte (shih Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, [1939], 131). Shpirti çon drejt paqes personale dhe një ndjenje uniteti me të tjerët. Ai bashkon shpirtrat. Një familje e bashkuar, një Kishë e bashkuar, një botë në paqe varet nga shpirtrat e bashkuar.

Mbajtja e Premtimeve të Bëra në Lutjen e Sakramentit

Edhe një fëmijë mund të kuptojë së çfarë duhet të bëjmë që ta kemi Frymën e Shenjtë si një shok. Ne e dëgjojmë këtë lutje çdo javë kur marrim pjesë në mbledhjet e sakramentit. Gjatë atyre çasteve të shenjta ne ripërtërijmë besëlidhjet që bëjmë në pagëzim. Dhe Zoti na kujton premtimet që morëm kur u konfirmuam anëtarë të Kishës — premtimin që mund të marrim Frymën e Shenjtë. Ja ku janë fjalët e lutjes së sakramentit: “Ata janë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Birit tënd dhe gjithmonë ta kujtojnë atë e të zbatojnë urdhërimet që ai u ka dhënë atyre, që të mund të kenë gjithmonë Shpirtin e tij me ta” (DeB 20:77).

Ne mund ta kemi Shpirtin e Tij duke mbajtur atë besëlidhje. Së pari, ne premtojmë të marrim mbi vete emrin e Tij. Kjo do të thotë se duhet ta konsiderojmë veten si të Tijët. Ne do ta vendosim Atë të parin në jetën tonë. Do të duam atë që Ai do dhe jo atë që duam ne ose atë që bota na mëson të duam. Deri sa të vazhdojmë të duam së pari gjërat e botës, nuk do të ketë paqe brenda nesh. Të pasurit e një ideali për një familje ose një komb të qetë nëpërmjet të mirave materiale, së fundmi, do t'i përçajë ata (shih Harold B. Lee, *Stand Ye in Holy Places* [1974], 97). Ideali i të bërit për njëri-tjetrin atë që Zoti kërkon nga ne, që rrjedh natyrshëm nga marrja mbi vete e emrit të Tij, mund të na çojë në një nivel shpirtëror që është një grimë qielli mbi tokë.

Së dyti, ne premtojmë ta kujtojmë gjithmonë Atë. Këtë e bëjmë sa herë që lutemi në emrin e Tij. Veçanërisht kur kërkojmë faljen e Tij, ashtu siç duhet të bëjmë gjithmonë, edhe atëherë e kujtojmë Atë. Në atë çast kujtojmë sakrificën e Tij që bën të mundur pendimin dhe faljen. Kur i përgjërohemi në lutje, e kujtojmë Atë si Avokatin tonë para Atit. Kur përjetojmë ndjenjat e faljes dhe paqes, kujtojmë durimin e Tij dhe dashurinë e Tij të pafund. Kur i kujtojmë të gjitha këto, zemrat na mbushen me dashuri.

Ne gjithashtu e mbajmë premtimin tonë për ta kujtuar Atë kur lutemi dhe lexojmë shkrimet e shenjta së bashku si një familje. Në lutjen familjare rreth tryezës së mëngjesit, një fëmijë mund të lutet për një tjetër që ai të bekohet dhe se çdo gjë do të shkojë mirë në provim ose në ndonjë tjetër detyrë. Kur këto bekime të ndodhin, fëmija i bekuar do të kujtojë dashurinë e mëngjesit dhe mirësinë e Avokatit në emër të të cilit u ofrua lutja. Zemrat do të bashkohen në dashuri.

Ne e mbajmë besëlidhjen tonë për ta kujtuar Atë sa herë i mbledhim familjet tona për të lexuar nga shkrimet e shenjta. Ato dëshmojnë për Zotin Jezu Krisht, sepse ky është dhe gjithmonë ka qenë mesazhi i profetëve. Edhe pse fëmijët mund të mos i mbajnë mend fjalët, ata do të kujtojnë Autorin e vërtetë, që është Jezu Krishti.

Bindjuni të Gjitha Urdhërimeve

Së treti, ndërsa marrim sakramentin ne premtojmë të mbajmë urdhërimet e Tij, të gjitha urdhërimet. Presidenti J. Ruben Klark i Riu, ndërsa u përgjyruar për unitet — ashtu siç bënte shpesh — gjatë një bisede në konferencën e përgjithshme, na paralajmëroi kundër përzgjedhjes në të qenit të bindur. Ai e shprehu këtë kështu: “Zoti nuk na ka dhënë asgjë që është e pavlefshme ose e panevojshme. Ai i ka mbushur Shkrimet e Shenjta me gjëra që duhet të bëjmë me qëllim që të mund të fitojmë shpëtimin.”

Presidenti Klark vazhdoi: “Kur marrim Sakramentin besëlidhim t’i bindemi dhe të mbajmë urdhërimet e Tij. Nuk ka përjashtime. Nuk ka dallime, as ndryshime” (në Conference Report, prill 1955, 10-11). Presidenti Klark na mësoi se ashtu siç pendohe mi për të gjitha mëkatet, jo pikërisht për një mëkat të vetëm, ashtu betohemi të mbajmë të gjitha urdhërimet. Sa e vështirë duket, aq edhe e thjeshtë është. Ne thjesht i nënshtrohemi autoritetit të Shpëtimtarit dhe premtojmë të jemi të bindur në çfarëdo që Ai na urdhëron (shih Mosia 3:19). Është dorëzimi ynë ndaj autoritetit të Jezu Krishtit që na lejon të jemi të bashkuar si familje, si Kishë dhe si fëmijë të Atit tonë Qiellor.

Zoti ia delegon këtë autoritet nëpërmjet profetit të Tij shërbëtorëve të përuar. Ai besim e kthen thirrjen tonë si një mësues shtëpie ose mësuese vizitash në një detyrë të ngarkuar nga Zoti. Ne shkojmë për Të, nën urdhërin e Tij. Një burrë i zakonshëm dhe një shok i ri adoleshent shkojnë nëpër shtëpi me shpresën që fuqitë e qiellit do t’i ndihmojnë të bëjnë të mundur që familjet të jenë të bashkuara dhe të mos ketë asnjë ashpërsi, as gënjeshtër, të folur pas shpine apo të folur dashakeqës. Besimi — se Zoti thërret

shërbëtorët [e Tij] — do të na ndihmojë t’i shpërfillim të metat e tyre kur ata na qortojnë, ashtu siç do të bëjnë në fakt. Ne do të shohim qëllimin e tyre të mirë më tepër sesa të metat e tyre njerëzore. Do të ketë më pak mundësi që të ndihemi të fyer dhe më tepër mundësi për të ndjerë mirënjohje për Mësuesin që i ka thirrur ata.

Dashuria Hyjnore Është Thelbësore për Unitetin

Ka disa urdhërime të cilat, kur thyhen, e shkatërrojnë unitetin. Disa prej tyre kanë të bëjnë me atë çfarë themi ne dhe disa të tjera me atë se si reagojmë ndaj atyre që na thonë të tjerët. Ne nuk duhet të flasim keq për askënd. Ne duhet të shikojmë të mirën tek njëri-tjetri dhe të flasim mirë për njëri-tjetrin sa herë të mundemi (shih David O. McKay, në Conference Report, tetor 1967, 4-11).

Në të njëjtën kohë, duhet të qëndrojmë kundër atyre që flasin me përbuzje për gjërat e shenjta, sepse efekti i sigurtë i një mëkati të tillë është të fyejë Shpirtin dhe të krijojë kështu grindje dhe pështjellim. Presidenti Spenser W. Kimbëll na tregoi si ta bëjmë këtë pa debatuar, teksa qëndronte i shtrirë në shtratin e një spitali, dhe iu lut njërit prej ndihmësve, që në një çast nervozizmi, e përmendi pa respekt emrin e Zotit: “‘Të lutem! Të lutem! Ai, emrin e të cilit ti fyen, është Zoti im.’ Pasoi një heshje vdekje, më pas një zë i ulët përshpëriti: ‘Më falni!’” (*The Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball [1982], 198). Një qortim i frymëzuar dhe dashamirës mund të jetë një ftesë për unitet. Mosdhënia e atij qortimi kur nxitemi nga Fryma e Shenjtë do të çojë në mosmarrëveshje.

Në qoftë se duam të kemi unitet, ekzistojnë disa urdhërime që duhet t’i mbajmë në lidhje me mënyrën se si ndihemi brenda vetes sonë. Ne duhet të falim dhe të mos ruajmë asnjë ndjenjë të keqe ndaj atyre që na kanë lënduar. Shpëtimtari dha shembullin e Tij në kryq: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë” (Lluka 23:34). Ne nuk i njohim zemrat e atyre që na kanë lënduar. As nuk i njohim të gjitha burimet e vetë zemërimit dhe plagëve tona. Apostulli Pal na tregoi si të duam në një botë me njerëz të papërkryer, përfshirë edhe veten, kur tha: “Dashuria është e durueshme; plot mirësi; dashuria nuk ka smirë, nuk vë në dukje, nuk krekoset, nuk sillet në mënyrë të pahijshme, nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet, nuk dyshon për keq” (1 Korintasve 13:4-5). Dhe më pas na dha një paralajmërim solemn kundër zemërimit me të metat e të tjerëve dhe harritit të të metave tona kur shkroi: “Tani në fakt, ne shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe për faqe; tashti njoh pjesërisht, kurse atëherë do të njoh thellë ashtu sikurse njihem” (1 Korintasve 13:12).

Qëndroni të Pastër dhe Ruhuni nga Krenaria

Lutja e sakramentit na kujton çdo javë se si dhurata e unitetit do të vijë nëpërmjet bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit të Jezu Krishtit. Kur mbajmë besëlidhjet tona për të marrë mbi vete emrin e Tij, për ta kujtuar Atë dhe për të mbajtur të gjitha urdhërimet e Tij, ne do të marrim shoqërimin e Shpirtit të Tij. Kjo do të zbusë zemrat tona dhe do të na bashkojë. Por ka dy paralajmërime që duhet të vijmë me atë premtim.

Së pari, Fryma e Shenjtë do të qëndrojë me ne vetëm nëse jemi të pastër dhe nuk dëshirojmë gjërat e botës. Zgjedhja për të qenë të papastër do ta largojë Frymën e Shenjtë. Shpirti banon vetëm brenda atyre që zgjedhin Zotin përmbi botën. “Jini të pastër” (3 Nefi 20:41; DeB 38:42) dhe duajeni Perëndinë me gjithë “zemrën [tuaj], me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën [tuaj]” (DeB 59:5) këto nuk janë sugjerime, por urdhërime. Ato janë të domosdoshme për të pasur shoqërimin e Shpirtit, pa të cilin nuk mund të jemi një.

Paralajmërimi tjetër është të ruhem nga krenaria. Uniteti që krijohet në një familje ose mes një populli të zbutur nga Shpirti do të sjellë fuqi të madhe. Me atë fuqi do të vijë edhe vlerësimi nga bota. Nëse

ky vlerësim sjell me vete lavdërim ose lakmi, ai mund të na çojë drejt krenarisë. Kjo do ta fyente Shpirtin. Ekziston një mbrojtje ndaj krenarisë, atij burimi të sigurtë të përçarjes. Kjo mbrojtje vjen kur i shikojmë të mirat që Perëndia derdh mbi ne jo vetëm si një shenjë të hirit të Tij, por si një mundësi për t’u bashkuar me të tjerët rreth nesh në një shërbim edhe më të madh. Burri dhe gruaja e tij mësojnë të jenë një duke i përdorur ngjashmëritë e tyre për të kuptuar njëri-tjetrin dhe ndryshimet e tyre për të plotësuar njëri-tjetrin për t’i shërbyer kështu njëri-tjetrit dhe të tjerëve rreth tyre. Po në këtë mënyrë, ne mund të bashkohemi me ata që nuk e pranojnë doktrinën tonë, por që kanë të njëjtën dëshirë me ne për të bekuar fëmijët e Atit tonë Qiellor.

Ne mund të bëhemi paqebërës, të denjë për t’u quajtur të bekuar dhe fëmijë të Perëndisë (shih Mateu 5:9).

Perëndia Ati ynë jeton. Biri i Tij i dashur, Jezu Krishti, është kreu i kësaj Kise dhe Ai u ofron të gjithëve që do ta pranojnë atë, flamurin e paqes.

Nga një fjalim i Plakut Ajring në konferencën e përgjithshme të Kishës në prill 1998 (shih Conference Report, prill 1998, 85-89; ose *Ensign*, maj 1998, 66-68).

KULTIVIMI I DASHURISË DHE MIQËSISË NË MARTESË

3

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Studioni Moroni 7:45-48. Bëni një listë të karakteristikave të dashurisë hyjnore që përmenden në këtë fragment. Zotohuni t'i përmirësoni këto karakteristika në jetën tuaj. Mendoni për mënyra se si këto karakteristika mund t'i ndihmojnë bashkëshortët e bashkëshortet të kultivojnë dashurinë dhe miqësinë mes tyre.
- Planifikoni së bashku me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj të kaloni kohë të dy çdo javë. Mund të jetë e nevojshme që këto planifikime t'i bëni duke i shënuar në kalendar ose në bllok në mënyrë që të mos harroni.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

TË QËNIT NJË NË MARTESË

President Spenser W. Kimbëll
Presidenti i 12-të i Kishës

Një martesë e nderuar, e lumtur dhe e suksesshme është me siguri qëllimi kryesor i çdo njeriu të zakonshëm. Martesa është ndoshta vendimi më jetësor ndër të gjitha vendimet e tjera dhe ka efekte shumë më të gjera, sepse ajo ka të bëjë jo vetëm me lumturinë e tanishme, por gjithashtu me gëzimet e përjetshme. Martesa prek jo vetëm ata dy persona që martohen, por ajo gjithashtu prek familjet e tyre dhe veçanërisht fëmijët dhe fëmijët e fëmijëve të tyre për breza me radhë.

Zgjedhja e një shoku/shoqeje për jetën dhe për përjetësinë, sigurisht që kërkon meditim dhe një planifikim të kujdesshëm, lutje dhe agjërime gjithashtu, për të qenë të sigurtë se ndër të gjitha vendimet e tjera, ky vendim të mos jetë i gabuar. Në një martesë të vërtetë duhet të ketë një unitet mendjesh dhe zemrash. Emocionet nuk duhet të përcaktojnë krejtësisht vendimet, por mendja dhe zemra, të forcuara nga agjërimi dhe lutja, dhe një vlerësim serioz [i situatës], do të na sjellin një mundësi maksimale për lumturi martesore. Ajo sjell me vete sakrificën, ndarjen e çdo gjëje mes njëri-tjetrit dhe kërkesën për një vetëmohim të madh.

Shumë nga filmat dhe historitë e përrallave përfundojnë me martesë: "Dhe ata jetuan të lumtur përgjithmonë." E kemi kuptuar tashmë se thjesht

kryerja e një ceremonie nuk sjell lumturi dhe një martesë të suksesshme. Lumturia nuk vjen duke shtypur një buton, ashtu siç ndodh me elektricitetin; lumturia është një gjendje e mendjes që vjen nga brenda. Ajo duhet të fitohet. Ajo nuk mund të blihet me para; nuk mund të merret në këmbim të asgjëje.

Disa njerëz mendojnë se lumturia është një jetë magjepëse, luksoze me emocione të vazhdueshme; por martesa e vërtetë bazohet mbi lumturinë që është më shumë se kaq, një lumturi kjo që vjen nga bujaria, shërbimi, ndarja e çdo gjëje me njëri-tjetrin, nga sakrifica dhe vetëmohimi.

Dy njerëz që vijnë nga mjedise të ndryshme shoqërore mësojnë shpejt se pas ceremonisë së martesës duhet të përballen me realitetin e ashpër. Nuk ka më një jetë fantazish ose imagjinatash; duhet të zbresim nga retë dhe t'i ngulim këmbët fort në tokë. Duhet të merren përsipër përgjegjësi dhe të pranohen detyra të reja. Duhet të hiqet dorë nga disa liri personale dhe shumë ndryshime, ndryshime vetëmohuese, duhen bërë.

Shpejt pas martesë fillon të kuptosh se bashkëshorti/bashkëshortja ka disa dobësi që nuk i ka shfaqur ose që nuk ia keni zbuluar më parë. Virtytet që gjatë periudhës së njohjes vazhdimisht shiheshin të zmadhuara tani duken relativisht të vogla dhe dobësitë që dikur dukeshin të vogla dhe të papërfillshme gjatë njohjes tani marrin përmasa të mëdha. Tashmë ka ardhur koha për të kuptuar zemrat, për vetë-vlerësim dhe për gjykim të mirë praktik, për të arsyetuar dhe

planifikuar. Tani veset e krijuara prej vitesh shfaqen; bashkëshorti (bashkëshortja) mund të jetë dorështrënguar ose shpërdorues, dembel ose punëtor, i përkushtuar ndaj fesë ose jofetar; ai mund të jetë i kujdesshëm dhe i gatshëm për të bashkëpunuar ose grënjar dhe inatçi, kërkues ose bujar, i vetëkënaqur ose modest. Më pas vjen në qendër problemi i vjehërrës e vjehërrit dhe përsëri marrëdhëniet e bashkëshortëve me ta shihen të zmadhuara.

Shpesh ekziston një mungesë gatishmërie për t'u angazhuar seriozisht dhe për të marrë përsipër përgjegjësitë e rënda që janë përpara. Ekonomia nuk e përballon dot jetën e begatë dhe të rinjtë shpesh duken tepër të paduruar për të mos mbetur prapa çifteve të tjera. Shpesh ekziston një mungesë vullneti të mirë për të bërë ndryshimet e nevojshme financiare. Bashkëshortet e reja shpesh kërkojnë që lukset që gëzonin dikur në shtëpitë e begata të baballarëve të tyre të suksesshëm të vazhdojnë edhe në shtëpitë e tyre. Disa prej tyre janë tepër të gatshme të ndihmojnë për të fituar atë jetë të begatë duke vazhduar punën edhe pas martesës. Për pasojë ato lënë shtëpinë, aty ku është detyra e tyre, për të ndjekur një karrierë profesionale ose biznesi, duke krijuar kështu një ekonomi të qëndrueshme që e bën shumë të vështirë dhënien pas një jete familjare normale. Kur punojnë që të dy bashkëshortët, në familje hyn më tepër konkurrenca në vend të bashkëpunimit. Dy punëtorë të lodhur kthehen në shtëpi me nerva të tendosura, krenari individuale, pavarësi më të madhe dhe më pas vijnë keqkuptimet. Mosmarrëveshjet e vogla kthehen gradualisht në mosmarrëveshje të mëdha.

E ndërsa martesë është e vështirë dhe martesat me mosmarrëveshje e me probleme janë të zakonshme, e megjithatë të vërteta, prapëseprapë lumturia e përhershme është e mundur dhe martesë mund të jetë një ekstazë ngazëllyese më tepër nga ç'mund ta imagjinojë mendja njerëzore. Këtë mund ta arrijë çdo çift dhe çdo individ. "Shpirtërat binjakë" janë fantazi dhe një iluzion; e ndërsa çdo i ri dhe e re do të përpiqet me gjithë shpirt dhe me shumë lutje për të gjetur një shok me të cilin jeta mund të jetë më harmonike dhe më e bukur, ende është e sigurtë që pothuaj çdo burrë i mirë dhe çdo grua e mirë mund të ketë lumturi dhe një martesë të suksesshme nëse që të dy janë të gatshëm të paguajnë çmimin që ajo kërkon.

Ekziston një formulë e pagabueshme që do t'i garantojë çdo çifti një martesë të lumtur dhe të përzetshme; por si me të gjitha formulat, elementët kryesorë nuk duhen përjashtuar, pakësuar ose kufizuar. Përzgjedhja përpara periudhës së korteve dhe më pas kortet e vazhdueshme pas martesës janë të një rëndësie të barabartë, por jo më të rëndësishme

se vetë martesë, suksesi i së cilës varet nga të dy individët — jo vetëm nga njëri, por nga të dy.

Për një martesë të filluar e të bazuar mbi standarde të arsyeshme siç thamë më lart, nuk ekziston asnjë bashkim forcash që mund ta shkatërrojë përveç fuqisë që ndodhet brenda vetë njerit ose të dy bashkëshortëve; dhe përgjithësisht përgjegjësia bie mbi ta. Njerëz të tjerë dhe shoqëria mund të ndikojnë për mirë ose për keq. Situatat financiare, shoqërore, politike ose situata të tjera mund të duket se ndikojnë në martesë; por martesë varet së pari dhe gjithmonë nga të dy bashkëshortët të cilët kanë gjithmonë mundësinë ta bëjnë martesën e tyre të suksesshme e të lumtur nëse janë këmbëngulës, vetëmohues dhe të drejtë.

Formula është e thjeshtë; elementët janë pak, megjithëse ekzistojnë shumë përforcues për secilin prej tyre.

Së pari, martesë duhet të konsiderohet me kujdes, gjë që përfshin meditimin për zgjedhjen e një bashkëshorti/bashkëshorteje që i afrohet sa më shumë të jetë e mundur kulmit të përsosjes në të gjitha ato gjëra që janë të rëndësishme për individët. Më pas ata të dy duhet të shkojnë para altarit të tempullit duke qenë të vetëdijshëm se duhet të punojnë fort për të pasur një bashkëjetesë të suksesshme.

Së dyti, duhet të ketë një vetëmohim të madh, një harrim të vetes dhe një drejtim të mbarë jetës familjare dhe çdo gjëje që i përket asaj, drejt së mirës së familjes, duke nënshtruar kështu vetveten.

Së treti, duhet të ketë korte të vazhdueshme dhe shprehje të vazhdueshme dashurie, mirësie e vlerësimi për ta mbajtur dashurinë gjallë dhe në rritje.

Së katërti, duhet të ketë një bindje të plotë ndaj urdhërimeve të Zotit siç i gjejmë të shkruara në ungjillin e Jezu Krishtit.

Me këto elementë të përzierë siç duhet dhe të vënë vazhdimisht në punë është e pamundur që të vijë trishtimi, mosmarrëveshjet të vazhdojnë, ose të ndodhin ndarje. Avokatëve të çështjeve të divorcive do t'iu duhet të kalojnë në fusha të tjera dhe gjykatat e divorcit do të jenë të kyçura.

Dy individët që i drejtohen altarit të martesës duhet ta kuptojnë se për të arritur martesën e lumtur për të cilën shpresojnë, ata duhet ta dinë se martesë nuk është një mburojë ligjore, por përfshin sakrificën, të qenit të gatshëm për të ndarë çdo gjë e madje pakësimin e disa prej lirive personale. Do të thotë të kursesh për një kohë të gjatë. Martesë do të thotë fëmijë që sjellin me vete barra financiare, barra që kanë të bëjnë me shërbimin, kujdesin, shqetësimin; por edhe emocionet më të thella e më të ëmbla mbi gjithçka tjetër.

Përpara martesës, secili individ është i lirë të bëjë ç'të dojë, ta organizojë dhe planifikojë jetën e vet si t'i duket më mirë, të marrë të gjitha vendimet duke menduar vetëm për veten. Të dashuruarit duhet ta kuptojnë para se të bëjnë betimet martesore se secili prej tyre duhet të pranojë saktësisht dhe plotësisht se e mira e familjes së vogël të sapokrijuar duhet të vijë gjithmonë mbi të mirën personale të bashkëshortëve. Secili nga bashkëshortët duhet ta eliminojë përdorimin e përemrit "unë dhe "i imi" duke i zëvendësuar me "ne" dhe "i yni." Çdo vendim duhet të marrë në konsideratë faktin se dy ose më shumë persona do të preken prej këtij vendimi. Ndërsa ajo tashmë vihet përballë vendimeve madhore, bashkëshortja mendon për efektet që këto vendime do të kenë mbi prindërit, fëmijët, shtëpinë dhe jetën e tyre shpirtërore. Zgjedhja e bashkëshortit në lidhje me punën e tij, jetën e tij shoqërore, miqtë dhe çdo interes i tij tani duhet të konsiderohet nën dritën e asaj se ai është vetëm një pjesë e familjes, se në fillim duhet të merret parasysh tërësia e grupit.

Një martesë mund të mos jetë gjithmonë e qetë dhe pa incidente, por megjithatë mund të ketë një paqe të madhe. Një çift mund të haset me varfëri, sëmundje, zhgënjime, dështime dhe madje edhe vdekje në familje, por as këto nuk do t'ua marrin paqen. Martesa mund të jetë e suksesshme për aq kohë sa egoizmi nuk hyn në të. Shqetësimet dhe problemet do t'i afrojnë më pranë bashkëshortët në një bashkim të pathyeshëm në qoftë se ekziston një vetëmohim i plotë. Gjatë krizës ekonomike të viteve 1930-të pati një rënie të theksuar të divorceve. Varfëria, dështimet, zhgënjimet — i lidhën më shumë bashkëshortët me njëri-tjetrin. Vështirësitë mund të betononjë marrëdhënie të cilat bollëku mund t'i shkatërrojë.

Martesa që bazohet mbi egoizmin është pothuajse e sigurtë se do të dështojë. Dikush që martohet për pasuri ose për prestigj apo shtresë shoqërore me siguri do të zhgënjehet. Dikush që martohet për të kënaqur krenarinë e vet ose që martohet për të inatosur një person tjetër apo për t'u mburrur, mashtron vetëm veten. Por ai që martohet për të falur dhe marrë lumturi, për të dhënë e marrë shërbim dhe që kujdeset për interesat e të dyve dhe më pas të familjes, do të ketë një mundësi të mirë për të pasur një martesë të lumtur.

Dashuria është si një lule, që ashtu si trupi, kërkon ushqim të vazhdueshëm. Trupi i vdeksuem shumë shpejt do të tretej dhe do të vdiste nëse nuk do të kishte ushqim të vazhdueshëm. Lulja e brishtë do të thahej e do të vdiste pa ushqim dhe ujë. Po kështu është edhe me dashurinë, nuk mund të presim që ajo të vazhdojë përgjithmonë në qoftë se nuk e ushqejmë vazhdimisht me racione dashurie,

manifestime vlerësimi e admirimi, shprehje mirënjohjeje dhe kujdesin për të qenë vetëmohues.

Është e sigurtë se vetëmohimi i plotë përbën një faktor tjetër në një martesë të suksesshme. Në qoftë se kërkojmë gjithmonë interesat, të mirën dhe lumturinë e tjetrit, dashuria që ekziston gjatë periudhës së njohjes dhe që betonohet në martesë do të marrë përmasa të mëdha. Shumë çifte lejojnë që martesa e tyre të bëhet bajate dhe dashuria e tyre të ftohet si një bukë e ndenjtur, si shaka të konsumuara apo si një gjellë e ftohur. Sigurisht ushqimet më jetësore për dashurinë janë interesimi, mirësia, vëmendja, kujdesi, shprehjet e dashurisë, përqaftimet e vlerësimit, admirimit, krenarisë, shoqërisë, mirëbesimit, besimit, partneritetit, barazisë dhe pavarësisë.

Për të qenë vërtetë të lumtur në martesë, duhet të kemi një bindje të vazhdueshme e besnike ndaj urdhërimeve të Zotit. Askush, i martuar ose i pamartuar, nuk ka qenë asnjëherë krejtësisht i lumtur pa qenë i drejtë. Ekzistojnë disa kënaqësi të përkohshme dhe situata të kamufluara për momentin, por lumturia e përhershme dhe e plotë mund të vijë vetëm nëpërmjet pastërtisë dhe denjësisë. Ai që ndjek një jetë fetare me bindje të thella fetare nuk mund të jetë kurrë i lumtur në një jetë joaktive. Ndërgjegjia do të vazhdojë ta mendojë, veçse po të jetë e fjetur, dhe nëse është kështu martesa është tashmë në rrezik. Një ndërgjegjje që vret mund ta bëjë jetën të padurueshme. Plogështia është shkatërruese për martesën, veçanërisht aty ku bashkëshortët janë të plogët në shkallë të ndryshme.

Ndryshimet fetare janë ndër më të mundimshmet dhe nga ndryshimet më të pazgjidhshme.

Martesa është shuguruar nga Perëndia. Ajo nuk është thjesht një traditë e shoqërisë. Pa një martesë të përshtatshme dhe të suksesshme, nuk mund të ekzaltohemi kurrë. Lexoni fjalët e Zotit tuaj, se të martohesh është një gjë e mirë dhe e drejtë.

Duke mbajtur këtë në mendje, shenjtori i kujdesshëm dhe inteligjent do ta planifikojë jetën e tij me kujdes për t'u siguruar që të mos ketë pengesa gjatë rrugës. Duke bërë një gabim të rëndë, ai mund të vendosë në udhën e tij pengesa që nuk mund të lëvizin kurrë dhe që mund t'ia bllokojnë rrugën drejt jetës së përfundimtare dhe perëndishmërisë — që është destinacioni ynë përfundimtar. Nëse dy njerëz e duan Zotin më tepër se jetën e tyre dhe e duan njëri-tjetrin më tepër se jetën e tyre, duke punuar së bashku në harmoni të plotë me programin e ungjillit si strukturën e tyre kryesore, ata mund të jenë të sigurtë se do ta kenë këtë lumturi të madhe. Kur një bashkëshort e bashkëshorte shkojnë shpesh së bashku në tempullin e shenjtë, gjunjëzohen në lutje së

bashku në shtëpinë e tyre dhe me familjen e tyre, shkojnë dorë për dorë në mbledhjet e kishës, e ruajnë jetën e tyre krejtësisht të dëlirë — mendërisht dhe fizikisht — në mënyrë që të gjitha mendimet dhe dëshirat dhe dashuria të jenë të përqendruara në një qenie, shokun/shoqen e tyre dhe që të dy të punojnë së bashku për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë, atëherë lumturia arrin kulmin.

Ndonjëherë në martesë ekzistojnë edhe besnikëri të tjera, megjithë faktin që Zoti tha: “Duaje bashkëshorten tënde me gjithë zemër dhe do të kapesh pas saj e pas askujt tjetër” (DeB 42:22).

Kjo do të thotë gjithashtu “Duaje bashkëshortin tënd me gjithë zemër dhe do të kapesh pas tij e pas askujt tjetër.” Shpesh, njerëzit vazhdojnë të kapen pas nënave e baballarëve të tyre dhe miqve të tyre. Ndonjëherë nënat nuk heqin dorë nga ndikimi që kanë pasur mbi fëmijët e tyre dhe bashkëshortët ashtu si bashkëshortet, kthehen tek nënat e baballarët e tyre për të marrë këshillë dhe për t’iu hapur zemrat, ndërkohë që duhet të kapen pas bashkëshortes së tyre për pjesën më të madhe të çështjeve dhe të gjitha intimitetet duhet të ruhen me fshehtësi të madhe nga të tjerët.

Çiftet do të bënin mirë që të gjenin menjëherë shtëpinë e tyre, të ndahen nga prindërit e tyre. Shtëpia mund të jetë shumë modeste dhe pa prete-ndime, por të paktën është një banesë e pavarur. Jeta

juaj martesore duhet të bëhet e pavarur nga familja e saj dhe familja e tij. Ju i doni ata më tepër se kurrë; e doni këshillën e tyre; e vlerësoni shoqërinë e tyre; por jetoni jetën tuaj, duke u qeverisur nga vetë vendimet tuaja, nga gjykimi juaj plot lutje pasi të keni marrë këshillë nga ata që duhet ta japin atë. Të kapesh nuk do të thotë thjesht të banosh në të njëjtën shtëpi; do të thotë të qëndroni pranë; të lidheni ngushtë me njëri-tjetrin.

“Si rrjedhim, është e ligjshme që . . . ata të dy duhet të jenë një mish, dhe kjo e gjitha, që toka të mund të përmbushë qëllimin e krijimit të saj;

Dhe që ajo të mund të mbushet me morinë e njerëzve, në përputhje me krijimin e tyre, përpara se bota të bëhet” (DeB 49:16-17).

Vëllezër e motra, mund të them se kjo është fjala e Zotit. Ajo është tepër, tepër serioze dhe askush nuk duhet ta kundërshtojë Zotin. Ai bëri tokën; Ai krijoi njerëzit. Ai i njeh rrethanat tona. Ai hartoi programin dhe ne nuk jemi aq inteligjent ose të zgjuar sa ta kundërshtojmë atë në këto gjëra të rëndësishme. Ai e di se çfarë është e drejtë dhe e vërtetë.

Ne ju kërkojmë të mendoni për këto gjëra. Sigurohuni që martesë juaj të jetë në rregull. Sigurohuni që jeta juaj të jetë në rregull. Sigurohuni që ta kryeni siç duhet pjesën tuaj në martesë.

Nga *Ensign*, mars 1977, faqe 3-5.

PËRGJIGJIA NDAJ SFIDAVE NË MARTESË

4

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Në artikullin e mëposhtëm, Plaku Lin G. Robins përshkruan një “recetë për shkatërrim.” Lexoni përshkrimin e tij në këtë faqe. Më pas krijoni një recetë për harmoni në shtëpi. Përcaktoni se cilët “përbërës” do të përfshini në një recetë të tillë.
- Zotohuni t’u përgjigjeni sfidave me durim dhe dashuri e jo me zemërim. Vendosni mbi diçka që mund të bëni që do t’jua kujtojë vazhdimisht këtë zotim. Për shembull, mund të vini një monedhë metalike ose një objekt tjetër të vogël në këpucë ose të mbani një shënim me vete në xhep.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

ZGJEDHJA E LIRË DHE ZEMËRIMI

Plaku Lin G. Robins
i të Shtatëdhjetës

Satani Nxit Zemërim në Familje

“Kam një familje k’tu në tokë. *Ata më duan shumë*” Kjo është shpresa e çdo fëmije, e shprehur në fjalët e një prej himneve tona (“Families Can Be Together Forever,” *Hymns*, no 300; germa kursive janë shtuar).

Ne mësojmë në proklamaten e familjes se “Familja është thelbësore në planin e Krijuesit” dhe se “Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin” dhe “një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi” (Familja: Një Proklamata drejtuar Botës, 35602 ose *Ensign*, nëntor 1995, 102).

Familja është gjithashtu shënjestra kryesore e Satanit. Ai i ka shpallur luftë familjes. Një nga taktikat e tij është mënyra tinzare dhe dinake që ai ka të depërtojë fshehtas prapa vijës së armikut dhe të hyjë në shtëpitë dhe jetët tona.

Ai dëmton dhe shpesh shkatërron familje brenda mureve të shtëpive të tyre. Strategjia e tij është të trazojë *zemërim* midis anëtarëve të familjes. Satani është “ati i grindjes dhe ai nxit zemrat e njerëzve, që të grinden me *zemërim* me njëri-tjetrin” (3 Nefi 11:29; germa kursive janë shtuar). Folja *nxit* ose *trazon* tingëllon si një recetë për shkatërrim. Vendoseni zemërimin në zjarr mesatar, trazoni në të disa fjalë

të zgjedhura dhe lëreni të ziejë; vazhdoni të trazoni deri sa masa të trashet; ftoheni; lërinin ndjenjat të ftohen për disa ditë; shërbejini të ftohta; do të ketë mjaft edhe për të mbetur.

Ne Mund të Zgjedhim të Mos Zemërohemi

Një pjesë e strategjisë së tij dinake është ta ndajë zemërimin nga zgjedhja e lirë, duke na bërë të besojmë se ne jemi viktimat të një emocioni që nuk mund ta kontrollojmë. Dëgjojmë të thuhet: “E humba gjakftohtësinë.” Humbja e gjakftohtësisë është një zgjedhje interesante fjalësh që ka filluar të bëhet një shprehje tepër e përdorur. Të “humbasësh diçka” nënkupton “që nuk kishe për qëllim,” “aksidentalisht,” “pa dashje,” “i papërgjegjshëm” — i pakujdesëm ndoshta por “jo i papërgjegjshëm.”

“Ai më ngriti nervat.” Kjo është një tjetër shprehje e dëgjuar që nënkupton mungesë kontrolli ose zgjedhje të lirë. Ky është një mit që duhet çmitizuar. Askush nuk na i ngre nervat. Të tjerët nuk na nxehin. Nuk ka asnjë llojë force në këtë mes. Të zemëroresh është një zgjedhje, një vendim i ndërgjegjshëm; kështu pra ne mund të zgjedhim të mos zemërohemi. Jemi *ne* ata që zgjedhim!

Atyre që thonë: “Nuk mund të përmbahem,” shkrimtari Uilliam Uilbanks u përgjigjet: “Gjepura.”

“Agresioni, . . . mbytyja e zemërimit, të flasësh rreth tij, të bërtasësh dhe të ulërasësh” të gjitha këto janë strategji të mësuara në trajtimin e zemërimit. Ne *zgjedhim* atë që ka provuar të jetë më efektiv për ne në të kaluarën. A e keni vënë re se sa rrallë e humbasim kontrollin kur zemërohemi me shefin, por

sa shpesh e humbasim atë kur irritohemi nga miqtë ose familja" ("The New Obscenity," *Reader's Digest*, dhjetor 1988, 24; germa kursive janë shtuar).

Në vitin e tij të parë të shkollës së mesme Uilbanks konkuroi për të hyrë në ekipin e basketbollit dhe u pranua. Në ditën e parë të stërvitjes, trajneri e vuri të luante në markim një me një ndërkohë që ekipi e shikonte. Kur humbi një gjuajtje të lehtë, u zemërua, përplasi këmbët dhe bërtiti. Trajneri iu afrua dhe i tha: "Bëje edhe një herë këtë që bëre dhe nuk do të luash më kurrë për ekipin tim." Gjatë tre viteve të tjera ai nuk e humbi kurrë më kontrollin. Disa vite më vonë, ndërsa po mendonte për këtë incident, e kuptoi se atë ditë trajneri i kish mësuar një parim që i ndryshoi jetën: zemërimi mund të kontrollohet (shih "The New Obscenity," 24).

Mësimet e Zotit

Në Përkthimin e Jozef Smithit të Efesianëve 4:26, Pali bën pyetjen: "A mund të zemëroheni dhe të mos mëkatoni?" Zoti është tepër i qartë në këtë çështje:

"Ai që ka shpirtin e grindjes nuk është i imi, por është i djallit i cili është ati i grindjes dhe ai nxit zemrat e njerëzve, që të grinden me zemërim me njëri-tjetrin.

Vini re, kjo nuk është doktrina ime, që të nxis zemrat e njerëzve në zemërim, njëri kundër tjetrit; por, doktrina ime është kjo, që gjëra të tilla duhet të zhduken" (3 Nefi 11:29-30).

Kjo doktrinë ose urdhërim nga Zoti nënkupton zgjedhjen e lirë dhe është një thirrje për mendjen e ndërgjegjshme që të marrë një vendim. Zoti pret që ne të zgjedhim të mos zemërohemi.

Zemërimi as nuk mund të justifikohet. Në Mateu 5, vargu 22, Zoti thotë: "Por unë po ju them: 'Kushdo që zemërohet *pa shkak* kundër vëllait të tij, do t'i nënshtrohet gjyqit'" (germat kursive janë shtuar). Sa interesant fakti që fraza "pa shkak" nuk gjendet në Përkthimin e frymëzuar të Jozef Smithit (shih Mateu 5:24), dhe as në versionin e 3 Nefi 12:22. Kur Zoti e eliminon frazën "pa shkak," Ai nuk na lë asnjë justifikim. "Por, doktrina ime është kjo, që gjëra të tilla duhet të zhduken" (3 Nefi 11:30). Ne mund "ta zhdukim" zemërimin, sepse kështu na ka mësuar dhe urdhëruar Ai.

Të Zemërohesh do të Thotë t'i Jepesh Ndikimit të Satanit

Të zemërohesh do të thotë t'i jepesh ndikimit të Satanit duke dorëzuar kështu vetë-kontrollin tonë. Mendimet mëkatore çojnë në ndjenja ose sjellje armiqësore. Zemërimi është ai që nxit sharjet në rru-

gë e autostrada kur jemi në timon, shpërthimet e dhunshme nëpër arenat sportive dhe dhunën në familje.

Po të mos kontrollohet, zemërimi mund të nxisë shpërthimin e fjalëve të egra dhe formave të tjera të abuzimit emocional që mund ta plagosin një zemër të butë. Është "ajo që del nga goja," tha Shpëtimtari që "e ndot njeriun" (Mateu 15:11).

David O. Mekei tha: "Bashkëshorti dhe bashkëshortja nuk duhet t'i flasin kurrë me tone të larta njëri-tjetrit, 'vetëm në rast se shtëpia po merr flakë'" (*Stepping Stones to an Abundant Life*, përmb. Llewelyn R. McKay [1971], 294).

Abuzimi fizik është zemërim i shfrenuar dhe nuk justifikohet asnjëherë dhe është gjithmonë i gabuar.

Zemërimi është një përpjekje e paqytetëruar për ta bërë tjetrin të ndihet fajtor ose një mënyrë mizore për t'u përpjekur ta korrigjosh atë. Ai shpesh keq-emërtohet si disiplinë, por gjithmonë është antiproduktiv. Prandaj shkrimet e shenjta paralajmërojnë: "Ju bashkëshortë, duajini bashkëshortet tuaja dhe mos u bëni të ashpër ndaj tyre," dhe "ju etër mos provokoni për zemërim bijtë tuaj, që të mos i lëshojë zemra" (Kolosianëve 3:19, 21).

"Nuk Do të Zemërohem Kurrë Më"

Zgjedhja dhe përgjegjshmëria janë parime të pandara. Duke qenë se zemërimi është një zgjedhje, në proklamaten e familjes gjendet një paralajmërim i rreptë se "individët . . . që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët, . . . do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë."

Të kuptuarit e lidhjes midis zgjedhjes së lirë dhe zemërimit është hapi i parë në eliminimin e zemërimit nga jeta jonë. Ne mund të zgjedhim të mos zemërohemi. Dhe ne mund të bëjmë këtë zgjedhje që sot, që tani: "Nuk do të zemërohem kurrë më." Meditoni për këtë vendim.

Seksioni 121-të i Doktrina e Besëlidhje është një nga burimet tona më të mira për të mësuar parime të sakta udhëheqjeje. Ndoshta seksioni 121 e gjen zbatimin e tij më të rëndësishëm tek bashkëshortët dhe prindërit. Ne duhet t'i drejtojmë familjet tona nëpërmjet bindjes, durimit, mirësjelljes, mirësisë, zemërbutesisë dhe dashurisë së pashtirur (shih DeB 121:41-42).

Uroj që të realizohet ëndrra e çdo fëmije që të ketë një familje këtu në tokë që ta dojë shumë.

Nga një fjalim i Plakut Robins në konferencën e përgjithshme të Kishës, prill 1998 (shih Conference Report, prill 1998, 105-6; ose *Ensign*, maj 1998, 80-81).

PËRGJIGJIA NDAJ SFIDAVE ME ANË TË KOMUNIKIMIT POZITIV

5

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Në artikullin e mëposhtëm që është caktuar për lexim, Plaku Xho J. Kristensen vëren: “Pak njerëz kanë ndryshuar për mirë si pasojë e kritikës dhe ankesës së vazhdueshme. Në qoftë se nuk jemi të kujdesshëm, ajo që ofrojmë si kritikë të *dobishme* është në fakt e *dëmshme*. Ndonjëherë, është më mirë t’i lëmë disa gjëra të pathëna” (shih 19). Gjatë javës së ardhshme, kushtojini vëmendje të kujdes-

shme atyre që mendoni dhe thoni për të tjerët. Përpiquni të jeni të sjellshëm dhe pozitivë në çdo gjë që thoni.

- Vëreni cilësitë e admirueshme tek bashkëshorti/bashkëshortja juaj. Bëni një listë të këtyre cilësive dhe ndajeni atë me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni e diskutoni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj

MARTESA DHE PLANI I MADH I LUMTURISË

Plaku Xho J. Kristensen
i të Shtatëdhjetës

Barbara dhe unë jemi bekuar me gjashtë fëmijë. Disa vite më parë, kur i morëm të gjithë me vete për të vizituar gjyshërit e tyre, im at më tha: “Xho, mendoj se ti dhe Barbara keni filluar diçka që nuk mund ta ndaloni.”

Në këtë kohë Pashkësh ne i shpallim mbarë botës se Jezusi është Krishti dhe se nëpërmjet priftërisë së Tij të shenjtë dhe fuqisë së saj vulosëse, martesat dhe familjet nuk kanë për të ndaluar kurrë — kurrë nuk do të përfundojnë.

Sot do të doja t’ju flisja rreth martesës. Po jap tetë sugjerime praktike të cilat, shpresoj, se mund të jenë të vlefshme për forcimin e martesave tona tani dhe në të ardhmen.

Kujtoni Rëndësinë e Martesës

1. Kujtoni rëndësinë kryesore të martesës suaj. Dëgjoni këto fjalë nga Plaku Brus R. Mekonki mbi rëndësinë e martesës në “planin e madh të lumturisë” të Atit Qiellor (Alma 42:8):

“Që nga çasti i lindjes në vdekshmëri deri në kohën që martohemi në tempull, çdo gjë që kemi në mbarë sistemin e ungjillit është që të na përgatisë dhe kualifikojë të hyjmë në atë rend të shenjtë të

martësës që na bën bashkëshort e bashkëshorte në këtë jetë dhe në botën që do të vijë . . .

Nuk ka asgjë në këtë botë më të rëndësishme se sa krijimi dhe përsosja e njëjësive familjare” (“Salvation Is a Family Affair,” *Improvement Era*, qershor 1970, 43-44).

Lutuni për Suksesin e Martesës Tuaj

2. Lutuni për suksesin e martesës tuaj. Disa vite më parë, kur ishte e zakonshme që një Autoritet i Përgjithshëm të vizitonte një mision dhe të intervistonte të gjithë misionarët, Plaku Spenser W. Kimbëll, në atë kohë anëtar i Kuorumit të të Dymbëdhjetëve, po bisedonte me një misionar që ishte në përfundim të misionit të tij.

“Elder, çfarë planesh ke pasi të lirohesh?”

“Oh, po planifikoj të vazhdoj universitetin.” Dhe me një buzëqeshje shtoi: “Më pas shpresoj të bie në dashuri dhe të martohem.”

Plaku Kimbëll ndau këtë këshillë të mençur: “Mos u lut vetëm që të martohesh me atë që do. *Përkundrazi, lutu që ta duash atë me të cilën do të martohesh.*”

Ne duhet të lutemi që të jemi më të dashur, më të sjellshëm, më të përlur, më të duruar, më të gatshëm për të falur dhe *veçanërisht*, më pak egoistë.

Me qëllim që të dallojmë problemet ose dobësitë tona personale që na pengojnë të jemi partnerë më

të mirë në martesë, ne duhet t'i drejtohem Zotit në lutje dhe të korrin të mirat e këtij premtimi të fuqishëm nga Libri i Mormonit: "Në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t'u tregoj atyre dobësinë e tyre. . . ; pasi në qoftë se ata përulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta" (Ethëri 12:27).

Kështu pra është e nevojshme të lutemi. Shumë udhëheqës të Kishës dhe këshillues martesorë vënë në dukje se nuk kanë parë asnjë martesë të ketë probleme serioze kur çifti lutet së bashku çdo ditë. Kur hasen me probleme dhe kur martesat kërcënohen, lutja së bashku si një çift mund të jetë ilaçi më i mirë.

Dëgjoni Bashkëshortin/Bashkëshorten Tuaj

3. Dëgjoni. Gjeneroni kohë të dëgjoni bashkëshortin/bashkëshorten tuaj; madje programoni ta bëni këtë rregullisht. Uluni dhe diskutoni me njëri-tjetrin se si po shkon martesa.

Vëllai Brent Barlou i bëri një pyetje një grupi vëllezërisht të priftërisë: "Sa nga ju do të donit të merrni një zbulësë?" Të gjithë ngritën dorën. Më pas ai sugjeroi që të shkonin që të gjithë në shtëpi dhe t'i pyesnin bashkëshortet e tyre se si mund të ishin bashkëshortë më të mirë. Ai shtoi: "E ndoqa këshillën time dhe pata një diskutim tepër informues me [bashkëshorten time] Suzanën për më tepër se një orë atë pasdite!" ("To Build a Better Marriage," *Ensign*, shtator 1992, 7). Një bisedë e tillë mund të jetë një zbulësë për çdonjërin nga ne.

A i ka ndodhur ndonjërit prej jush vëllezër që bashkëshortja t'ju thotë diçka të tillë si ajo që dëgjova jo shumë kohë më parë: "Xho, a po më dëgjon?" Ajo nuk ishte e vetmja që më pyeti nëse po e dëgjova. Para disa kohësh më kishte zënë gjumi dhe mbesa jonë e vogël Alison duke më ngritur njërin nga qepallat më tha: "Gjyshi, aty je?" Ne duhet të jemi "aty" për shokun/shoqen tonë dhe të tregohemi të ndjeshëm ndaj tyre.

Shmangni Ngacmimet e Vazhdueshme

4. Shmangni "ngacmimet e vazhdueshme." Mos jini tepër kritikues ndaj të metave të njëri-tjetrit. Kuptoni se askush nuk është i përkryer. Të gjithë ne kemi ende shumë rrugë për të bërë deri sa të bëhemi si Krishti dhe ashtu si na kanë nxitur udhëheqësit tanë.

"Ngacmimet e vazhdueshme," ashtu siç i quajti Presidenti Spenser W. Kimbëll, mund të dobësojnë pothuajse çdo martesë ("Marriage and Divorce," *1976 Devotional Speeches of the Year* [1977], 148). Në përgjithësi secili nga ne me dhimbje i njeh dobësitë e veta dhe nuk duam të na i kujtojnë vazhdimisht.

Pak njerëz kanë ndryshuar për të mirë si pasojë e kritikës dhe ankesës së vazhdueshme. Në qoftë se nuk jemi të kujdesshëm, ajo që ofrojmë si kritikë të *dobishme* është në fakt e *dëmshme*.

Ndonjëherë është më mirë që disa gjëra t'i lëmë të pathëna. Kur sapo ishte martuar, motra Lola Uollters lexoi në një revistë se për të forcuar martesën, çiftet duhet të kenë sesione të rregullta dhe të çiltra bashkëbisedimi gjatë të cilave të rendisin sjellje që i dukeshin të bezdisshme. Ajo shkroi:

"Duhej të renditnim pesë gjëra që na dukeshin të bezdisshme dhe unë ja fillova . . . I thashë se nuk më pëlqente se si e hante qitron. Ai e qëronte dhe e hante si portokall. Nuk njihja askënd ta hante qitron në atë mënyrë. A mund të pritët që një vajzë të kalojë gjithë jetën e madje përjetësinë duke e parë bashkëshortin e saj ta hajë qitron si një portokall? . . .

Pasi mbarova me [pesë gjërat e mia], ishte radha e tij të më thoshte se çfarë nuk i pëlqente rreth meje. [Ai] tha: 'Po të them të vërtetën nuk mund të mendoj për asnjë gjë që nuk më pëlqen te ty, e dashur.'

Mora frymë thellë.

U ktheva nga ana tjetër, sepse nuk e dija si t'i shpjegoja lotët që më mbushën sytë dhe më rridhnin faqeve."

Motra Uollter përfundon: "Sa herë që dëgjoj për çiftet e martuara të kenë mospërputhje, gjithmonë pyes veten nëse po vuajnë nga ajo që unë tani e quaj Sindroma e Qitros" ("The Grapefruit Syndrome," *Ensign*, prill 1993, 13).

Po, ndonjëherë është më mirë që disa gjëra t'i lëmë të pathëna.

Mbajini Gjallë Kortet

5. Mbajini gjallë kortet. Planifikoni kohë për të bërë diçka së bashku — vetëm ju të dy. Megjithatë është e rëndësishme të jeni me fëmijët dhe familjen, ju keni nevojë të kaloni kohë vetëm me njëri-tjetrin rregullisht çdo javë. Planifikimi i një kohe të tillë do t'u tregojë fëmijëve se ju e konsideroni shumë të rëndësishme martesën tuaj dhe se ju duhet ta ushqeni atë. Kjo kërkon angazhim, planifikim dhe programim.

Ajo që bëni nuk ka pse të jetë e kushtueshme. Koha që kaloni së bashku është elementi më i rëndësishëm.

Një herë vjehëri im po largohej nga shtëpia pas drekës për t'u kthyer në punë, vjehërra ime i tha: "Albert, kthehu shpejt këtu dhe më thuaj se me do." Ai buzëqeshi dhe me shaka i tha: "Elsi, kur u martuam të thashë që të doja dhe nëse kjo do të ndryshojë ndonjë herë, do të ta them." S'ka gjasa të përdoret me tepricë shprehja "të dua." Përdoreni atë çdo ditë.

Jini të Shpejtë që të Thoni “Më Fal”

6. Jini të shpejtë që të thoni “më fal.” Megjithëse mund të jetë e vështirë për të gjetur fjalët, jini të shpejtë të thoni “të kërkoj ndjesë, të lutem më fal,” edhe pse ju mund të mos jeni ai që e ka plotësisht fajin. Dashuria e vërtetë zhvillohet nga ata që janë gati t’i pranojnë menjëherë gabimet dhe fyerjet e tyre.

Kur ka mosmarrëveshje, është e rëndësishme t’i diskutoni dhe zgjidhni ato, por ka dhe raste kur është më mirë të heshtni. Të kafshosh gjuhën dhe të numërosh deri në dhjetë ose madje njëqind është e rëndësishme. Dhe herë pas here, ta lini diellin të perëndojë mbi zemërimin tuaj mund t’ju ndihmojë të jeni më të shlodhur për t’u përballur me problemin të nesërmen në mëngjes, më të qetë dhe me një mundësi më të mirë për të gjetur një zgjidhje.

Herë pas here dëgjojmë shprehje të tilla si: “Kemi pesëdhjetë vjet të martuar dhe kurrë nuk kemi pasur një mosmarrëveshje.” Në qoftë se është me të vërtetë kështu, atëherë njëri nga partnerët mbizotërohet nga tjetri, ose, siç tha dikush, njëri nga partnerët nuk e njeh të vërtetën. Çdo çift inteligjent do të ketë opinione të ndryshme. Sfida jonë është të jemi të sigurtë të dimë si t’i zgjidhim ato. Kjo është pjesë e procesit të të bërit të një martesë të mirë edhe më të mirë.

Jetoni Brenda Mundësive

7. Mësoni të jetoni brenda mundësive. Disa nga sfidat më të rëndësishme në martesë lindin nga financat. “Shoqata e Avokatëve të Amerikës . . . vuri në dukje se 89 përqind e të gjitha divorceve rezultojnë nga grindjet dhe akuzat rreth parave” (Marvin J. Ashton, “One for the Money,” *Ensign*, korrik 1975, 72). Jini të gatshëm të shtyni ose hiqni dorë nga bledhja e disa gjërave në mënyrë që të qëndroni brenda buxhetit tuaj. Së pari paguani të dhjetën dhe shmanjeni borxhin sa më tepër të jetë e mundur. Mbani mend se të shpenzosh pesëdhjetë dollarë më pak sesa merrni çdo muaj është baraz me lumturi dhe shpenzimi i pesëdhjetë dollarëve më tepër është baraz me mjerim. Mund të ketë ardhur koha të nxirrni gërshërët dhe kartat e kreditit dhe të kryeni atë që Plaku Xhefri R. Holland e quajti një lloj “kirurgjie plastike” (“Things We Have Learned — Together,” *Ensign*, qershor 1986, 30).

Ndani Përgjegjësitë në Shtëpi dhe Familje

8. Jini një partner i vërtetë për sa i përket përgjegjësisë në shtëpi dhe familje. Mos jini si ai bashkëshorti

që rri ulur dhe pret t’i shërbejnë, duke menduar se të fitojë para është detyra e tij e vetme dhe se vetëm gruaja e tij është përgjegjëse për shtëpinë dhe kujdesin për fëmijët. Detyra për t’u kujdesur për shtëpinë dhe familjen është më tepër se sa përgjegjësia e një personi.

Mbani mend se ju jeni në këtë partneritet së bashku. Barbara dhe unë kemi vënë re se mund ta rregullojmë shtratin së bashku çdo mëngjes në më pak se një minutë dhe është i rregulluar për gjithë ditën. Ajo thotë se më lejon ta bëj këtë që të më ndihmojë të ndihem mirë rreth vetes gjatë gjithë ditës dhe mendoj se ka të drejtë.

Gjeni kohë të studioni shkrimet e shenjta së bashku dhe ndiqni këtë këshillë të mirë nga Presidenti Kimbell: “Kur një burrë dhe një grua shkojnë shpesh së bashku në tempull, gjunjzohen në lutje së bashku në shtëpinë e tyre dhe me familjen e tyre, shkojnë dorë për dorë në mbledhjet e kishës, e mbajnë jetën e tyre krejtësisht të dëlirë, mendërisht dhe fizikisht, . . . dhe punojnë së bashku për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë, atëherë lumturia ka arritur kulmin” (*Marriage and Divorce* [1976], 24).

Së fundi:

- Kujtoni rëndësinë kryesore të martesës suaj.
- Lutuni për suksesin e saj.
- Dëgjoni.
- Shmangni “ngacmimet e vazhdueshme.”
- Mbajini gjallë kortet.
- Jini të shpejtë që të thoni “më fal.”
- Mësoni të jetoni brenda mundësive.
- Jini një partner i vërtetë për sa i përket përgjegjësisë në shtëpi dhe familje.

Unë dëshmoj se Jezusi është Krishti, se varri ishte bosh atë ditë të tretë dhe se “ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin” (1 Korintasve 15:22). Kështu me mirënjohje për fuqinë vulosëse që gjendet brenda ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit, mund të themi me besim bashkë me poeten: “Pas vdekjes edhe më shumë do të të dua” (Elizabeth Barrett Browning, *Sonnets from the Portuguese*, nr. 43, vargu 14).

Nga një fjalim i Plakut Kristensen në konferencën e përgjithshme të Kishës në prill 1995 (shih Conference Report, prill 1995, 84-87; ose *Ensign*, maj 1995, 64-66).

FORCIMI I MARTESËS NËPËRMJET BESIMIT DHE LUTJES

6

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Vendosni një gjë që mund të bëni për të forcuar besimin tuaj tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti.
- Vendosni një kohë të caktuar çdo ditë për t'u lutur me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni e diskutojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

TË GJEJMË GËZIM NË JETË

Plaku Riçard G. Skot
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Larmia midis Qëndrueshmërisë

Jo shumë kohë më parë qëndrova pranë bregut verior të një ishulli të bukur të Paqësorit duke soditur oqeanin në agim. U mahnita nga rregullsia me të cilën dallgët gjigande lëviznin pa pushim përpara deri sa thyheshin në breg. Kjo më kujtoi rregullsinë e planit të Zotit, me ligjin e tij të përjetshëm, të përcaktuar një herë e mirë, sigurinë e drejtësisë së pafund dhe mëshirës së dashur të fituar nëpërmjet bindjes. Vura re se çdo dallgë ngrihej në një pikë të ndryshme të horizontit deri sa e gjente shtegun e vet unik drejt bregut. Disa prej tyre përplaseshin mbi shkëmbinj, duke lënë rrëqe shkume të bardhë. Të tjerat thyheshin në breg secila sipas modelit të vet. Ato rrëshkisnin lozonjare mbi rërën e lagur duke u shkumëzuar në breg e më pas tërhiqeshin duke krijuar fluska e vorbulla.

Mendova për larminë e pafund të mundësive që Zoti na ka dhënë. Ne kemi kaq shumë liri, kaq shumë mundësi për të zhvilluar personalitetin dhe talentet tona unike, kujtimet tona individuale dhe kontributet tona të personalizuar. Duke qenë se më vonë nuk do të kisha mundësi për të vështruar oqeanin madhështor, u përpoqa të imagjinoja pamjen e lavdishme që do të krijonte më vonë dielli i ndritshëm. Teksa vështroja këtë skenë të mrekullueshme me nderim, një dritare u krijua mes reve; rrezet e ndritshme të diellit që po lindte depërtuan përmes qiellit të vrenjtur, duke transformuar çdo gjë me shkëlqimin e tij, ngjyrën e tij, jetën e tij. Ishte sikur Zoti donte të ndante një bekim tjetër, një simbol

të dritës së mësimave të Tij që i jep ndriçim e shpresë kujt do që prek. Sytë m'u mbushën me lotë mirënjohjeje për këtë botë të mrekullueshme në të cilën jetojmë, për bukurinë e jashtëzakonshme që Ati ynë Qiellor ndan kaq bujarisht me të gjithë ata që janë të gatshëm ta shohin atë. Me të vërtetë, jeta është e bukur.

Vlerësoni Bukurinë e Jetës

A gjeni kohë çdo ditë për të zbuluar sa e bukur mund të jetë jeta juaj? Sa kohë ka kaluar që kur keni soditur përdimin e diellit — rrezet në arrati duke i dhënë puthjen e natës së mirë reve, pemëve, kodrave e fushave, ndonjëherë qetësisht, ndonjëherë me shpërthime të gjalla ngjyrash e formash?

Po mrekullinë e një nate pa re kur Zoti zbulon mrekullitë e qiejve të Tij — yjet vezullues, rrezet e hënës — për t'i dhënë krah imagjinatës sonë me madhësinë dhe lavdinë e Tij?

Sa mahnitëse të shikosh një farë të mbjellë në një tokë pjellore të mbijë, të marrë forcë dhe të lëshojë një filiz të vogël dhe në dukje të parëndësishëm. Me durim ai fillon të rritet dhe të krijojë karakterin e vet, sipas kodit gjenetik që Zoti i ka dhënë për të drejtuar zhvillimin e tij. Me kujdesin e duhur ai me siguri do të bëhet çka ishte paracaktuar të bëhej: një zambak, i kurorëzuar me hir e bukuri; një bimë mente aromatike; një pjeshkë; një avokado; ose një lule e bukur me një brishtësi, ngjyrë dhe aromë të veçantë.

Kur ka qenë hera e fundit që keni vështruar të krijohet një gonxhe trëndafil? Çdo ditë kjo gonxhe zhvillon një karakter të ri dhe mbresëlënës, një premtim më të madh për bukuri deri sa të bëhet një trëndafil madhështor.

Ju jeni një ndër krijimet më fisnike të Perëndisë. Qëllimi i Tij është që jeta juaj të jetë madhërisht e bukur pavarësisht nga rrethanat tuaja. Kur jeni mirënjohës dhe të bindur, mund të bëheni gjithçka që Perëndia ka caktuar të jeni.

Gëzimi në Jetë Varet nga Besimi në Perëndi

Trishtimi, zhgënjimi dhe sfidat e rënda janë *ngjarje* në jetë, jo vetë jeta. Nuk e minimizoj atë se sa të rënda mund të jenë disa prej këtyre ngjarjeve. Ato mund të zgjasin për një periudhë të gjatë, por nuk duhet të lejoni që ato të bëhen qendra kufizuese e çdo gjëje që bëni. Zoti e frymëzoi Lehin të shpallte të vërtetën themelore: “Njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim”. Kjo fjali është në kushtore: “ata mund të kenë gëzim.” Por ajo nuk është në kushtore për Zotin. Qëllimi i Tij është që secili nga ne të gjejë gëzim. Nuk do të jetë kushtore për ju po t’i bindeni urdhërimeve, të keni besim te Mësuesi dhe të bëni ato që janë të domosdoshme për të pasur gëzim këtu në tokë.

Gëzimi juaj në jetë varet nga besimi që keni në Atin Qiellor dhe Birin e Tij të shenjtë, nga bindja juaj se plani i tyre i lumturisë mund t’ju sjellë vërtetë gëzim. Meditimi rreth doktrinës së tyre do t’ju ndihmojë të gëzoni bukuritë e kësaj toke dhe do të pasurojë marrëdhëniet tuaja me të tjerët. Do t’ju çojë drejt përvojave ngushëlluese e forcëdhënëse që rrjedhin nga lutja drejtuar Atit në Qiell dhe përgjigjeve që Ai ju jep në kthim.

Këndvështrimi dhe Durimi

Kur një guralec e mbajmë afër syve na duket një pengesë gjigande. Po ta hedhim në tokë, e shikojmë në një këndvështrim tjetër. Po kështu, problemet ose sprovat në jetë duhen parë në këndvështrimin e doktrinës së shkrimeve të shenjta. Përndryshe ato fare mirë mund të na e errin vizionin, të na shterrojné energjinë dhe të na privojné gëzimin dhe bukurinë që Zoti ka për qëllim që ne të marrim këtu në tokë. Disa njerëz janë si gurë të hedhur në një det problemesh. Ata janë të mbytur prej tyre. Jini si një tapë. Kur jeni të zhytur në një problem, luftoni të jeni të lirë që të dilni sërish në sipërfaqe për të shërbyer përsëri me lumturi.

Ju jeni këtu në tokë për një qëllim hyjnor. Ky qëllim nuk është që të argëtoheni pafund ose të jeni vazhdimisht duke rendur pas kënaqësisë. Ju jeni këtu për t’u provuar, për ta provuar veten që të mund të merrni bekimet e tjera që Perëndia ka për ju². Kërkohet efekti zbutës i durimit³. Disa bekime do të jepen këtu në këtë jetë, të tjerat do të vijnë përtej velit.

Zoti ka për qëllim rritjen dhe zhvillimin tuaj personal. Ky përparim përshpejtohet kur ju me dëshirë

e lejoni Atë t’ju udhëheqë përmes çdo përvoje rritjeje me të cilën përballeni, edhe nëse mund t’ju pëlqejë ose jo në fillim. Kur keni besim te Zoti, kur jeni të gatshëm ta lini zemrën dhe mendjen të përqendrohet në vullnetin e Tij, kur i kërkoni të drejtoheni nga Shpirti për të bërë vullnetin e Tij, atëherë siguroheni për lumturinë më të madhe gjatë udhës dhe arritjen më të kënaqshme nga kjo përvojë në vdekshmëri. Nëse e vini në dyshim çdo gjë që ju është kërkuar të bëni, ose i rezistoni çdo sfidë të pakënaqshme, atëherë e bëni më të vështirë për Zotin që t’ju bekojë⁴.

Zgjedhja juaj e lirë, e drejta për të bërë zgjedhje, nuk ju është dhënë që të merrni atë që doni. Kjo dhuratë hyjnore është dhënë që ju të zgjidhni atë që Ati në Qiell dëshiron për ju. Në këtë mënyrë Ai mund t’ju udhëheqë që të bëheni gjithçka që Ai dëshiron të bëheni⁵. Ky shteg ju çon drejt gëzimit dhe lumturisë së lavdishme.

Jetoni me Gëzim midis Vështirësive

Mësoni nga ata njerëz frymëzues që kanë bërë paqe me sfidat e tyre dhe jetoni me gëzim midis vështirësive. Një grua e bukur që vuante nga një sëmundje e rëndë vdekjeprurëse gjeti vazhdimisht gëzim në jetë. Ajo e kuptoi planin e lumturisë, kishte marrë ordinancat e tempullit dhe po përpiquej me gjithë fuqinë e saj për të qenë e denjë për bekimet e premtuara. Në ditarin e saj personal shkruhet:

“Është një ditë e bukur vjeshte. Mora postën dhe u ula në lisharse. Ndihesha kaq e lumtur dhe e kënaqur nën diellin e ngrohtë, mes aromës së ëmbël të natyrës dhe pemëve përreth. Ndenja ashtu ulur dhe u mrekullova nga fakti që jam ende gjallë në këtë tokë të bukur . . . Zoti është kaq i mirë me mua. Sa shumë e falënderoj që jam ende këtu dhe që ndihem kaq mirë. Jam aq e lumtur sa dua të bërtas dhe të kërcëj nëpër këtë shtëpi të bukur ndërsa dielli derdhet përmes dritareve të mëdha. E dua jetën.”

Një nënë e guximshme që po luftonte me kurajo me një sëmundje të rëndë kaloi orë të tëra duke punuar për të përfunduar një punë të vështirë me grep. Ajo ishte një dhuratë për një çift në vështirësi. Për atë çift ajo do të jetë një thesar i shtrenjtë, që do t’i kujtojë vazhdimisht për frutet e çmuara të një përpjekjeje të vendosur përballë vështirësisë, një mesazh i përhershëm shprese i endur në fijet e dashurisë së pastër dhe sakrificës së vullnetshme.

Gjeni Gëzim në Atë që Keni

Fëmijët na mësojnë si të gjejmë gëzim madje nën rrethanat më sfiduese. Fëmijët nuk kanë mësuar ende të jenë të dëshpëruar duke u përqendruar në gjërat që nuk kanë. Ata gjejné gëzim në atë që tashmë kanë. Më kujtohet një djalë i vogël që po luante në breg të lumit. Ai kishte lidhur një filispanjë në

fundet e dy kanoçeve bosh. Ai e hodhi njëren nga kanoçet mbi një degë, më pas e mbushi atë me ujë. Njëren nga kanoçet e tërhiqte dhe më pas e lëshonte. Pesha e kanoçes së parë ndërsa binte në tokë e ngrinte lart të dytën. Ai qeshte dhe kërcente gjithë hare.

Përvoja të thjeshta e ripërtëritëse na rrethojnë. Ato mund të jenë valvula sigurie për të mbajtur prisionin e ulët dhe shpirtin lart. Mos u përqendroni në ato që nuk keni ose që keni humbur. Zoti i ka premtuar të bindurit se do të ndajë gjithçka që Ai ka me ta. Ju mund t'ju mungojnë përkohësisht disa gjëra këtu, por në jetën tjetër, nëse e provoni veten të denjë duke jetuar me guxim, plotësia e bekimeve do të jetë e juaja.

Gjeni bekimet kompensuese në jetë kur, në urtësinë e Tij, Zoti ju privon disa gjëra që ju i dëshironi aq shumë. Të verbërit ose të shurdhit, Ai i forcon shqisat e tjera. Të sëmurit, i jep durim, kuptim dhe vlerësim më të madh për mirësinë e të tjerëve. Kur humbasim një njeri të dashur, Ai thëllon lidhjet e dashurisë, pasuron kujtimet dhe ndez shpresën për një ritakim të ardhëm. Ju do të zbuloni bekime kompensuese kur e pranoni me dëshirë vullnetin e Zotit dhe ushtroni besim në Të⁶.

Popullit të munduar të Almës, Zoti i tha:

“Dhe unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat . . . që ju të mos i ndjeni në shpinat tuaja. . . ; dhe këtë do ta bëj që ju të qëndroni si dëshmitarë për mua në të ardhmen dhe që ju të dini me siguri se unë, Zoti Perëndi, i vizitohet njerëzit e mi në pikëllimet e tyre.

Dhe . . . barrat . . . u lehtësuan; po, Zoti i forcoi ata që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtruan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit”⁷.

Të Qenit Krijues do t’ju Ndhimojë ta Gëzoni Jetën

Përpiquini të jini krijues, për hir të gëzimit që sjell një gjë e tillë. Pasi bashkëshortët e tyre fisnikë kaluan në jetën tjetër, motra Kamila Kimbëll, Amelia Mekonki dhe Helen Riçards mësuuan të pikturonin. Kështu ato jo vetëm po lënë pas një trashëgimi artistike, por kurrë më nuk do ta shikojnë në të njëjtën mënyrë një perëndim dielli, një fytyrë apo një pemë. Tashmë ato dallojnë nuanca të lehta ngjyrash dhe formash dhe gëzohen në bukurinë e pasur që i rrethon.

Zgjidhni diçka si muzika, kërcimi, skulptura ose poezia. Të qenit krijues do t’ju ndihmojë ta gëzoni jetën. Do të bëjë të lindë shpirti i mirënjohjes. Të qenit krijues zhvillon talentin e fshehur, mpreh aftësinë tuaj për të arsyetuar, vepruar dhe për të gjetur qëllim në jetë. Largon vetminë dhe dëshpërimin. Të jep një ripërtëritje, një shkëndijë entuziazmi dhe zelli për jetën.

Shërbimi: Një Çelës për Lumturi

Shërbimi i etur ndaj të tjerëve është çelësi i lumturisë që zgjat. Presidenti Spenser W. Kimbëll tha: “Perëndia na shikon dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që ai i plotëson nevojat tona. Prandaj, është jetësore që t’i shërbejmë njëri-tjetrit”⁸.

Njoh një grua që ishte gjithmonë e lumtur. Çdo mëngjes ajo i lutej Atit të saj në Qiell që ta drejtonte tek dikush që ajo mund ta ndihmonte. Ajo lutje e sinqertë mori përgjigje herë pas here. Barrërat e shumë njerëzve u lehtësuan dhe jeta e tyre u ndriçua. Ajo vetë u bekua vazhdimisht, sepse u bë një mjet i drejtuar nga Zoti.

Vështirësia Mund të Kthehet në Rritje

Unë e di se vështirësitë që ndeshim në jetë, madje edhe ato që vijnë nga vetë pakujdesia jonë ose madje nga shkeljet tona, mund të kthehen nga Zoti në përvoja rritjeje, një shkallë e vërtetë që të çon lart⁹. Unë sigurisht nuk e rekomandoj shkeljen si një rrugë drejt rritjes. Është e dhimbshme, e vështirë dhe krejt e panevojshme. Është shumë më e mençur dhe shumë më e lehtë të ecim përpara në drejtësi. Por nëpërmjet pendimit të duhur, besimit në Zotin Jezu Krisht dhe bindjes ndaj urdhërimeve të Tij, madje dhe zhgënjimi që vjen nga shkelja mund të shndërrohet në një rikthim në lumturi.

Bëni një listë të gjërave që mund të bëni për lumturinë, të tilla si:

- Meditoni shkrimet e shenjta për të kuptuar planin e lumturisë.
- Lutuni me besim në Jezu Krisht.
- Duajini dhe shërbejuni të tjerëve.
- Merrni ordinancat e tempullit. Kthehuni aty për të bekuar të tjerët.
- Dëgjoni profetin dhe bindjuni këshillës së tij.
- Jini mirënjohës për atë që keni.
- Buzëqeshni më shumë.

Lista juaj do t’ju japë çelësat e kënaqësisë dhe gëzimit.

Sfida Është e Përkohëshme, por Lumturia Është e Përvetshme

Një këngë e famshme braziliane përsërit një ide të rreme që e besojnë shumë vetë. Trishtimi nuk mbaron kurrë, por lumturia mbaron. Unë dëshmoj se me besim të Shpëtimtari dhe bindja ndaj mësimave të Tij, lumturia nuk mbaron kurrë, por trishtimi mbaron.

Pavarësisht sa e vështirë mund të jetë diçka me të cilën po përballeni ju ose një njeriu juaj i dashur, ajo nuk duhet t'ju pushtojë jetën dhe të jetë qendra e gjithë interesit tuaj. Sfidat janë përvoja rritjeje; skena të përkohëshme për t'u luajtur në sfondin e një jete të këndshme. Mos u jepni aq shumë pas një ngjarjeje të vetme sa që nuk mund të mendoni për asgjë tjetër ose të mos kujdeseni për veten apo për ata që varen nga ju. Mbani mend, po ashtu si kurimi i trupit, shërimi i disa sfidave shpirtërore dhe emocionale kërkon kohë.

Zoti ka thënë: "Ji i duruar në mundime, sepse do të kesh shumë; por duroji ato, pasi, vër re, unë jam me ty, madje deri në mbarim të ditëve të tua"¹⁰. Kur jeni të duruar, do të arrini të kuptoni se ç'do të thotë shprehja "jam me ty." Dashuria e Perëndisë sjell paqe e gëzim.

Besimi juaj në Jezu Krisht i jep jetës kuptim të pafund. Mbani mend ju jeni në një udhëtim drejt ekzaltimit. Ndonjëherë keni përvoja që falin më te-

për lumturi se të tjerat, por çdo gjë ka një qëllim për Zotin¹¹.

Si një dëshmitar i Shpëtimtarit, unë ju nxis të falni ata që mund t'ju kenë lënduar. Në qoftë se keni kryer shkelje, pendohuni për të, që Mësuesi të mund t'ju shërojë.

Falënderoni Atin tuaj në Qiell dhe Birin e Tij të Dashur për planin e lumturisë dhe parimet e ungjillit mbi të cilat është bazuar. Jini mirënjohës për ordinancat dhe besëlidhjet që ata ju kanë dhënë. Unë dëshmoj solemnisht se ata kanë fuqi për ta kurorëzuar jetën tuaj me paqe e gëzim, për t'i dhënë asaj qëllim dhe kuptim. Ju do të mësoni se trishtimi dhe zhgënjimi janë të përkohshëm. Lumturia është përjetësisht e përjetshme për shkak të Jezu Krishtit. Unë dëshmoj solemnisht se Ai jeton, se Ai ju do dhe se Ai do t'ju ndihmojë.

Nga një fjalim i Plakut Skot në konferencën e përgjithshme të Kishës në prill 1996 (shih Conference Report, prill 1996, 31-35; ose *Ensign*, maj 1996, 24-26).

SHËNIME

1. 2 Nefi 2:25.
2. Shih Abrahami 3:25.
3. Shih Mosia 3:19.
4. Shih 1 Nefi 3:7.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 58:26-32.
6. Shih Orson F. Whitney, cituar në Spencer W. Kimball, *Faith Precedes the Miracle* (1972), 98.
7. Mosia 24:14-15.
8. *The Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball (1982), 252.
9. Shih Isaia 40:31.
10. Doktrina e Besëlidhje 24:8.
11. Shih Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, bot. 5-të (1939), 177.

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Studioni shembujt e faljes në fragmentet e mëposhtme të shkrimeve të shenjta: Lluka 23:33-34; Veprat e Apostujve 7:58-60; 1 Nefi 7:8-21.
- Zotohuni të jeni më të gatshëm për të falur dhe më të denjë për faljen e të tjerëve.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni e diskutojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

“NGA JU KËRKOHEM T’I FALNI TË GJITHË”

Presidenti Gordon B. Hinkli
Këshilltar i Parë në Presidencinë e Parë

Një shpirt faljeje dhe një qëndrim me dashuri e dhembshuri ndaj atyre që mund të na kenë lënduar është esenca e vërtetë e ungjillit të Jezu Krishtit. Secili nga ne ka nevojë për këtë shpirt. Mbarë bota ka nevojë për të. Zoti na e mësoi atë. Ai e mishëroi atë si nuk e ka mishëruar askush tjetër.

Në kohën e agonisë së Tij në kryqin e Kalvarit, me akuzuesit e ligjit të urryer para Tij, ata që e kishin dënuar me këtë kryqëzim të tmerrshëm, Ai thirri: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë” (Lluka 23:34).

Asnjërit nga ne nuk i është kërkuar të falë kaq bujarisht, por secili prej nesh është nën një detyrim hyjnor për të zgjatur dorën e faljes dhe mëshirës. Zoti ka shpallur në fjalët e zbulesës: “Dishepujt e mi, në ditët e lashta, kërkuan rast kundër njëri-tjetrit dhe nuk e falën njëri-tjetrin në zemrat e tyre; dhe për këtë ligësi ata u brengosën dhe u ndëshkuan reptësisht.

Prandaj, unë ju them se ju duhet ta falni njëri-tjetrin; sepse ai që nuk ia fal shkeljet vëllait të tij, mbetet i dënuar përpara Zotit; sepse atij i ngelet mëkati më i madh.

Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit.

Dhe ju duhet të thoni në zemrat tuaja — Perëndia duhet të gjykojë midis meje dhe teje dhe të shpërblejë sipas veprave të tua” (DeB 64:8-11).

Sa shumë nevojë kemi për zbatimin e këtij parimi të dhënë nga Perëndia dhe parimit shoqëruar të tij, pendimit! E shikojmë nevojën për të në shtëpitë e njerëzve, aty ku përgjethet e vogla të keqkuptimit fryhen në male grindjesh. E shikojmë midis fqinjëve, kur mosmarrëveshje të parëndësishme çojnë në urrejtje të pafund. E shohim midis kolegëve të biznesit që grinden e nuk pranojnë të bien në kompromis dhe të falin kur, në pjesën më të madhe të rasteve, në qoftë se do të kishte një vullnet të mirë për t’u ulur së bashku dhe për t’i folur me qetësi njëri-tjetrit, çështja do të mund të zgjidhej në të mirë të të gjithëve. Përkundrazi, ata kalojnë ditë të tëra duke ushqyer mëri dhe duke planifikuar hakmarrje.

Gjatë vitit të parë të organizimit të Kishës, kur Profeti Jozef Smith u arrestua vazhdimisht dhe u gjykua mbi akuza të rreme nga ata që kërkonin ta dëmtonin, Zoti i tha atij nëpërmjet zbulesës: “Dhe kushdo që do të shkojë në gjyq ndaj jush, do të dënohet nga ligji” (DeB 24:17). E kam parë këtë në kohën tonë midis disa prej atyre që kanë ndjekur me shpirt hakmarrës meritë e ushqyera. Madje edhe midis disa prej atyre që e fitojnë çështjen duket se ka pak paqe të mendjes, e ndërsa mund të kenë fituar para, kanë humbur diçka më të çmuar.

Shmangeni Zemërimin

Gi de Mopasan, shkrimtari francez, tregon historinë e një fshatari të quajtur Hoshkom i cili shkoi në fshat ditën e pazarit. Ndërsa po ecte nëpër sheshin publik, sytë i zunë një copë spangoje që kishte rënë në kalldrëm. E mori dhe e futi në xhep. Kjo u vu re nga samarxhiu i fshatit, me të cilin ai kishte pasur një debat para disa kohësh.

Më vonë po atë ditë u raportua një çantë e humbur. Hoshkom u arrestua i akuzuar nga samarxhiu. E çuan para kryeplakut, para të cilit ai protestoi për pafajsinë e tij, duke i treguar copën e spangos që kishte gjetur. Por nuk e besuan dhe u tallën me të.

Të nesërmen çanta u gjet dhe Hoshkomin e liruan nga të gjitha akuzat. Por, i zemëruar nga poshtërimi që kishte pësuar për shkak të një akuze të rreme, ai u mbush me mllef dhe nuk donte ta harronte atë që kish ndodhur. Duke mos qenë i gatshëm të falte dhe të harronte, ai nuk mendonte dhe nuk fliste për asgjë tjetër. E la pas dore fermën e tij. Kudo që shkonte, këdo që takonte do t'i fliste patjetër për këtë padrejtësi. Ditë e natë e bluante në mendje. I fiksuar pas zemërimit të tij, ai u sëmur rëndë dhe vdiq. Në delirin e vuajtjeve të vdekjes, ai mërmëriste vazhdimisht: "Një copë spango, një copë spango" (*The Works of Guy de Maupassant* [n.d.], 34-38).

Po të ndryshojmë personazhet dhe rrethanat, kjo histori mund të përsëritet shumë herë në kohën tonë. Sa e vështirë është për secilin nga ne të falim ata që na kanë lënduar. Të gjithë priremi të mos i harrojmë të ligat që na kanë bërë. Kjo kthehet në një kangrenë brejtëse e shkatërruese. A ka ndonjë virtut që duhet ta zbatojmë më tepër në kohën tonë sesa virtytin e faljes dhe harresës? Ka nga ata që do ta konsideronin këtë si shenjë dobësie. A është e tillë? Mendoj se nuk kërkon as forcë e as inteligjencë të bluash në mendje me zemërim padrejtësitë që ke kaluar, ta kalosh jetën me një shpirt hakmarrjeje, të shkosh dëm aftësitë e tua për të planifikuar hakmarrjen. Nuk ka paqe kur ruajmë brenda vetes mërira. Nuk ka lumturi të jetosh për ditën që do të marrësh hak.

Pali flet për "elementet e dobët dhe të varfër" të jetës sonë (shih Galatasve 4:9). A ka ndonjë gjë më të dobët ose më të varfër sesa prirja për ta kaluar jetën në një rreth të pafund mendimesh urrejtjeje dhe duke thurur makinacione ndaj atyre që mund të na kenë fyer?

Jozef F. Smith e drejtoi Kishën në kohën e një urrejtjeje të madhe ndaj njerëzve tanë. Ai ishte shënjestra e akuzave të liga, e një vargu të pafund kritikash të gazetarëve madje edhe në komunitetin e tij. Atë e satirizuan, e paraqitën në karikatura dhe e vunë në lojë. Dëgjoni përgjigjen e tij ndaj atyre që e kthyen në lojë poshtërimin e tij: "Mos i ngacmoni. Le të bëjnë ç'të duan. Jepuni lirinë e fjalës që e duan aq shumë. Le të tregojnë historinë e tyre dhe të shkruajnë fatin e tyre" (*Gospel Doctrine*, boimi i 5-të [1939], 339). Dhe më pas me një shpirt të madh faljeje dhe harrimi, ai eci më tej në punën e madhe e të vërtetë të çuarjes përpara të Kishës drejt një rritjeje të re dhe arritjesh të mrekullueshme. Në kohën e

vdekjes së tij, shumë prej atyre që e kishin vënë në lojë shkruan me nderim e lavde për të.

Më kujtohet një herë kur dëgjova gjërë e gjatë një çift që ishin ulur përballë meje. Kishte zemërim mes tyre. E di se dikur dashuria e tyre ishte e thellë dhe e vërtetë. Por secili kishte krijuar zakonet e të folurit për të metat e tjetrit. Pa qenë të gatshëm të falnin ato lloj gabimesh që bëjmë të gjithë, pa dashur t'i harrojnë ato dhe t'i mposhtin ato me durim, ata grindeshin me njëri-tjetrin deri sa dashuria që kishin dikur ishte mbytur. Ish kthyer në hi me vendimin e ashtuquajtur divorc "pa faj." Tani ka mbetur vetëm vetmia dhe akuzat. Jam i bindur se po të kishte pasur madje një grimë të vogël pendimi dhe faljeje, ata do të ishin ende së bashku, duke gëzuar shoqërinë me të cilën ishin bekuar aq shumë dikur.

Paqe Nëpërmjet Faljes

Nëse ka ndonjë që ushqen në zemrën e vet tharmin helmues të armiqësisë ndaj të tjerëve, unë ju përgjerohem t'i luteni Zotit t'ju japë forcë për të falur. Shprehja e dëshirës për të falur do të jetë thelbi i pendimit tuaj. Mund të mos jetë e lehtë dhe mund të mos vijë shpejt. Por nëse e kërkon me sinqeritet dhe e kultivoni atë, ajo do të vijë. Edhe pse ai që ju keni falur vazhdon t'ju ndjekë dhe kërcënojë, ju do ta dini se keni bërë sa mundët për të arritur në një mirëkuptim. Në zemrën tuaj do të vijë një paqe që përndryshe nuk do ta kishit kurrë. Ajo do të jetë paqja e Atij që tha:

"Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t'ju falë edhe juve;

por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t'ua falë juve gabimet tuaja" (Mateu 6:14-15).

Djali Plangprishës

Unë nuk njoh ndonjë histori më të bukur në mbarë literaturën se ajo që gjendet në kapitullin e pesëmbëdhjetë të Llukës. Është historia e një djali të penduar dhe një ati të gatshëm për të falur. Është historia e një djali që e humbi trashëgiminë e tij duke bërë një jetë të shturur, duke flakur këshillën e të atit, duke përbuzur ata që e donin. Kur i kishte shpenzuar të gjitha, mbeti i uritur dhe pa miq dhe "atëherë erdhi në vete" (Lluka 15:17), ai u kthye tek i ati, i cili sapo e pa nga larg "u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi" (Lluka 15:20).

Ju kërkoj ta lexoni atë histori. Çdo prind duhet ta lexojë atë herë pas here. Ajo është tepër e madhe sa të përfshijë çdo shtëpi dhe shumë më e madhe se aq, madje sa të përfshijë mbarë njerëzimin, sepse a nuk jemi ne të gjithë bijë e bija plangprishëse që kanë

nevojë të pendohen dhe të marrin mëshirën falëse të Atit tonë Qiellor dhe më pas të ndjekin shembullin e Tij?

Biri i Tij i Dashur, Shëlbuesi ynë, na shtrin dorën e faljes dhe mëshirës, por duke e bërë këtë Ai na urdhëron të pendohemi. Shpirti i vërtetë dhe bujar i faljes do të bëhet shprehja e pendimit që kërkohet. Zoti tha — dhe po citoj nga një zbulesë dhënë Profetit Jozef:

“Prandaj unë të urdhëroj të pendohesh — pendohu, përndryshe unë të godas me shufrën e gojës sime dhe me zemërimin tim, dhe me indinjatën time, dhe vuajtjet e tua do të jenë të ashpra — sa të ashpra ti s’e di, sa therëse ti s’e di, po, sa të vështira për t’u duruar ti s’e di.

Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt . . .

Mëso nga unë dhe dëgjoji fjalët e mia; ec në butësinë e Shpirtit tim dhe ti do të kesh paqe në mua” (DeB 19:15-18, 23).

Ky është urdhërimi dhe ky është premtimi i Atij që, në lutjen e Tij shembullore, u përgjërua: “At[ë] . . . na i fal fajet tona, ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë” (Mateu 6:9, 12).

“Lidhni . . . Plagët”

A nuk janë të bukura fjalët që tha Abraham Linkoln për tragjedinë e luftës të tmerrshme civile: “Me keqdashje ndaj kurkujt, me dashuri për të gjithë, . . . le të . . . lidhim . . . plagët” (në John Bartlett, *Familiar Quotations* [1968], 640).

Vëllezërit dhe motrat e mia, le të lidhim plagët — plagët e shumta që janë shkaktuar nga fjalë të ashpra, nga zemërimet të kultivuara me kokfortësi, duke thurur plane për “t’u hakmarrë” me ata që na kanë lënduar. Të gjithë kemi pak nga ky shpirt hakmarrës brenda nesh. Fatmirësisht, të gjithë kemi fuqinë të ngrihemi përmbi këtë shpirt, nëse “[vishemi] me lidhjen e dashurisë hyjnore, si me një mantel, që është lidhja e përsosmërisë dhe e paqes” (DeB 88:125).

“Të gabosh është njerëzore, të falësh është hyjnore” (Alexander Pope, *An Essay on Criticism*, 2:711). Nuk ka paqe kur mendon për dhimbjen e plagëve të vjetra. Por paqja vjen vetëm nga pendimi dhe falja. Kjo është paqja e ëmbël e Krishtit, i cili tha: “Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë” (Mateu 5:9).

Nga *Ensign*, qershor 1991, faqe 2-5.

ADMINISTRIMI I FINANCAVE TË FAMILJES

8

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni një ose që të dy këto sugjerime.

- Bëni një listë të gjërave që keni blerë kohët e fundit. Shkruani germën *N* pranë çdo artikulli që ju nevojitej. Shkruani germën *D* pranë çdo artikulli që donit, por që nuk ju nevojitej. Përdoreni këtë listë për të vlerësuar praktikën tuaj të shpenzimeve. Nëse po shpenzoni më tepër para në gjëra që janë të panevojshme, mendoni për mënyra se si t'i përdorni paratë tuaja më me urtësi.
- Me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj krijoni një buxhet për një periudhë kohe — ndoshta për një ose dy javë. Mbani parasysh se mund të përdorni shembullin në faqen 32 si udhëzues. Punoni së bashku për të jetuar brenda buxhetit që keni caktuar.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni i/e martuar, lexojeni e diskutojeni artikullin me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

QËNDRUESHMËRIA MIDIS NDRYSHIMIT

Presidenti N. Eldon Taner

Këshilltar i Parë në Presidencinë e Parë

Ajo që do të doja të ndaja me ju sot janë vëzhgimet që kam bërë rreth parimeve të qëndrueshme dhe themelore të cilat, po të ndiqen, do të sjellin siguri financiare dhe paqe të mendjes nën *çdo* rrethanë ekonomike.

“Para së Gjithash Kërkoni Mbretërinë e Perëndisë”

Së pari, do të doja të ndërtoja një themel dhe të vendosja një këndvështrim brenda të cilit duhet të zbatohen këto parime ekonomike.

Një ditë një nga nipërit e mi më tha: “Të kam vërejtur ty dhe njerëz të tjerë të suksesshëm dhe e kam vendosur në mendjen time se dua të jem i suksesshëm në jetë. Dua të intervistoj sa më shumë njerëz të suksesshëm për të parë se çfarë i bëri ata të tillë. Kështu pra, duke u bazuar në përvojën tënde gjysh, cili beson ti se është elementi më i rëndësishëm i suksesit?”

I thashë se Zoti na ka dhënë formulën më të madhe për sukses që unë di: “Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen” (Mateu 6:33).

Disa kundërshtojnë duke thënë se ka edhe disa njerëz që *nuk* kërkojnë para së gjithash mbretërinë

e Perëndisë por janë të suksesshëm financiarisht. Është e vërtetë. Por Zoti nuk na premton vetëm pasuri materiale nëse kërkojmë para së gjithash mbretërinë. Nga përvoja ime e di se nuk ndodh kështu. E shprehur me fjalët e Henrik Ibsenit: “Paraja mund të jetë lëvoria e shumë gjërave, por jo bërthama. Paraja ju sjell ushqimin, por jo oreksin; ilaçin, por jo shëndetin; të njohurit, por jo miqtë; shërbëtorët, por jo besnikërinë; ditë gëzimi, por jo paqe ose lumturi” (në *The Forbes Scrapbook of Thoughts on the Business of Life* [1968], 88).

Bekimet materiale janë një pjesë e ungjillit nëse arrihen në mënyrën e duhur dhe për qëllimin e duhur. Më vjen ndër mend një përvojë e Presidentit Hju B. Braun. Kur ishte ushtar në Luftën e Parë Botërore, ai po vizitonte në spital një mikun e tij të moshuar. Miku i tij ishte një multi-milioner i cili, në moshën tetëdhjetë vjeç, ishte në prag të vdekjes. As bashkëshortja e tij e divorcuar as ndonjëri nga pesë fëmijët e tij nuk e morën mundimin të shkonin për ta parë në spital. Ndërsa Presidenti Braun mendoi për gjërat që miku i tij “kishte humbur të cilat paraja nuk mund t’i blinte dot dhe vuri re situatën e tij tragjike dhe thellësinë e mjerimit të tij,” ai e pyeti mikun e tij se çfarë do të ndryshonte po ta niste jetën nga e para.

Zotëria i vjetër, i cili vdiq disa ditë më vonë, tha: “Ndërsa mendoj për jetën time, gjëja më e rëndësishme dhe gjëja më me vlerë që mund të kisha pasur, por që e humba gjatë procesit të grumbullimit të

milionave të mi, ishte besmi i thjeshtë që mamaja ime kishte në Perëndi dhe në pavdekësinë e shpirtit.

. . . Ti më pyete se cila është gjëja më me vlerë në jetë. Nuk mund të përgjigjem më mirë sesa me fjalët e përdorura nga poeti. Ai i kërkoi Presidentit Braun të merrte një libër të vogël nga çanta e tij nga i cili ai lexoi një poezi të titulluar "Jam një i Huaj."

Jam një i huaj ndaj besimit që ime më më mësoi,
Jam një i huaj ndaj Perëndisë që nënën time
dëgjoi kur ajo vajtoi,
Jam një i huaj ndaj qetësisë që ninullat më sollën,
Ndaj krahëve të përjetshëm që tim at mbajtën kur
vdiq.
Kur bota e madhe erdhi të më thërriste, lashë çdo
gjë për ta ndjekur,
Duke mos e vënë re kurrë se në verbërinë time
isha shkëputur nga dora e Tij,
Duke mos ëndërruar kurrë në trullosjen time se
filluska e famës është bosh,
Se pasuria e arit është një stringël vezulluese, që
sikurse e mësova, e tillë është.
E kam kaluar gjithë jetën duke kërkuar gjërat që
kur i gjeta i përbuza,
Kam luftuar dhe jam shpërblyer në shumë çështje
të suksesshme,
Por do t'i jepja të gjitha: famën dhe pasurinë dhe
kënaqësinë që i rrethon,
Po të kisha atë besim që nënën time e forcoi."

"Kjo ishte dëshmia e një njeriu që po vdiste i cili kishte lindur në Kishë, por ishte larguar prej saj. Kjo ishte klithma e dëshpëruar e një njeriu të vetmuar që mund të kishte çdo gjë që paraja mund të blejë, por që kish humbur gjërat më të rëndësishme të jetës për të grumbulluar të mirat e kësaj bote" (*Continuing the Quest* [1961], 32-35; gërmat kursive janë shtuar).

Në Librin e Mormonit, profeti Jakob na jep një këshillë të rëndësishme mbi këtë çështje:

"Por, para se të kërkoni pasuri, kërkoni mbretërinë e Perëndisë.

Dhe, pasi ju të keni marrë një shpresë në Krisht, ju do të merrni pasuri, në qoftë se ju i kërkoni ato; dhe ju do t'i kërkoni ato me qëllim që të bëni mirë — të vishni të zhveshurit, dhe të ushqeni të uriturit, dhe të çlironi robërit, dhe t'u jepni ndihmë të sëmurëve dhe të mjerëve" (Jakobi 2:18-19; gërmat kursive janë shtuar).

Kështu pra themeli dhe këndvështrimi janë këto: Së pari duhet të kërkohet mbretërinë, të punohet, të planifikohet dhe të shpenzohet me urtësi, të planifikohet për të ardhmen dhe të përdorim atë pasuri me të cilën kemi bekuar për të ndihmuar në ndërtimin e mbretërisë. Kur udhëhiqemi nga ky këndvështrim i përjetshëm dhe nga ndërtimi i këtij

themeli të fortë, mund të vazhdojmë me vetëbesim në detyrat e përditshme të jetës, të cilat duhet të planifikohen me kujdes dhe të ndiqen me zell.

Brenda këtij kuadri dua të shpjegoj pesë parime për qëndrueshmëri ekonomike.

Paguani një Të Dhjetë të Ndershme

Qëndrueshmëria #1: Paguani një të dhjetë të ndershme. Shpesh pyes veten nëse e kuptojmë se pagimi i të dhjetës nuk përfaqëson dhënien e dhuratave Zotit dhe Kishës. Pagimi i së dhjetës është pagimi i një borxhi që i kemi Zotit. Zoti është burimi i të gjitha bekimeve tona, përfshirë vetë jetën.

Pagimi i së dhjetës është një urdhërim, një urdhërim me një premtim. Nëse i bindemi këtij urdhërimi, na është premtuar se do të "përparojmë në tokë." Ky përparim përfshin më tepër se të mira materiale — ai mund të përfshijë të gëzuarit e një shëndeti të mirë dhe vitalitetin e mendjes. Përfshin solidaritetin e familjes dhe rritjen shpirtërore. Shpresoj se ju që tani nuk po paguani një të dhjetë të plotë do të kërkoni besimin dhe forcën për ta bërë këtë. Ndërsa ja shlyeni këtë detyrim Krijuesit tuaj, do të gjeni lumturi shumë të madhe, një lumturi të tillë që e njohin vetëm ata që janë besnikë ndaj këtij urdhërimi.

Jetoni me Kursim

Qëndrueshmëria #2: Jetoni me më pak se sa fitoni. Kam zbuluar se nuk ka mundësi që të mund të fitosh më tepër sesa mund të shpenzosh. Jam i bindur se nuk është sasia e parave që fiton një njeri që sjell paqe të mendjes më tepër se sa të pasurit kontroll mbi paratë e tij. Paraja mund të jetë një shërbëtor i bindur, por një zotëri i ashpër. Ata që e krijojnë standardin e tyre të jetesës në mënyrë që të lejojë për një tepriçë të vogël, janë në kontroll të rrethanave të tyre. Ata që shpenzojnë pak më shumë nga sa fitojnë kontrollohen nga rrethanat e tyre. Ata janë në robëri. Presidenti Hibër J. Grant tha dikur: "Nëse ka ndonjë gjë që do të sillte paqe dhe lumturi në zemrën e njeriut dhe në familje, është që të jetojmë me aq sa kemi. Dhe nëse ka ndonjë gjë që është më dërrmuese, më dekurajuese dhe më ligështuese është të kesh borxhe dhe detyrime që nuk mund t'i përballosh" (*Gospel Standards*, përmb. G. Homer Durham [1941], 111).

Çelësi për të shpenzuar më pak se fitojmë është i thjeshtë — quhet disiplinë. Qoftë herët ose vonë në jetë, ne të gjithë duhet që më në fund të mësojmë ta disiplinojmë veten, orekset tona dhe dëshirat tona ekonomike. Sa i bekuar është ai që mëson të shpenzojë më pak se fiton dhe vë diçka mënjane për një ditë të vështirë.

Dalloni Midis Nevojave dhe Dëshirave

Qëndrueshmëria #3: Mësoni të dalloni midis nevojave dhe dëshirave. Dëshirat e klientit janë artificiale. Sistemi ynë i lirë dhe konkurses i sipërmarrjeve prodhon mallra dhe shërbime të pakufizuara për të stimuluar dëshirën tonë për të dëshiruar më tepër lehtësira dhe lukse. Nuk e kritikoj sistemin ose ofrimin e këtyre mallrave ose shërbimeve. Unë jam i shqetësuar vetëm nëse njerëzit tanë përdorin gjykim të shëndoshë në blerjet e tyre. Ne duhet të mësojmë se sakrificat është pjesë e disiplinës sonë të përjetshme.

Në këtë vend dhe në shumë vende të tjera, shumë prindër dhe fëmijë të lindur që nga koha e Luftës së Dytë Botërore kanë njohur vetëm kushte të mira. Shumë kanë qenë të kushtëzuar nga kënaqësitë e çastit. Ka pasur më tepër mundësi pune për të gjithë që janë të aftë të punojnë. Lukset e së djeshmes për shumicën e njerëzve konsiderohen si domosdoshmëritë e të sotmes.

Një gjë e tillë mishërohet në çiftet e reja që kërkojnë t'i mobilojnë shtëpitë dhe të sigurojnë ato lukse për veten që në fillim të martesës, për të cilat prindërve të tyre u është dashur një kohë e gjatë përpjekjesh e sakrificash. Duke dashur tepër shumë tepër shpejt, çiftet e reja mund t'i dorëzohen lehtë planeve të kredive, duke u zhytur kështu në borxh. Kjo do t'i pengonte të kishin mjetet e nevojshme financiare për të bërë atë që sugjeron Kisha për sa i përket krijimit të rezervave ushqimore dhe programeve të tjera të sigurisë.

Plotësimi i tepruar i dëshirave dhe administrimi i keq i parave vendosin një tension të madh në marrëdhëniet martesore. Shumica e problemeve martesore, me sa duket e kanë zanafillën në rrënjët ekonomike — ose të ardhura të pamjaftueshme për të mbështetur familjen ose keqadministrim i të ardhurave të fituara.

Një baba i ri shkoi në zyrën e peshkopit për këshillim financiar dhe i tregoi atij një histori shumë të zakonshme. "Peshkop, jam trajnuar mirë si një inxhinier dhe kam një rrogë të mirë. Duket se gjatë gjithë shkollës më kanë mësuar si të fitoj para, por askush nuk më ka mësuar si t'i administroj paratë."

Ndërsa besoj se është e dëshirueshme që çdo student të frekuentojë klasat për edukimin e konsumatorit, trajnimi kryesor i takon prindërve. Prindërit nuk mund t'ia lënë këtë trajnim jetësor rastësisë ose t'ia kalojnë përgjegjësinë krejtësisht shkollave dhe universiteteve publike.

Një pjesë e rëndësishme e këtij trajnimi duhet të jetë shpjegimi i borxhit. Për shumicën nga ne ekzistojnë dy lloje borxhesh financiare — borxhi i konsumatorit dhe borxhi i investimit ose biznesit.

Borxhi i konsumatorit ka të bëjë me blerjen me kredi të atyre gjërave që përdorim ose konsumojmë në jetën e përditshme. Shembuj të kësaj përfshijnë pagesat me këste për blerjen e rrobave, pajisjeve, orendive etj. Borxhi i konsumatorit sigurohet nga hipotekimi i fitimeve tona të ardhshme. Kjo mund të jetë shumë e rrezikshme. Nëse na nxjerrin nga puna, nëse demtohem fizikisht, ose hasim kriza serioze, do ta kemi të vështirë të përmbushim detyrimet tona. Blerja me kredi është mënyra me e shtrenjtë e blerjes. Koshtet e mallrave që blejmë duhet t'i shtojmë një interes të lartë dhe tarifat e shërbimit.

Unë e kuptoj që familjet e reja e kanë të domosdoshme ndonjëherë të blejnë me kredi. Por ne ju këshillojmë të mos blini me tepër sesa është vërtetë e nevojshme dhe t'i paguani borxhet tuaja sa më shpejt të jetë e mundur. Kur buxheti është i shtrënguar, shmangni barrën e tepërt të më shumë tarifave të interesit.

Borxhi i investimit duhet të sigurohet plotësisht në mënyrë që të mos pengojë sigurinë e familjes. Mos investoni në sipërmarrje spekulative. Shpirti i spekulimit mund të bëhet helmues. Pasuri të tëra janë tretur nga dëshira e pakontrolluar për të fituar më shumë. Le të mësojmë nga përvojat e hidhura të të kaluarës dhe të shmangim skllavërimin e kohës, energjisë dhe shëndetit tonë ndaj një dëshire të pafre për të fituar sa më shumë të mira materiale.

Presidenti Spenser W. Kimbëll na ka dhënë këtë këshillë që na bën të mendojmë:

"Zoti na ka bekuar si një popull me një pasuri të paparë në të kaluarën. Burimet që janë vënë nën fuqinë tonë janë të mira dhe të domosdoshme për punën tonë këtu në tokë. Por kam frikë se shumë nga ne janë dhënë kaq shumë pas tufave dhe bagëti-ve, hektarëve, hangarëve e pasurive dhe kanë filluar t'i adhurojnë ato si perëndi të rreme dhe ato kanë fuqi mbi ne. A kemi më tepër nga këto gjëra nga ç'mund të mbajë besimi ynë? Shumë njerëz e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në shërbim të një imazhi për veten që përfshin para të mjaftueshme, bursa, obligacione, portofol investimesh, prona, karta krediti, mobilje, makina dhe të tilla si këto me shpresën për të *garantuar* sigurinë trupore për një jetë, që shpresohet të jetë e gjatë dhe e lumtur. Harrohet fakti se detyra jonë është që t'i përdorim këto burime të shumta në familjet dhe kuorimet tona për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë" ("The False Gods We Worship," *Ensign*, qershor 1976, 4).

Dua t'i shtoj dëshminë time kësaj thënieje të Presidentit Kimbëll. Unë nuk di asnjë situatë ku lumturia dhe paqja e mendjes të jenë rritur me shtimin e pronave përtej nevojave dhe kërkesave të arsyeshme të familjes.

Hartoni Buxhetin me Mençuri

Qëndrueshmëria #4: Hartoni dhe jetoni brenda buxhetit. Një miku im ka një vajzë që shkoi jashtë vendit me një program studimor nga Universiteti Brigam Jang për një simestër. Ajo i shkruante vazhdimisht familjes për t'i dërguar më tepër para. Ai u shqetësua aq shumë saqë e telefonoi dhe e pyeti përse i duheshin më tepër fonde. Në një pikë të bisedës e bija iu përgjigj: “Babi, nuk mund të të them se ku ka përfunduar çdo qindarkë që më keni dërguar.”

Ai iu përgjigj: “Ti nuk po e kupton se ku e kam fjalën. Mua më intereson të kesh një buxhet — një plan për të shpenzuar — jo një libër llogarie ku të shënosh se ku kanë shkuar paratë.”

Ndoshta prindërit duhet të jenë më tepër si babai i atij studentit që i shkroi këtë telegram familjes “S’ka para, s’ka qejf, yt bir.” I ati i dërgoi përgjigjen me një tjetër telegram “Sa keq, shumë keq, yt at.”

Kam vënë re gjatë intervistimit të shumë njerëzve për vite me rradhë se shumë njerëz nuk kanë një buxhet praktik dhe nuk e disiplinojnë veten që t’i përmbahen fondeve të tij. Shumë njerëz mendojnë se një buxhet i privon lirinë. Përkundrazi, njerëzit e suksesshëm kanë mësuar se buxheti bën të mundur lirinë e vërtetë ekonomike.

Hartimi i një buxheti dhe administrimi i financave nuk duhet të jetë tepër i ndërlikuar ose të marrë shumë kohë. Tregojnë një histori për një baba emigrant i cili mbante llogaritë e pagesave në një kuti këpucësh, llogaritë e parave të marra në një bosht dhe paratë e tij në arkë.

“Nuk e kuptoj se si mund ta administrosh në këtë mënyrë biznesin tënd,” i tha i biri. “Nga e di se sa ke fituar?”

“Bir,” iu përgjigj biznesmeni, “kur zbrita nga anija, kisha vetëm pantallonat që kisha në trup. Sot jot motër është një mësuese arti, yt vëlla doktor kurse ti llogaritar. Kam një makinë, një shtëpi dhe një biznes të mirë. Çdo gjë është e paguar. Kështu mbli-dhi të gjitha këto, zbrit pantallonat dhe ja ku doli fitimi im.”

Këshilluesit e mençur financiarë na mësojnë se ka katër elementë të ndryshëm në çdo buxhet të mirë. *Së pari duhen marrë masa për nevojat bazë të tilla si ushqimi, veshja, etj.; së dyti, pagesa e shtëpisë; së treti,*

nevoja emergjente të tilla si kursime, siguracion shëndetësor dhe siguracion jete; dhe *së katërti*, një investim i mençur dhe një program rezervash ushqimore për të ardhmen.

Më lejoni të komentoj dy nga këta elementë. Asgjë nuk duket aq e sigurtë në jetën tonë se sa të papriturat. Me rritjen e kostos së shërbimeve mjeksore, siguracioni për shëndetin është mënyra e vetme me anë të së cilës pjesa më e madhe e familjeve janë në gjendje të përballojnë një aksident të rëndë, sëmundje, ose koston e shtatëzanive, veçanërisht në rastet e lindjeve të parakohshme. Siguracioni për jetën siguron të ardhura të vazhdueshme kur siguresi i të mirave materiale vdes parakohe. Çdo familje duhet të marrë masa për të pasur siguracion shëndetësor dhe siguracion për jetën.

Pasi janë plotësuar këto nevoja bazë, me anë të administrimit të kujdesëshëm duhet të kursejmë rregullisht për të krijuar fonde për investime. Kam vënë re se pak njerëz që nuk kanë krijuar shprehinë e kursimit të vazhdueshëm kanë qenë të suksesshëm me investimet e tyre. Kjo kërkon disiplinë dhe gjykim të mprehtë. Ka shumë mënyra për të investuar. Këshilla ime është të zgjidhni me urtësi këshilluesit e investimeve. Sigurohuni që ata e meritojnë mirëbesimin tuaj duke mbajtur një dokument të suksesshëm investimesh.

Jini të Ndershëm

Qëndrueshmëria # 5: Jini të ndershëm në të gjitha çështjet financiare. Ideali i integritetit nuk do të dalë kurrë nga moda. Ai gjen zbatim në çdo gjë që bëjmë. Si udhëheqës dhe anëtarë të Kishës, ne duhet të jemi mishërimi i integritetit.

Vëllezër dhe motra, me anë të këtyre pesë parimeve, jam përpjekur të skicoj atë që mund të cilësohet si modeli i vërtetë për administrimin e financave dhe burimeve.

Shpresoj që secili nga ju mund përfitojë nga zbatimi i tyre. Unë dëshmoj se këto parime janë të vërteta dhe se kjo Kishë e puna në të cilën jemi përfshirë janë të vërteta.

Nga një fjalim i Presidentit Taner në sesionin e përgjithshëm të mirëqenies në konferencën e përgjithshme të Kishës tetor 1979 (shih Conference Report, tetor 1979, 117-21; ose *Ensign*, nëntor 1979, 80-82).

Buxheti nga _____ data _____ deri në _____ data _____

TË ARDHURAT	TË PLANIFIKUARA	AKTUALE
Pagat ose rroga pas taksave		
Të ardhura të tjera		
Totali i të ardhurave		
SHPENZIMET	TË PLANIFIKUARA	AKTUALE
E Dhjeta		
Dhurime të tjera në Kishë		
Kursime afat-gjata		
Kursime për raste emergjente		
Ushqimi		
Hipoteka ose qeraja		
Shërbimet publike		
Transporti		
Pagimi i borxheve		
Siguracioni		
Shpenzimet mjeksore		
Veshje		
Të tjera		
Të tjera		
Të tjera		
Totali i shpenzimeve		

PJESA B: PËRGJEGJËSITË E PRINDËRVE PËR TË FORCUAR FAMILJET



“FËMIJËT JANË NJË TRASHËGIMI NGA ZOTI”

9

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Zotohuni të kaloni kohë individualisht me secilin nga fëmijët tuaj ose me një fëmijë në fafesisin tuaj. Ndërsa flisni me fëmijët, përpiquni të mësoni diçka të re rreth interesave, nevojave dhe sfidave të tij apo të saj.
- Bëni kohë për të folur rreth fëmijëve tuaj me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj. Diskutoni për pikat e forta dhe vështirësitë e siccilit prej fëmijëve. Vendosni se çfarë mund të bëni për të plotësuar nevojat e siccilit fëmijë.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojeni artikullin me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

FËMIJËT E ÇMUAR, NJË DHURATË NGA PERËNDIA

Presidenti Tomas S. Monson

Këshilltar i Parë në Presidencinë e Parë

Ne mësojmë se pasi Jezusi dhe dishepujt e Tij zbritën nga Mali i Shpërfytyrimit, ata ndaluan në Galile dhe më pas shkuan në Kapernaum. Dishepujt i thanë Jezusit: “Kush është, pra, më i madhi në mbretërinë e qiejve?”

Dhe Jezusi, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre dhe tha: “Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve.”

Kush, pra, do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve.

Dhe kushdo që e pranon një fëmijë të vogël si ky në emrin tim, më pranon mua.

Por ai që do të skandalizojë një prej këtyre të vegjëlve që besojnë tek unë, do të jetë më mirë për atë t’i varet në qafë një gur mulliri (që e sjell rrotull gomari) dhe të zhytet në thellësi të detit”¹.

Unë mendoj se është shumë kuptimplotë fakti që Jezusi i donte kaq shumë këta fëmijë të vegjël, të cilët nuk kishin shumë që ishin larguar nga ekzistenca paratokësore për të ardhur në tokë. Fëmijët në atë kohë dhe fëmijët tani, bekojnë jetën tonë, ngjallin dashurinë tonë dhe nxisin vepra të mira.

A është për t’u habitur që poeti Uordsuërth flet kështu për lindjen tonë: “Duke u çapitur nëpër re ladvie ne vijmë/ Nga Perëndia, që është shtëpia jonë”².

Shumica e këtyre të vegjëlve u vijnë prindërve që mezi e presin ardhjen e tyre, nëna e baballarë që gëzohen të jenë pjesë e asaj mrekullie që e quajmë lindje. Asnjë sakrificë nuk është e tepërt, asnjë dhembje nuk është më e madhe, asnjë pritje tepër e gjatë.

Patjetër që tronditemi kur dëgjojmë për një histori që vjen nga një qytet në Amerikë e që lajmëron: “një vajzë e porsalindur e cila ishte mbështjellë me një qese letre dhe ish hedhur në kazanin e plehërave është nën mbikqyrje të rreptë në spital. Fëmija është mirë. ‘Ajo është një bebe me të vërtetë e bukur dhe e shëndetshme,’ tha të mërkurën një nga zëdhënësit e spitalit. Policia tha se foshnja u zbulua pasi punëtori i plehërave zbrazi kazanin në makinën e plehërave dhe vuri re diçka që lëvizte mes mbeturinave. Autoritetet janë duke kërkuar nënën.”

Është detyra jonë solemne, privilegji ynë i çmuar — madje mundësia jonë e shenjtë — për të mirëpritur në shtëpitë dhe në zemrat tona fëmijët që hijeshojnë jetën tonë.

Fëmijët tanë kanë tre klasa për të mësuar që dallojnë shumë nga njëra-tjetra. Flas për klasën në shkollë, klasën në kishë dhe klasën në shtëpi.

Klasa në Shkollë

Kisha ka pasur gjithmonë një interes të madh në arsimin publik dhe i nxit anëtarët e saj të marrin

pjesë në aktivitete prindër-mësues dhe në ngjarje të tjera të caktuara për të përmirësuar arsimin e rinisë sonë.

Nuk ka aspekt më të rëndësishëm në arsimin publik se sa mësuesi që ka mundësi t'i dojë, mësojë dhe frymëzojë djemtë dhe vajzat, të rinjtë e të rejtat e zellshëm. Presidenti David O. Mekei tha: "Mësimdhënia është profesioni më fisnik në botë. Në arsimimin e duhur të rinisë varet qëndrueshmëria dhe pastërtia e shtëpisë, siguria dhe vazhdueshmëria e kombit. Prindi i jep fëmijës një mundësi për të jetuar; mësuesi bën të mundur që fëmija të jetojë mirë." ³ Unë kam besim se ne do ta pranojmë rëndësinë e tyre dhe misionin e tyre jetësor duke siguruar pajisje të mjaftueshme, libra nga më të mirët dhe paga që u tregojnë (atyre) mirënjohjen dhe besimin tonë.

Secili prej nesh i kujton me dashuri mësuesit e rinisë sonë. Mësuesja ime e muzikës në shkollën fillore ishte Znj. Sharp. Ajo kishte aftësinë të rrënjoste brenda nxënësve të saj një dashuri për muzikën dhe na mësoi të dallonim instrumentat muzikorë dhe tingujt e tyre. Më kujtohet mirë ndikimi i Znj. Ruth Krau që na jepte lëndën për shëndetin. Megjithëse ishin kohët e Krizës Ekonomike, ajo bëri të mundur që çdo nxënës në klasën e gjashtë të kishte një kartelë dentare. Ajo vetë i kontrolloi të gjithë nxënësit për shëndetin dentar dhe siguroi që nëpërmjet buri-meve publike apo private, asnjë fëmijë të mos mbetej pa kujdesin e duhur dentar. Kur Znj. Burkhaus, e cila jepte gjeografi, hapte hartat e botës dhe me shkopin e saj tregonte kryeqytetet e kombeve dhe tiparet dalluese të çdo vendi, gjuhën dhe kulturën, nuk më shkonte mendja dhe as ëndërroja që një ditë unë do t'i vizitoja këto toka e këta popuj.

Oh, ç'rëndësi kanë në jetën e fëmijëve tanë mësuesit që u lartësojnë shpirtrat, që u zhvillojnë intelektin dhe motivojnë jetën e tyre!

Klasa në Kishë

Klasa në Kishë i shton një përmasë jetësore edukimit të çdo fëmije e të riu. Në këtë mjedis çdo mësuese mund t'i sigurojë një rritje më të madhe atyre që dëgjojnë mësimet dhe ndiejnë ndikimin e dëshmisë së saj. Në mbledhjet e Fillores, Shkollës së të Dielës, Të Rejave dhe atyre të Priftërisë Aarone, mësues të përgatitur mirë, të thirrur nën frymëzimin e Zotit, mund të prekin çdo fëmijë e çdo të ri dhe t'i nxisin të gjithë të kërkojnë fjalë urtësie nga librat më të mirë dhe të kërkojnë të mësojnë nëpërmjet studimit si edhe nëpërmjet besimit.⁴ Një fjalë inkurajimi këtu, e një mendim shpirtëror atje, mund të prekë një jetë të çmuar dhe të lërë një gjurmë të pashlyeshme në një shpirt të pavdekshëm.

Shumë vjet më parë, në një banket çmimesh të Revistës së Kishës, u ulëm me Presidentin dhe Motrën Harold B. Li. Presidenti Li i tha Anës, vajzës sonë adoleshente: "Zoti të ka bekuar me një fytyrë e trup të bukur. Qëndro brenda aq e bukur sa edhe jashtë dhe do të bekohesh me lumturi të vërtetë." Ky mjeshtrë mësues i la Anës një udhëheqje të frymëzuar për në mbretërinë çelestiale të Atit tonë Qiellor.

Mësuesja e përlurur dhe e frymëzuar në klasën e Kishës mund të rrënjosë tek nxënësit e saj një dashuri për shkrimet e shenjta. Mësuesja mund t'i sjellë Apostujt e hershëm dhe Shpëtimtarin e botës jo vetëm në klasë, por edhe në zemrat, mendjet dhe shpirtrat e fëmijëve tanë.

Klasa që Quhet Shtëpi

Ndoshta klasa më e rëndësishme nga të gjithë të tjerat është klasa e shtëpisë. Është pikërisht në shtëpi ku krijojmë qëndrimet tona si edhe pikëpamjet që i mbrojmë fort. Është në shtëpi ku shpresa ushqehet ose shkatërrohet. Shtëpitë tona janë laboratorë të jetës sonë. Çfarë bëjmë aty, përcakton drejtimin e jetës sonë, kur largohemi nga shtëpia. Dr. Stuart E. Rosenberg, në librin e tij *The Road to Confidence* (Rruga Drejt Vetëbesimit) shkroi: "Pavarësisht nga të gjitha shpikjet e reja dhe krijimet moderne, moda dhe manirat, askush nuk ka shpikur ende, ose kurrë nuk do të shpikë, një zëvendësues të kënaqshëm për familjen tonë"⁵.

Një shtëpi e lumtur është veçse një qiell i parakohshëm. Presidenti Xhorxh Albert Smith pyeti: "[A] dëshirojmë që shtëpitë tona të jenë të lumtura[?]" Në qoftë se po, le të jenë ato vendi ku të banojë lutja, falënderimi dhe mirënjohja."⁶

Ka situata ku fëmijët vijnë në vdekshmëri më një të metë fizike apo mendore. Edhe pse përpigemi shumë, nuk është e mundur të dimë pse ose si ndodhin ngjarje të tilla. Unë i nderoj ata prindër të cilët pa u ankuar e marrin një fëmijë të tillë në krahët dhe në jetën e tyre dhe i ofrojnë një sakrificë e dashuri jash-tëzakonisht të madhe njërit prej fëmijëve të Atit Qiellor.

Një verë, në një Kamp familjar në Aspen Grouv, vura re një nënë që ushqente me durim një vajzë adoleshente të dëmtuar në lindje dhe që varej plotësisht nga e ëma. Nëna i jepte çdo lugë ushqimi, çdo gllënkë uji, ndërsa mbante të palëvizur kokën dhe qafën e së bijës. Mendova qetësisht me vete: "Për 17 vjet, nëna i ka dhënë këtë shërbim e gjithë shërbimet e tjera bijës së saj, duke mos menduar kurrë për rehatinë e vet, kënaqësinë e vet, ushqimin e vet." Perëndia i bekoftë nëna të tilla, baballarë të tillë, fëmijë të tillë. Dhe Ai do t'i bekojë.

Pafajësia e Fëmijëve

Prindërit kudo e kuptojnë se kombinimi më i fuqishëm i emocioneve në botë nuk shkaktohet nga ndonjë ngjarje madhështore kozmike, as nuk gjendet në romane apo librat e historisë, por thjesht nga një prind që vështron një fëmijë duke fjetur.

Kur e bëjmë këtë na vjen në mend vërtetësia e fjalëve të Çarls M. Dickinson:

*Ata janë idhujt e zemrës dhe të shtëpisë
Ata janë engjëjt të maskuar të Perëndisë;
Drita e diellit ende fle në flokët e tyre;
Lavdia e Tij ende shkëlqen në sytë e tyre;
Këta që largohen nga shtëpia e nga Qielli,
Më kanë bërë më të dashur e më të butë;
Dhe tani e di pse Jezusi mund ta krahasonte
Mbretërinë e Perëndisë me një fëmijë⁷.*

Në përvojën tonë të përditshme me fëmijët, ne zbulojmë se ata janë shumë të kapshëm dhe shpesh thonë të vërteta të mëdha. Çarls Dikensi, autori i veprës klasike *A Chrismans Carol* (Një Këngë Krishtlindjeje), e ilustroi këtë fakt, kur përshkroi familjen e përrulur të Bob Kratçitit që po mblidhej për një darkë shumë të varfër Krishtlindjeje, por që kishin kohë që e prisnin. Bobi, babai, po kthehej në shtëpi duke mbajtur në shpatulla birin e tij të dobët Tini Timin. Tini Tim “mbante një patericë dhe gjymtyrët e tij mbështeteshin në një mbajtëse prej hekurri.” Gruaja e pyeti Bobin: “E si u soll Timi i vogël?”

“Flori e shkuar floririt’ tha Bobi. Duke ndenjtur aq shumë vetëm, ai bie në mendime dhe mendon gjëra nga më të çuditshme që ke dëgjuar ndonjëherë. Ndërsa po vinim në shtëpi ai më tha se shpresonte që njerëzit ta vinin re në kishë, sepse ai ishte një sakat dhe atyre mund t’iu pëlqente që në Ditën e Krishtlindjes të kujtonin se kush i bëri lypësit e çalë të ecnin dhe të verbërit të shihnin.”⁸

Vetë Çarls Dikensi tha: “Unë i dua këta të vegjël dhe nuk është një gjë e pakët kur ata, të cilët sapo kanë ardhur të freskët nga Perëndia, na duan ne.”

Fëmijët e shprehin dashurinë e tyre në mënyra të reja e origjinale. Disa kohë më parë, për ditëlindjen time një vogëlushe e dashur më dha një kartolinë ditëlindjeje të shkruar me dorë dhe të mbyllyr në një zarf një dryn të vogël lodër që asaj i pëlqente dhe mendoi se edhe mua do të më pëlqente ta merrja si dhuratë.

“Ndër të gjitha pamjet më të bukura në botë nuk ka asgjë më të bukur se një fëmijë kur jep diçka. Në çdo gjë të vogël që jep. Një fëmijë të dhuron botën. Të hap botën sikur të qe një libër që kurrë nuk do të kishe mundur ta lexoje. Por kur gjendet një dhuratë gjithmonë ka diçka të vogël absurde, të ngjitur në kërrabë . . . një ëngjëll që duket si klloun. Një fëmijë

ka shumë pak për të dhënë, sepse ai asnjëherë s’e di se të ka dhënë gjithçka”⁹.

E tillë ishte edhe dhurata e Xhenit për mua.

Fëmijët duket se janë bekuar me një besim të qëndrueshëm në Atin e tyre Qiellor dhe në aftësinë e dëshirën e Tij për t’iu përgjigjur lutjeve të tyre të sinqerta. E kam provuar personalisht që kur një fëmijë lutet, Perëndia dëgjon.

Më lejoni të ndaj me ju përvojën e Beri Bonell dhe Deil Mërfi, lojtarë profesionistë të mirënjohur beisbolli që luanin në klubin e Atlanta Braves. Që të dy janë anëtarë të Kishës të kthyer në besim, Deil Mërfi u pagëzua nga Beri Bonell.

“Gjatë 1978-tës Beri pati një përvojë që e përshkruan si ‘diçka që i ndryshoi jetën.’ Ai po vuante shumë se nuk po luante mirë. Për shkak të lojës së tij të dobët ai ishte ishte i mërzitur me veten dhe ndihej shumë keq. Kur Deil Mërfi i kërkoi që të shkonin së bashku në spital, ai nuk donte të shkonte, por megjithatë shkoi. Atje ai takoi një djalë të ri, Riki Litëll, një përkrasë besnik të Atlanta Braves, por që ishte i sëmurë me leuçemi. Dukej qartë që Riki ishte pranë vdekjes. Beri ndjeu një dëshirë të madhe të mendohte për t’i thënë diçka ngushëlluese, por asgjë nuk i dukej e mjaftueshme. Më në fund, ai e pyeti nëse kishte ndonjë gjë që ata mund të bënin për të. Djali ngurroi dhe pastaj i pyeti nëse secili prej tyre do të shënonte një pikë për të në ndeshjen e ardhshme. [Më vonë] Beri tha: ‘Një kërkesë e tillë nuk ishte ndonjë gjë e vështirë për Deilin, i cili në fakt kishte shënuar dy pikë atë natë, por unë nuk po kisha sukses në lojë dhe nuk kisha shënuar gjatë gjithë vitit. Pastaj ndjeva të më pushtonte një ndjenjë e ngrohtë dhe i thashë Rikit se do ta bënim patjetër.’” Atë natë Beri shënoi pikën e tij të vetme gjatë gjithë sezonit¹⁰. Lutja e një fëmije kishte marrë një përgjigje, dëshira e një fëmije ish plotësuar.

Nevoja për Siguri

Sikur vetëm të gjithë fëmijët të kishin prindër të dashur, shtëpi të sigurta dhe miq që kujdesen për ta, sa e mrekullueshme do të ishte bota e tyre. Fatkeqësisht, jo të gjithë fëmijët janë kaq të bekuar. Disa fëmijë janë dëshmitarë të baballarëve që i rrahin mizorisht nënat e tyre, ndërsa të tjerë e provojnë vetë këtë abuzim. Ç’frikë, ç’dëgjenerim, ç’turp!

Spitalet lokale ngado mbledhin këta të vegjël, të maviosur e të rrahur të shoqëruar me gënjeshtër të pacipa që gjoja fëmija “u përplas me derën” ose “ra nga shkallët.” Gënjeshtarët, mizorët që abuzojnë mbi fëmijët, një ditë do vuajnë pasojat e veprimeve të tyre të ndyra. Fëmija i heshtur, i lënduar, i fyer, viktimë e abuzimit dhe ndonjëherë edhe i incestit, duhet të ndihmohet.

Një gjykatës distriktoi deklaroi në një letër që më drejtohej mua: "Abuzimi seksual i fëmijëve është një nga krimet më degjeneruese, më shkatërruese dhe më demoralizuese në shoqërinë e qytetëruar. Po ndodh një rritje alarmuese e raportimeve të abuzimeve fizike, psikologjike dhe seksuale ndaj fëmijëve. Gjykatat tona janë dyndur me raste të kësaj sjelljeje të neveritshme."

Kisha nuk e fal këtë sjellje të urryer e të ligë. Përkundrazi, ne e dënojmë me masën më të rreptë një trajtim të tillë të fëmijëve të çmuar të Perëndisë. Ai fëmijë duhet të shpëtohet, të këtë përkujdesje, ai duhet dhe të shërohet. Fajtori duhet të sillet para drejtësisë për të dhënë llogari për veprimet e tij apo të saj dhe të marrë trajtimin e duhur për të ndaluar një sjellje të tillë djallëzore. Kur ju dhe unë jemi në dijeni të një sjelljeje të tillë dhe nuk bëjmë asgjë për të marrë masa që ta eliminojmë atë, ne bëhemi pjesë e problemit. Një pjesë e fajit bëhet e jona. Ne do të provojmë një pjesë të ndëshkimit.

Besoj se nuk kam folur shumë ashpër, por unë i dua këta vogëlushë dhe e di që edhe Zoti i do. Nuk mund të gjendet një tregim më prekës i kësaj dashurie se sa në përvojën e Jezusit që bekoi fëmijët ashtu si përshkruhet tek 3 Nefi. Aty tregohet për Jezusin që shëroi të sëmurët, mësoi popullin dhe iu lut Atit Qiellor për ta. Por më lejoni të citoj fjalët e çmuara:

"[Jezusi] i mori fëmijët e tyre të vegjël, një nga një, dhe i bekoi dhe iu lut Atit për ta.

Dhe pasi e bëri këtë gjë ai qau përsëri;

Dhe ai i foli turmës dhe u tha atyre: Vini re të vegjëlit tuaj.

Dhe si u kthyen të shikonin, ata hodhën sytë drejt qiellit dhe panë qiejt të hapur; dhe panë engjëj që zbritnin nga qielli sikur të ishin në mes të një zjarri . . . dhe engjëjt u shërbyen atyre"¹¹.

Ju mund të pyesni: *A ndodhin gjëra të tilla madje edhe sot?* Më lejoni të ndaj me ju një tregim të bukur të një gjysheje e gjyshi që po shërbenin në mision disa vjet më parë dhe mënyrën se si u bekua nipi i tyre i vogël. Gjyshi misionar shkroi:

"Gruaja ime Diana dhe unë po shërbejmë një mision në Xhekson, Ohajo. Një prej shqetësimeve tona më të mëdha kur pranuan thirrjen për në mision

ishte familja jonë. Ne nuk do të gjendeshim pranë tyre kur ata të kishin probleme.

"Pak para se të niseshim për në mision, nipi ynë, R.J., që ishte dy vjeç e gjysëm, duhet të operonte syrin. Nëna e tij më kërkoi të shkoja me ta, sepse unë dhe R.J. jemi miq të vërtetë. Operacioni shkoi mirë, por R.J. qau para dhe pas operacionit, sepse asnjë nga familja nuk mund të hynte në sallën e operacionit dhe ai kishte frikë.

"Rreth gjashtë muaj më vonë kur ne ishim akoma në mision, R.J. duhej të rregullonte syrin tjetër. Nëna e tij më telefonoi dhe shprehu dëshirën e saj që unë të shkoja me ta për operacionin e dytë. Sigurisht, largësia dhe misioni nuk më lejuan të isha me ta. Diana dhe unë agjëruam dhe iu lutëm Zotit që të ngushëllonte nipin tonë gjatë operacionit të tij.

"Ne telefonuam kur operacioni kishte përfunduar dhe mësuam se R.J. e mbante mend përvojën e mëparshme dhe nuk donte të largohej nga prindërit e tij. Por sapo kishte hyrë në sallën e operacionit, ishte qetësuar. Ai u shtri në shtratin e operacionit, hoqi syzet dhe e përballoi operacionin me një shpirt të qetë. Ne ishim shumë mirënjohës; lutjet tona kishin marrë një përgjigje.

"Disa ditë më vonë i telefonuam vajzës sonë dhe e pyetëm për R.J. Ai po ja kalonte mirë dhe ajo na tregoi këtë ndodhi: Atë pasdite pas operacionit, R.J. u zgjua dhe i tha së ëmës se gjyshi ishte atje me të gjatë operacionit. Ai tha: 'Gjyshi ishte atje dhe bëri që çdo gjë të shkonte mirë.' A e shihni, Zoti e bëri anestezistin t'i dukej atij vogëlushi sikur të qe gjyshi i tij, por gjyshi dhe gjyshja e tij ishin në mision 2,900 kilometra larg.

Gjyshi mund të mos ketë qenë pranë shtratit tënd R.J., por ti ke qenë në lutjet dhe në mendimet e tij . . . Ti u përkunde në duart e Zotit dhe u bekoje nga Ati i të gjithëve ne.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, e qeshura e fëmijëve gëzoftë zemrat tona. Besimi i fëmijëve qetësotë shpirtat tanë. Dashuria e fëmijëve le të nxisë veprimet tona. "Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti"¹². Ati qiellor i bekoftë këta shpirta të dashur, këta miq të veçantë të Mësuesit.

Nga *Ensign*, qershor 2000, faqe 2-5.

SHËNIME

1. Mateu 18:1-6.
2. “Ode: Intimations of Immortality from Recollections of Early Childhood.”
3. *Gospel Ideals* (1954), 436.
4. Doktrina e Besëlidhje 88:118.
5. *The Road to Confidence* (1959), 121.
6. Në Conference Report, Prill 1944, 32.
7. Nga *The Children*, in Jack M. Lyon and others, eds., *Best-Loved Poems of the LDS People* (1996), 21.
8. *A Christmas Carol and Cricket on the Hearth* (n.d.), 50-51.
9. Margaret Lee Runbeck, *Bits & Pieces*, 20 shtator 1990.
10. James L. Ison, *Mormons in the Major Leagues* (1991), 21.
11. 3 Nefi 17:21-24.
12. Psalmet 127:3.

ROLET E SHENJTA TË BABALLARËVE DHE NËNAVE

10

PJESA 1: ROLET E BABALLARËVE

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Rishikoni rolet e baballarëve dhe nënave që përkruhen në paragrafin e shtatë të “Familja: Një Proklamim drejtuar Botës” (shih faqe iv). Me lutje përcaktoni se si kjo këshillë gjen zbatim në shtëpinë tuaj dhe çfarë do të bëni për ta ndjekur atë.
- Shkruajini një letër babait ose gjyshit tuaj.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojeni artikullin me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

BABALLARËVE NË IZRAEL

Presidenti Ezra Taft Benson
Presidenti i 13-të i Kishës

Të dashur vëllezër të priftërisë, jam mirënjohës të jem me ju në këtë mbledhje të lavdishme të priftërisë së Perëndisë. Lutem që Shpirti i Zotit të jetë me mua dhe ju ndërsa ju flas mbi një prej temave më jetësore. Sonte dua t’u flas baballarëve të mbledhur këtu dhe në mbarë Kishën rreth thirrjeve të tyre hyjnore.

Shpresoj se edhe ju të rinj do të më dëgjoni me kujdes, duke qenë se po përgatiteni tani për t’u bërë baballarët e ardhshëm të Kishës.

Një Thirrje e Përjetshme

Baballarë, thirrja juaj është një thirrje e përjetshme nga e cila nuk liroheni kurrë. Thirrjet në Kishë, sado të rëndësishme që janë, vetë nga natyra e tyre janë vetëm për një kohë të caktuar dhe më pas vjen lirimi në kohën e përshtatshme. Por thirrja e një babai është e përjetshme dhe rëndësia e saj e tejkalon kohën. Ajo është një thirrje për kohën dhe përjetësinë.

Presidenti Harold B. Li me të drejtë tha: “Ndër punët më të rëndësishme të Zotit që ju [baballarë] do të bëni ndonjëherë do të jetë puna që do të bëni brenda mureve të shtëpisë tuaj. Mësimi i shtëpisë, puna në këshillin e peshkopit dhe detyrat e tjera të Kishës janë të gjitha të rëndësishme, por puna më e rëndësishme është brenda mureve të shtëpisë tuaj” (*Strengthening the Home* [pamphlet, 1973], 7)

Cila atëherë është përgjegjësia specifike e një babai brenda mureve të shenjtë të shtëpisë së tij? Më lejoni të sugjeroj dy përgjegjësi bazë për çdo baba në Izrael.

Të Sigurojë Nevojat Materiale

Së pari, ju keni një përgjegjësi të shenjtë të siguroni nevojat materiale të familjes tuaj.

Zoti i përcaktoi qartë rolet për sigurimin e të mirave materiale dhe për edukimin e një brezi të drejtë. Në fillim Adami, jo Eva, u udhëzua për të fituar bukën me djersën e ballit.

Apostulli Pal i këshillon bashkëshortët e baballarët “Por në qoftë se dikush nuk kujdeset për të vetët, dhe më tepër për ata të shtëpisë, ai e ka mohuar besimin dhe është më i keq se një jobesimtar” (1 Timoteut 5:8).

Në vitet e para të historisë së Kishës, Zoti në mënyrë specifike i ngarkoi burrat me detyrimin për të siguruar të mirat materiale për bashkëshortet dhe familjet e tyre. Në janar të vitit 1832 Ai tha: “Dhe përsëri, në të vërtetë unë ju them se çdo burrë që është i detyruar të sigurojë për familjen e tij, duhet të sigurojë dhe në asnjë mënyrë nuk do ta humbasë kuroren e tij” (DeB 75:28). Tre muaj më vonë Zoti tha përsëri: “Gratë kanë të drejtë t’u kërkojnë bashkëshortëve për t’i mbajtur, derisa bashkëshortët e tyre të merren” (DeB 83:2). Kjo është e drejta hyjnore e çdo bashkëshorteje dhe nëne. Ndërsa ajo kujdeset dhe ushqen fëmijët e saj në shtëpi, i shoqi fiton jetesën për familjen, gjë që e bën të mundur të ushqyerin.

Në një shtëpi ku ka një bashkëshort të aftë fizikisht, nga ai pritjet që të jetë shtylla e familjes.

Ndonjëherë dëgjojmë bashkëshortë të cilët, për shkak të kushteve ekonomike, kanë humbur punën dhe presin që gratë të dalin nga shtëpia dhe të punojnë, megjithëse bashkëshorti është ende i aftë të sigurojë jetesën për familjen. Në të tilla raste, ne e nxisim bashkëshortin të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij për ta lejuar gruan të rri në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët ndërkohë që ai vazhdon të sigurojë jetesën për familjen e tij me aq sa mundet, megjithëse puna që ai mund të sigurojë mund të mos jetë ideale dhe buxheti i familjes mund të jetë më i shtrënguar.

Gjithashtu, nevoja për shkollim ose gjëra materiale nuk e justifikon shtyrjen për të pasur fëmijë me qëllim që gruaja të vazhdojë të punojë për të siguruar jetesën e familjes.

Këshillë e Presidentit Kimbëll

Më kujtohet këshilla e profetit tonë të dashur Spenser W. Kimbëll që u dha studentëve të martuar. Ai tha: "U kam thënë dhjetra mijëra prej jush të rinjve që kur martohen nuk duhet të presin për të patur fëmijë deri sa të kenë mbaruar shkollën dhe dëshirat e tyre financiare . . . Ata duhet të jetojnë së bashku normalisht dhe t'i lejojnë fëmijët të vijnë . . .

"Unë nuk di asnjë shkrim të shenjtë," vashdoi Presidenti Kimbëll, "ku t'u jepet një autorizim bashkëshorteve të reja që t'i lënë familjet e tyre dhe të shkojnë të punojnë për të mbajtur bashkëshortët e tyre ndërkohë që ata vazhdojnë studimet. Ka mijëra bashkëshortë që kanë punuar gjatë studimeve dhe po në të njëjtën kohë janë kujdesur për familjet e tyre" ("Marriage Is Honorable," in *Speeches of the Year, 1973* [1974], 263).

Roli i Nënës në Shtëpi

Vëllezër të priftërisë, vazhdoj të nënvizoj rëndësinë që nënat të rrinë në shtëpi për të ushqyer e për t'u kujdesur për fëmijët e tyre dhe për t'i edukuar ata me parimet e drejtësisë.

Ndërsa udhëtoj në mbarë Kishën, e ndiej se një pjesë e madhe e nënave shenjtoje të ditëve të mëvonshme dëshirojnë sinqerisht ta ndjekin këtë këshillë. Por e dimë se ndonjëherë nëna punon jashtë shtëpisë me nxitjen, ose madje me insistimin e të shoqit. Është ai që dëshiron komoditetet që mund të blihen me më shumë të ardhura. Në raste të tilla do të vuajë jo vetëm familja, vëllezër, por rritja dhe përparimi juaj shpirtëror do të pengohet. Ju them të gjithëve ju, Zoti i ka ngarkuar burrat me përgjegjësinë për t'u kujdesur për familjet e tyre në mënyrë të tillë që bashkëshortja të lejohet të përmbushë rolin e saj si nënë në shtëpi.

Përgatitja Familjare më Urgjente Sot

Baballarë, një tjetër aspekt jetësor i sigurimit të nevojave materiale për familjen tuaj janë edhe masat që duhet të merrni për familjen tuaj në rast të një të papriture. Përgatitja familjare ka qenë një parim i mirëqenies për një kohë të gjatë. Ajo është edhe më urgjente sot.

Ju pyes sinqerisht, a keni siguruar për familjen tuaj një rezervë një-vjeçare ushqimore, veshje dhe aty ku është e mundur edhe lëndë djegëse? Zbulesa për të prodhuar dhe krijuar rezerva ushqimore mund të jetë po aq jetësore për mirëqenien tonë fizike sa ç'ishte edhe hipja në arkë për njerëzit në kohën e Noeut.

Gjithashtu, a po jetoni me aq të ardhura sa keni duke kursyer nga pak?

A jeni të ndershëm me Zotin në pagimin e të dhjetave? Të jetuarit e këtij ligji hyjnor do të sjellë beki-me si shpirtërore ashtu edhe materiale.

Po, vëllezër, si etër në Izrael ju keni përgjegjësinë e madhe për të siguruar nevojat materiale të familjes tuaj dhe të merrni masat e nevojshme në rast të një të papriture.

Jepni Udhëheqje Shpirtërore

Së dyti, ju keni një përgjegjësi të shenjtë të siguro-ni udhëheqje shpirtërore për familjen tuaj.

Në një pamflet të botuar disa vite më parë nga Këshilli i të Dymbëdhjetëve, thamë sa më poshtë: "Atësia është udhëheqje — lloji më i rëndësishëm i udhëheqjes. Gjithmonë ka qenë kështu; gjithmonë do të jetë kështu. Ti baba, me ndihmën, këshillën dhe inkurajimin e shoqes tënde të përjetshme, kryeson në shtëpi" (*Father, Consider Your Ways* [pamphlet, 1973], 4-5).

Megjithatë, bashkë me atë detyrë kryesuese vijnë edhe detyrime të rëndësishme. Ndonjëherë dëgjojmë histori për burra, madje edhe brenda Kishës, që mendojnë se të qenit kreu i shtëpisë në një farë mënyre i vendos në një rol superior dhe i lejon të diktojnë dhe të komandojnë në familjen e tyre.

Apostulli Pal vë në dukje se "sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës" (Efesianëve 5:23; germa kursive janë shtuar). Ky është modeli që duhet të ndjekim në rolin tonë për të kryesuar në shtëpi. Nuk e shikojmë asnjëherë Shpëtimtarin ta drejtojë Kishën me ashpërsi ose vrazhdësi. Nuk e shikojmë asnjëherë Shpëtimtarin ta trajtojë Kishën e Tij pa respekt ose ta lërë pas dore. Nuk e shikojmë Shpëtimtarin të përdorë forcë ose shtrëngim për të përmbushur qëllimet e Tij. Asnjëherë nuk e shikojmë Shpëtimtarin të bëjë ndonjë gjë që nuk e ngre moralisht, nuk e frymëzon,

ngushëllon dhe lartëson Kishën. Vëllezër, ju them me gjithë solemnitët, Ai është modeli që duhet të ndjekim, ndërsa marrim në dorë udhëheqjen shpirtërore të familjeve tona.

Kjo është veçanërisht e vërtetë në marrëdhëniet me bashkëshortet tuaja.

Duajeni Bashkëshorten Tuaj

Ja përsëri një këshillë nga më të bukurat dhe më të drejtëpërdrejtat nga Apostulli Pal. Ai tha thjesht: “Ju, burra, t’i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të” (Efesianëve 5:25).

Në zbulesën e ditëve të mëvonshme Zoti flet përsëri mbi këtë detyrim. Ai tha: “Duaje bashkëshorten tënde me gjithë zemër dhe do të kapesh pas saj e pas askujt tjetër” (DeB 42:22). Me sa di unë në të gjithë shkrimet e shenjta ekziston vetëm dikush që jemi urdhëruar ta duam me gjithë zemër dhe ai është Vetë Perëndia. Mendoni se ç’do të thotë kjo!

Këtë lloj dashurie mund t’ua tregoni bashkëshorteve tuaja në shumë mënyra. E para dhe më e rëndësishmja, asgjë përveç Perëndisë Vetë nuk ka përparësi në jetë përpara bashkëshortes tënde — as puna, as shlodhja, as aktivitetet argëtuese. Bashkëshortja jote është ndihmësja jote e shtrenjtë dhe e përjetëshme — shoqja jote.

Çfarë do të thotë ta duash dikë me gjithë zemër? Do të thotë ta duash me gjithë ndenjat e tua emocionale dhe me gjithë përkushtimin tënd. Sigurisht kur e do bashkëshorten tënde me gjithë zemër, nuk mund ta poshtërosh, ta kritikosh, ta fajësosh ose ta abuzosh me fjalë, sjellje ose veprime të vrazhda.

Çfarë do të thotë të “kapesh pas saj”? Do të thotë t’i qëndrosh pranë, t’i jesh besnik, të komunikosh me të dhe t’i shprehësh dashurinë.

Dashuri do të thotë të jesh i ndjeshëm ndaj ndjenjave dhe nevojave të saj. Ajo dëshiron të ketë vëmendjen dhe të vlerësohet. Ajo dëshiron që ti t’i thuash se për ty ajo është e bukur, tërheqëse dhe e rëndësishme. Dashuri do të thotë ta vësh të mirën dhe vetë-vlerësimin e saj si një përparësi të lartë në jetë.

Ti duhet të jesh mirënjohës që ajo është nëna e fëmijëve të tu dhe mbretëresha e shtëpisë tënde, mirënjohës që ajo ka zgjedhur shtëpinë dhe amësinë — për të lindur, ushqyer, dashur dhe edukuar fëmijët e tu — si thirrjen më fisnike.

Bashkëshortë, vini në dukje inteligjencën e bashkëshortes tuaj, aftësinë e saj për t’u këshilluar me ju si një partnere e vërtetë në lidhje me planet e

familjes, aktivitetet familjare dhe buxhetin e familjes. Mos jini cingunë me kohën dhe të ardhurat tuaja.

Jepini asaj mundësinë për t’u rritur intelektualisht, emocionalisht, shoqërisht si edhe shpirtërisht.

Mbani mend vëllezër, dashuria mund të rritet dhe ushqehet me veprime të vogla. Lulet në një rast të veçantë janë të mrekullueshme, por po kështu është edhe gatishmëria juaj për të ndihmuar me enët, për të ndërruar pelenat, për të mbajtur në mes të natës fëmijën që qan dhe për ta lënë televizorin ose gazetën për të ndihmuar me darkën. Këto janë mënyra të heshtura për të thënë “të dua” me veprimet tuaja. Ato sjellin fitime tepër të pasura për një përpjekje kaq të vogël.

Kjo lloj udhëheqje priftërie me dashamirësi vlen për fëmijët tuaj si edhe për bashkëshorten tuaj.

Roli i Babait në Shtëpi

Nëna luan një rol të rëndësishëm si qendra e familjes, por kjo nuk e pakëson në asnjë mënyrë rolin po aq të rëndësishëm që duhet të luajë babai si kreu i shtëpisë, për t’i rritur, edukuar dhe dashur fëmijët e tyre.

Si patriarku në shtëpinë tuaj, ju keni një përgjegjësi solemne për të marrë përsipër udhëheqjen për të punuar me fëmijët tuaj. Ju duhet të ndihmoni për të krijuar një shtëpi ku mund të banojë Shpirti i Zotit. Detyra juaj është të drejtoni të gjithë jetën familjare. Ju duhet të merrni pjesë aktivisht në vendosjen e rregullave dhe disiplinës në familje.

Shtëpia duhet të jetë qiell paqeje dhe gëzimi për familjen tuaj. Me siguri asnjë fëmijë nuk duhet të ketë frikë nga i babai i tij — veçanërisht nga një baba që mban priftërinë. Detyra e një babai është ta bëjë shtëpinë e tij një vend lumturie dhe gëzimi. Ai nuk mund ta bëjë këtë kur ka grindje, zënka, mosmarëveshje ose sjellje të padrejtë. Efekti i fuqishëm i baballarëve të drejtë në dhënien e një shembulli, disiplinimit dhe edukimit, kujdesin dhe dashurinë është jetësore për mirëqenien shpirtërore të fëmijëve të tij.

Jepni Udhëheqje Shpirtërore

Me dashuri në zemër për etërit në Izrael, më lejoni të sugjeroj dhjetë mënyra specifike se si baballarët mund t’u japin udhëheqje shpirtërore fëmijëve të tyre.

1. U jepni bekime atërore fëmijëve tuaj. Pagëzojini dhe konfirmojini ata. Shugurojini bijtë tuaj në priftëri. Këto do të bëhen çaste të shënuara shpirtërore në jetën e fëmijëve tuaj.

2. Drejtoni personalisht lutjet familjare, leximin e përditshëm të shkrimeve të shenjta dhe mbrëmjet e përjavshme familjare. Angazhimi juaj personal do t'ju tregojë fëmijëve se sa të rëndësishme janë këto aktivitete për ju.

3. Sa herë është e mundur, shkoni në mbledhjet e Kishës së bashku si familje. Adhurimi familjar nën udhëheqjen tuaj është jetësor për mirëqenien shpirtërore të fëmijëve tuaj.

4. Dilni në takime at-bijë dhe në ekskursionet at-bir me fëmijët tuaj. Shkoni në kampime dhe piknikë si familje, në ndeshje futbollit dhe recitale, në programet shkollore etj. Kur babi është atje çdo gjë është ndryshe.

5. Krijoni tradita për pushime familjare, udhëtime dhe ekskursionet. Këto kujtime nuk do të harrohen kurrë nga fëmijët tuaj.

6. Zhvilloni takime të rregullta individuale me fëmijët tuaj. U jepni mundësinë të flasni për çfarë të duan. Mësojuni parimet e ungjillit. Mësojuni vlera të vërteta. U thoni se i doni. Koha personale me fëmijët i lë atyre të kuptojnë se babi di si ti vendosë përparësitë e tij.

7. Mësojuni fëmijëve tuaj të punojnë dhe tregojni vlerën e punës për një qëllim të drejtë. Krijimi i fondeve të misionit dhe fondeve të shkollimit për fëmijët tuaj u tregon atyre se babi i konsideron këto gjëra të rëndësishme.

8. Inkurajoni muzikë, art dhe literaturë të mirë në shtëpitë tuaja. Shtëpitë që kanë një shpirt finese dhe bukurie do të bekojnë jetën e fëmijëve të tyre përgjithmonë.

9. Aq sa jua lejon largësia, frekuentoni rregullisht tempullin me bashkëshorten tuaj. Atëherë fëmijët tuaj do ta kuptojnë më mirë rëndësinë e martesës në tempull, betimeve të tempullit dhe njësisë së përjetshme familjare.

10. I lejoni fëmijët të vërejnë gëzimin dhe kënaqësinë që ju sjell shërbimi në Kishë. Kjo mund t'ju transmetohet edhe atyre, që edhe ata do të kenë dëshirën për të shërbyer në Kishë dhe ta duan mbretërinë.

Thirrja Juaj më e Rëndësishme

Oh, bashkëshortë dhe etër në Izrael, ju mund të bëni kaq shumë për shpëtimin dhe ekzaltimin e familjeve tuaja! Përgjegjësitë tuaja janë shumë të rëndësishme.

Kujtoni thirrjen tuaj të shenjtë si një baba në Izrael — thirrja juaj më e rëndësishme për këtë kohë dhe për përjetësinë — një thirrje nga e cila kurrë nuk do të liroheni.

Uroj që ju të siguroni gjithmonë nevojat materiale të familjes tuaj dhe së bashku me shoqen tuaj të përjetshme përkrah jush, të mund të përmbushni përgjegjësinë e shenjtë për të siguruar udhëheqje shpirtërore në shtëpinë tuaj.

Nga një fjalim i Presidentit Benson në sesionin e priftërisë të konferencës së përgjithshme të tetorit 1987 (shih Conference Report, tetor 1987, 59-63; ose *Ensign*, nëntor 1987, 48-51).

ROLET E SHENJTA TË BABALLARËVE DHE NËNAVE

11

PJESA 2: ROLET E NËNAVE

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Në proklamaten për familjen, jemi këshilluar se “etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë” (shih faqe iv të këtij udhëzuesi studimor). Me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj, rishikoni dhjetë sugjerimet e Presidentit Ezra Taft Benson për baballarët, në faqet 42-43 të këtij udhëzuesi studimor dhe dhjetë sugjerimet për nënat, në faqet 47-48. Diskutoni se në ç’mënyrë mund të punoni së bashku dhe si ta mbështesni njëri-tjetrin në këto përgjegjësi.
- Shkruajini një letër nënës ose gjyshes tuaj.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikujt e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojini dhe diskutojini artikujt me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

“SEPSE ËSHTË NËNË”

Plaku Xhefri R. Holland
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Nderim Nënave

Në disa rreshta që i atribuohen Viktor Hygosë thuhet:

“Ajo e ndau bukën në copa dhe ua dha fëmijëve të saj, që e hëngrën me uri. ‘Për vete nuk ruajti asnjë kafshatë,’ psherëtiu rreshteri.

‘Sepse nuk ishte e uritur,’ tha një ushtar.

‘Jo,’ tha rreshteri, ‘sepse është nënë.’”

Në këtë vit kur po festojmë besimin dhe guximin e atyre që bënë udhëtimin e mundimshëm përmes Ajuas, Nebraskës dhe Uaioming, dëshiroj të nderoj homologet moderne të atyre nënave pioniere që u kujdesën, u lutën dhe shumë shpesh varrosën foshnjat e tyre gjatë atij marshimi të gjatë. Atyre grave që po më dëgjojnë që dëshirojnë aq shumë të jenë nëna, por që ende nuk janë, unë ju them përmes lotëve tuaj dhe lotëve tanë për këtë çështje se do të vijë koha kur Perëndia do t’i sjellë “shpresë shpirtit [tuaj]”¹. Ashtu si profetët kanë mësuar vazhdimisht nga kjo katedër, në fund “asnjë bekim nuk do të mbahet” prej besnikëve, edhe pse këto bekime nuk vijnë menjëherë². Ndërkohë ne gëzohemi që thirrja që kemi për t’u kujdesur nuk kufizohet vetëm me ata të mishit e gjakut tonë.

Kur u flas nënave nuk harroj edhe rolin vendimtar dhe të ngutshëm të baballarëve, duke qenë se pikërisht mungesa e babait në shtëpitë e tanishme konsiderohet nga disa si “problemi kryesor social i kohës sonë”³. Me të vertetë, mungesa e babait mund të jetë një problem madje edhe në një shtëpi ku babai është i pranishëm — por që si të themi ha dhe fle “pranë telekomandës.” Por ky përbën një mesazh për priftërinë një herë tjetër. Sot dëshiroj të përgëzoj ato duar nënash që kanë tundur djepin e foshnjave dhe që me drejtësinë e mësuar fëmijëve që në djep, janë në qendër të qëllimeve të Zotit për ne në vdekshmëri.

Këtë e bëj duke jehuar fjalët e Palit, i cili shkroi për të përgëzuar Timoteun për “besimin e sinqertë. . . , i cili më parë ishte te gjyshja jote Loide dhe te nëna jote Eunike”⁴. “Se që nga fëmijëria” tha Pali “i njeh Shkrimet e shenjta”⁵. Ne i falënderojmë të gjitha nënat dhe gjyshet nga të cilat janë mësuar të tilla të vërteta që në kohët e hershme.

Sakrificat e Nënave të Reja

Kur flas për nënat në përgjithësi, dëshiroj të përgëzoj dhe të inkurajoj veçanërisht nënat e reja. Puna e nënës është e vështirë, shpesh një punë e heshtur. Vitet e para janë shpesh ato vite kur ose bashkëshorti ose bashkëshortja — ose të dy bashkë — mund të jenë ende në shkollë ose në etapat e para dhe ende të paformuara të zhvillimit të aftësive fitimprurëse të bashkëshortit. Financat lëkunden çdo ditë midis niveleve të ulta dhe inekzistente. Apartamenti

zakonisht zbkurohet me një ose dy zbkurime elegante — nga dyqanet e dorës së dytë. Makina, nëse kanë një të tillë, ecën mbi rrota të shfryra dhe me një serbator bosh. Por për shkak të netëve pa gjumë për të ushqyer dhe për të qetësuar të qarat në kohën e daljes së dhëmbëve, shpesh sfida më e madhe për një nënë të re është thjesht lodhja. Gjatë këtyre viteve, nënat flenë më pak dhe u falin më tepër të tjerëve duke menduar më pak për rehatinë personale sesa çdokush tjetër në ndonjë etapë tjetër të jetës. Nuk është për t'u habitur që hijet nën sytë e tyre janë gjithmonë të mëdha.

Sigurisht ironia, është se shpesh, është pikërisht kësaj motre që duam t'i japin një thirrje — ose që na duhet ta thërrasim për të shërbyer në organizatat ndihmëse të lagjes dhe kunjit. Dhe kuptohet. E kush nuk do ta dëshironte ndikimin shembullor të këtyre nënave të reja që po bëhen si gjyshja e Timoteut, Loide, dhe nëna e tij Eunike? Tregohuni të mençur të gjithë. Mbani mend se familjet janë përparësia më e lartë, veçanërisht gjatë atyre viteve formuese. E megjithatë, nënat e reja ende do të gjejnë mënyra të mrekullueshme për të shërbyer me besnikëri në Kishë, ashtu sikurse të tjerët u shërbejnë dhe i forcojnë ato dhe familjet e tyre po në të njëjtën mënyrë.

Bëni aq sa të mundeni gjatë këtyre viteve, por mbi të gjitha vlerësoni atë rol që është aq unik për ju dhe të për të cilin vetë qielli dërgon engjëj për t'u kujdesur për ju dhe të vegjëlit tuaj. Bashkëshortë — veçanërisht ju bashkëshortë — si edhe udhëheqës të Kishës e miq ngado, jini gati për të ndihmuar, jini të ndjeshëm dhe të mençur. Kujtoni “Çdo gjë ka stinën e vet, çdo situatë ka një kohë nën qiell”⁶.

Nëna, ne e njohim dhe e vlerësojmë besimin tuaj në çdo hap. Ju lutemi dijeni se ajo që po bëni është e vlefshme dhe, sot e përgjithmonë. Dhe nëse, për çfarëdo lloj arsyeje, po e bëni të vetme këtë përpjekje të guximshme, pa pasur bashkëshortin përkrah, atëherë lutjet tona do të jenë akoma më të mëdha për ju dhe vendosmëria jonë për t'ju ndihmuar edhe më e fortë.

Nënat Kryejnë Punën e Perëndisë

Një nënë e re më shkroi kohët e fundit se ankthi i saj vinte nga tre drejtime. Njëri prej tyre ishte se sa herë që dëgjonte biseda mbi nënat shenjtoreshë të ditëve të mëvonshme, shqetësohej, sepse mendonte se nuk ishte në lartësinë e duhur ose që në një farë mënyre nuk po bënte atë që kërkon detyra. Së dyti, mendonte se bota priste që ajo t'u mësonte fëmijëve shkrim e këndim, mobilimin e shtëpisë, latinisht, njehsime dhe Internetin — dhe të gjitha këto para se foshnja të fillonte të belbëzonte. Së treti, ajo shpesh mendonte se njerëzit tregoheshin disi poshtërues, pothuajse gjithmonë pa dashur të jenë të tillë, sepse

edhe këshillat që merrte ose madje edhe komplimentet dukeshin se nuk pasqyronin asgjë nga investimi mendor, përpjekja shpirtërore dhe emocionale, netët e ditët e gjata, kërkesat deri aty ku s'mban më që ndonjëherë kërkohen kur po përpiqesh të jesh dhe kur do të jesh ajo nënë që Perëndia shpreson të jesh.

Por një gjë, tha ajo, i dha forcë të shkonte përpara: “Përmes të mirave e vështirësive të gjithë kësaj dhe përmes lotëve të herëpashershëm, *unë e di thellë brenda vetes se po bëj punën e Perëndisë*. E di se në amësinë time jam në partneritet të përjetshëm me Atë. Prekem thellë nga fakti që Perëndia e gjen qëllimin dhe kuptimin e Tij final në të qenit prind, madje edhe nëse disa prej fëmijëve të Tij e bëjnë të vajojë.

“Është pikërisht, ky mendim,” thotë ajo “që përpigem ta sjell ndër mend gjatë atyre ditëve pashmangshmërisht të vështira kur e gjithë kjo mund të jetë dërmuese. Ndoshta është pikërisht paaftësia dhe ankthi ynë që na nxisin t'i drejtohem Atij dhe të vëmë në pah aftësinë e Tij për të na u përgjigjur. Mbase Ai shpreson me vete se ne *do të jemi të shqetësuar*,” tha ajo “*do të përgjërohemi për ndihmën e Tij*. E më pas, besoj se Ai mund t'i mësojë këta fëmijë drejtpërsëdrejti, nëpërmjet nesh, por pa asnjë lloj qëndrese. Më pëlqen kjo ide,” përfundon ajo. “Më jep shpresë. Nëse jam e denjë para Atit tim në Qiell, ndoshta udhëheqja e Tij për fëmijët tanë mund të jetë pa pengesa. Ndoshta atëherë kjo mund të jetë me të vërtetë puna e Tij dhe lavdia e Tij”⁷.

Fëmijët e Tu do të Quajnë të Bekuar

Nën dritën e kësaj shprehje, është e qartë se disa nga ato sy të lodhur vijnë jo vetëm prej pelenave dhe shoqërimit të fëmijëve nëpër aktivitete, por nga të paktën disa netë pa gjumë duke hetuar shpirtin, duke kërkuar me zell aftësinë për t'i rritur këta fëmijë që të bëhen ashtu siç do Perëndia. I prekur nga ky përkushtim dhe vendosmëri, më lejoni t'u them nënave kolektivisht, në emrin e Zotit, jeni të madhërishtme. Ju po bëni një punë të jashtëzakonshme. Vetë fakti që ju është dhënë një përgjegjësi e tillë është provë e përjetshme e besimit që Ati juaj në Qiell ka tek ju. Ai e di se lindja e një fëmije nuk ju bën menjëherë të gjithëdiqshme. Në qoftë se ju dhe bashkëshorti juaj do të përpiqeni ta doni Perëndinë dhe të jetoni ungjillin; nëse do të luteni për atë udhëheqje e ngushëllim nga Shpirti i Shenjtë që u është premtuar besnikëve; nëse do të shkoni në tempull për të bërë dhe kërkuar premtimet e besëlidhjeve nga më të shenjtat që një grua dhe një burrë mund të bëjnë në këtë botë; nëse do t'u tregoni të tjerëve, përfshirë edhe fëmijëve tuaj, po të njëjtën zemër të ndjeshme, të dhembshur, të gatshme për të falur që doni që edhe Zoti të tregojë ndaj jush; nëse përpiqeni më sa fuqi keni për të qenë prindi më i mirë që mundeni,

atëherë do të keni bërë gjithçka që një qenie njerëzore mund të bëjë dhe gjithçka që Perëndia pret nga ju.

Ndonjëherë vendimi i një fëmije ose nipi a mbese do t'ju thyejë zemrën. Ndonjëherë shpresat nuk do të realizohen menjëherë. Çdo nënë e çdo baba shqetësohet për këtë. Madje edhe ai prind i dashur dhe mrekullisht i sukseshëm Presidenti Jozef F. Smith u përgjyera: "Oh! Perëndi, më ndihmo të mos humbas [fëmijët] e mi"⁸. Kjo është lutja e çdo prindi dhe brenda saj ka diçka nga frika e çdo prindi. Por askush që vazhdon të përpiket dhe të lutet nuk ka dështuar. Ju keni çdo të drejtë të luteni për të marrë kurajo dhe për të ditur se në fund fëmijët do t'ju quajnë të bekuar, pikërisht si brezat e atyre nënave që jetuan para jush dhe që kishin të njëjtat shpresa dhe që ndjenë të njëjtën frikë si edhe ju.

Juve ju përket traditat e madhërishtme e Evës, nënës së mbarë familjes njerëzore, ajo që e kuptoi se Adami *duhej* të binte më qëllim që "njerëzit të mund të jenë"⁹ dhe që të kenë gëzim. Juve ju përket tradita e madhërishtme e Sarës, Rebekës dhe Raketës, pa të cilat nuk do t'i kishin ardhur ato premtimet e mrekullueshme patriarkale Abrahamit, Isakut dhe Jakobit që na bekojnë të gjithëve ne. Juve ju përket tradita e madhërishtme e Loides dhe Eunikes dhe e nënave të 2,000 luftëtarëve të rinj. Juve ju përket tradita e madhërishtme e Maries, e zgjedhur dhe e parachuguruar që para krijimi të botës, për të ngjizur, për të mbajtur dhe për të lindur Birin e Vetë Perëndisë. Ne ju falënderojmë ju, përfshirë edhe nënat tona dhe ju themi se nuk ka asgjë më të rëndësishme në këtë botë se sa të marrësh pjesë drejtëpërsëdrejti në punën dhe lavdinë e Perëndisë për t'i sjellë vdekshmërinë dhe jetën tokësore bijave e bijëve të Tij, kështu që pavdekësia dhe jeta e përjetshme të mund të vijë lart në mbretërinë celestiale

Mbështetuni te Shpëtimtari Përgjithmonë

Kur shkoni te Zoti me zemërbutësi e përlulesi të zemrës dhe, ashtu siç tha një nënë, "trokisnin fort në portat e qiellit për t'u lutur, për t'u përgjyruar, për të kërkuar udhëheqje, urtësi e ndihmë për këtë detyrë të mrekullueshme," ajo portë hapet dykanatësh për

t'ju dhënë ndikimin dhe ndihmën e gjithë përjetësisë. Kërkoni premtimet e Shpëtimtarit të botës. Lutuni për balsamin shërues të Shlyerjes për çfarëdo gjëje që mund t'ju shqetësojë ju ose fëmijët tuaj. Dijeni se me besim çdo gjë do të zërë vend pavarësisht nga ju, ose më saktësisht, për shkakun tuaj.

Nuk është e mundur ta bëni këtë vetëm, por ju *këni* ndihmë. Mjeshtri i Qiellit dhe i Tokës është aty për t'ju bekuar — Ai që shkon me vendosmëri pas deles së humbur, fshin gjithandej për të gjetur dhraminë e humbur, pret përjetësisht për rikthimin e djallit plangprishës. Juve ju përket puna e shpëtimit dhe për këtë arsye do të lartësoheni, do të kompensoheni, do të bëheni më tepër nga ç'jeni dhe më të mira nga ç'keni qenë ndonjëherë, ndërsa përpiqeni për të bërë një përpjekje të sinqertë, pavarësisht sa e dobët mund t'ju duket ndonjëherë kjo përpjekje.

Kujtoni, kujtoni gjatë gjithë ditëve të amësisë tuaj: "Ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë"¹⁰.

Mbështetuni tek Ai. Mbështetuni tek Ai me gjithë forcën tuaj. Mbështetuni tek Ai përgjithmonë. Dhe "shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës"¹¹. Ju po bëni punën e Perëndisë. Dhe po e bëni atë jashtëzakonisht mirë. Ai po ju bekon dhe do t'ju bekojë, madje — jo, *veçanërisht* — kur ditët dhe netët tuaja të jenë më të vështira. Si gruaja që fshehtas, me urtësi e ndoshta me ngurrim dhe një ndjenjë turpi çau përmes turmës për të prekur cepin e rrobës së Mësuesit, po ashtu Krishti do t'u thotë grave që shqetësohen dhe dyshojnë dhe ndonjëherë vajtojnë mbi përgjegjësinë e tyre si nëna: "Merr zemër, o bijë; besimi yt të ka shëruar"¹². Dhe po kështu do të shërojë edhe fëmijët tuaj.

Nga një fjalim i Plakut Holland në konferencën e përgjithshme të prillit 1997 (shih Conference Report, prill 1997, 46-49; or *Ensign*, maj 1997, 35-37).

SHËNIME

1. "Shëlbues i Izraelit," Himne dhe Këngë të Fëmijëve, fq. 5, shih gjithashtu 2 Nefi 22:1.
2. Shih Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, comp. Bruce R. McConkie, 3 vols. (1954-56), 2:76; Harold B. Lee, *Ye Are the Light of the World: Selected Sermons and Writings of President Harold B. Lee* (1974), 292; dhe Gordon B. Hinckley, në Conference Report, prill 1991, 94.
3. Tom Lowe, "Fatherlessness: The Central Social Problem of Our Time," Claremont Institute Home Page Editorial, janar 1996.
4. 2 Timoteu 1:5.
5. 2 Timoteu 3:15.
6. Predikuesi 3:1.
7. Letërkëmbim personal
8. Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, 5th ed. (1939), 462.
9. 2 Nefi 2:25.
10. 2 Nefi 31:19.
11. 2 Nefi 31:20.
12. Mateu 9:22.

NËNAVE NË SION

Presidenti Ezra Taft Benson
Presidenti i 13-të i Kishës

Nëna në Sion, rolet që ju janë caktuar nga Perëndia janë aq jetësore për vetë ekzaltimin tuaj dhe për shpëtimin dhe ekzaltimin e familjes tuaj, Një fëmijë ka nevojë për nënën e tij më tepër se për çdo gjë tjetër që mund të blihet me para. Koha që kaloni me fëmijët tuaj është dhurata më e madhe ndër të gjitha dhuratat e tjera.

Me dashuri në zemër për nënat në Sion, tani do të doja të sugjeroja dhjetë mënyra specifike se si nënat tona mund të kalojnë kohë efikase me fëmijët e tyre.

Jini të Pranishme në Çastet Vendimtare. Së pari, bëni kohë për të qenë të pranishme në çastet vendimtare kur fëmijët ose po kthehen ose po largohen — kur shkojnë dhe kur kthehen nga shkolla, kur shkojnë dhe kthehen nga takimet, kur sjellin një mik në shtëpi. Jini të pranishme në çastet vendimtare qoftë kur fëmijët janë gjashtë ose gjashtëmbëdhjetë vjeç. Në Fjalët e Urta lexojmë: “Fëmija për të cilën nuk kujdeset kurrkush e turpëron nënën e vet” (Fjalët e Urta 29:15). Ndër shqetësimet më të mëdha të shoqërisë sonë janë miliona fëmijë me çelës në qafë që çdo ditë kthehen në shtëpi të boshatisura, pa mbikëqyerjen e prindërve që punojë.

Jini mike e Vërtetë. Së dyti, nëna, kërkoni kohë për të qenë një mike e vërtetë për fëmijët tuaj. Dëgjojini fëmijët tuaj, dëgjojini më të vërtetë. Flisni me ta, qeshni dhe bëni shaka me ta, këndon, luani, qani me ta, përqafojini, përgëzojini sinqerisht. Po, rregullisht kaloni kohë individualisht me çdo fëmijë pa qenë në nxitim. Jini një mike e vërtetë për fëmijët tuaj.

Lexojini Fëmijëve Tuaj. Së treti, nëna, kërkoni kohë për t’iu lexuar fëmijëve tuaj. Duke filluar që në djep, lexojini bijëve e bijave tuaja. Mbani mend çfarë tha poeti:

Pasuri të paparë mund të kesh;
Arka me margaritarë e kuti me ar.
Por më i pasur se un’ kurrë s’mund të jesh —
Un’ kisha një nënë që më lexonte.
(Strickland Gillilan, “The Reading Mother.”)

Ju do të rrënjosni dashurinë për librat e mirë dhe dashurinë e vërtetë për shkrimet e shenjta nëse u lexoni rregullisht fëmijëve tuaj.

Lutuni me Fëmijët Tuaj. Së katërti, bëni kohë për t’u lutur me fëmijët tuaj. Lutjet familjare, nën drejtimin e babait, duhet të mbahen çdo mëngjes dhe mbrëmje. I lejoni fëmijët të ndjejnë besimin tuaj nërsa luteni që bekimet e qiellit të bien mbi ta. Duke përfrazuar fjalët

e Jakobit, “Shumë fuqi ka lutja e [një nënë të drejtë] kur bëhet me gjithë shpirt” (Jakobi 5:16 [Dhjata e Re]). U kërkoni fëmijëve të marrin pjesë në lutjet familjare dhe të luten individualisht dhe gëzohuni në fjalët e ëmbla që ata i drejtojnë Atit të tyre në Qiell.

Zhvilloni Mbrëmje Familjare Çdo Javë. Së pesti, bëni kohë çdo javë për të zhvilluar një mbrëmje familjare kuptimplotë. Së bashku me bashkëshortin tuaj që kryeson merrni pjesë çdo javë në një mbrëmje familjare shpirtërore e frymëzuese. Përfshijini aktivisht fëmijët. U mësoni atyre parime të sakta. Bëjeni këtë një nga traditat e rëndësishme të familjes. Mbani mend premtimin e mrekullueshëm nga Presidenti Jozef F. Smith kur i prezantoi për herë të parë Kishës mbrëmjen familjare: “Nëse shenjtorët do t’i binden kësaj këshille, ju premtojmë se do t’iu vijjnë bekime të mëdha. Dashuria në shtëpi dhe bindja ndaj prindërve do të rritet. Besimi do të zhvillohet në zemrat e rinisë së Izraelit dhe ata do të marrin forcë për të luftuar ndikimin e ligë dhe tundimet që i rrethojnë” (në James R. Clark, comp., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 6 vols. [1965-75], 4:339). Ky premtim është ende në fuqi edhe sot.

Hani së Bashku. Së gjashti, krijoni mundësi që të hani së bashku sa më shpesh të jetë e mundur. Kjo bëhet e vështirë ndërsa fëmijët rriten dhe jeta bëhet më e ngarkuar. Por biseda të gëzueshme, diskutimi i planeve dhe aktiviteteve të ditës dhe çaste të veçanta mësimi ndodhin rreth tryezës së ngrënies, sepse nënat, baballarët dhe fëmijët përpiqen për këtë.

Lexoni Çdo Ditë Shkrimet e Shenjta. Së shtati, kërkoni kohë çdo ditë për të lexuar shkrimet e shenjta si një familje. Leximi individual i shkrimeve të shenjta është i rëndësishëm, por leximi familjar i shkrimeve të shenjta është jetësor. Leximi i Librit të Mormonit së bashku si një familje do të sjellë veçanërisht një rritje të shpirtshmërisë në shtëpinë tuaj dhe do t’u japi prindërve dhe fëmijëve fuqinë për t’i bërë ballë tundimeve dhe për të pasur Frymën e Shenjtë si mikun e tyre të përhershëm. Unë ju premtoj se Libri i Mormonit do të ndryshojë jetën e familjes tuaj.

Bëni Gjëra së Bashku si një Familje. Së teti, bëni kohë për të bërë gjëra së bashku si një familje. Bëjini ekskursionet familjare, pikniqet, festimet e ditëlindjeve dhe udhëtimet kohë të veçanta dhe mundësi për të krijuar kujtime. Sa herë të jetë e mundur, merrni pjesë si një familje në veprimtari ku përfshihet njëri nga anëtarët e familjes, të tilla si lojra të shkollës, ndeshje futbollit, biseda, recitale, etj. Shkoni në mbledhjet e kishës së bashku dhe uluni së bashku si një familje sa herë të keni mundësi. Nënat që i ndihmojnë familjet të luten dhe të luajnë së bashku

do të jenë gjithmonë me ta dhe do të bekojnë jetën e fëmijëve përgjithmonë

Mësojini Fëmijët Tuaj. Së nënti, nëna, bëni kohë t'i mësoni fëmijët tuaj. Mos i lini të kalojnë çastet për t'i mësuar fëmijët. Këtë mund ta bëni në çdo çast të ditës — kur jeni duke ngrënë, në situata të zakonshme, ose gjatë kohëve të veçanta kur uleni për të biseduar së bashku, pranë shtratit në fund të një dite, ose gjatë shëtitjeve herët në mëngjes. Nëna, ju jeni mësuesja më e mirë e fëmijëve tuaj. Mos ia kaloni këtë përgjegjësi të çmuar kopshteve ose datove. Dashuria dhe përkujdesja plot lutje e një nëne për fëmijët e vet janë përbërësit e saj më të rëndësishëm për t'i mësuar ata.

U mësoni fëmijëve parimet e ungjillit. U mësoni atyre se mirësia shpërblehet. U mësoni se nuk ka siguri në mëkat. Mësojuni dashurinë për ungjillin e Jezu Krishtit dhe dëshminë e hyjnisë së tij.

U mësoni bijëve e bijave tuaja modestinë në të veshur dhe mësojuni atyre të respektojnë rolet e tyre si burra e gra. U mësoni fëmijëve pastërtinë seksuale, standardet e duhura të daljes në takime, martesën në tempull, shërbimin misionar dhe rëndësinë e pranimi dhe lartësimi të thirrjeve në Kishë.

U mësoni atyre dashurinë për punën dhe vlerën e një shkollimi të mirë.

Mësojuni rëndësinë e argëtimit të duhur, përfshirë filma, video, muzikë, libra dhe revista të përshtatshme. Diskutoni të ligat e pornografisë dhe drogës dhe mësojuni rëndësinë e të jetuarit të një jete të pastër.

Po, nëna, mësojuni fëmijëve tuaj ungjillin në shtëpinë tuaj, rreth vatrës tuaj. Kjo është mënyra më efektive për t'i mësuar fëmijët tuaj. Kjo është mënyra që Zoti përdor për të na mësuar. Kisha nuk mund të mësojë siç mund të mësoni ju. As shkolla nuk mund ta bëjë këtë. As kopshti. Këtë mund ta bëni vetëm ju dhe Zoti do t'iu mbështesë. Fëmijët tuaj do t'iu kujtojnë gjithmonë mësimet tuaja dhe kur të plaken nuk do të largohen prej tyre. Ata do t'iu quajnë të bekuar — nënat e tyre engjëj të vërtetë.

Nëna, ky mësim qiellor prej nëne kërkon kohë — shumë kohë. Nuk mund të bëhet në mënyrë efektive kur i dedikoni vetëm një pjesë të kohës. Duhet bërë

gjatë gjithë kohës me qëllim që të shpëtoni dhe ekzaltoni fëmijët tuaj. Kjo është thirrja juaj hyjnore.

Duajini me të Vërtetë Fëmijët Tuaj. Më në fund së dhjeti, nëna, kërkon kohë për t'i dashur me të vërtetë fëmijët tuaj. Dashuria pa rezerva e një nëne i afrohet dashurisë hyjnore.

Ja një nderim i bukur i një djali për nënën e tij: "Nuk më kujtohet shumë rreth pikëpamjeve të saj gjatë zgjedhjeve as pozitën e saj shoqërore; dhe se cilat ishin idetë e saj për shkollimin, dietën dhe teorinë e për rritjen e fëmijëve nuk mund t'iu kujtoj. E vetmja gjë që më vjen ndërmend tani pas shumë vjetësh është se ajo më donte. Asaj i pëlqente të shtrihej në bar me mua dhe të më tregonte histori, ose të vraponte e të lozte kukafshehtas me ne fëmijët. Ajo më përqafoonte gjithmonë. Dhe kjo më pëlqente. Fytyra e saj ishte plot dritë. Mua më dukej si Perëndia dhe të gjitha uratat që shenjtorët i japin Atij. Dhe i këndojnë! Ndër të gjitha ndjesitë e këndëshme të jetës sime asgjë nuk mund të krahasohet me ngazëllimin që ndjeja ku uleshja në prehërin e saj dhe më zinte gjumi, ndërsa ajo lëkundej në karrigen e saj lëkundëse dhe më këndonte. Kur mendoj për këtë, pyes veten nëse gruaja sot, me të gjitha nocionet e planet e saj të jashtëzakonshme, e kujton se ç'faktor i fuqishëm është në formimin e fëmijës së saj për të mirë ose për të keq. Nuk e di nëse ajo e kupton se sa shumë rëndësi ka në jetën e një fëmije dashuria dhe vëmendja e plotë."

Nëna, edhe fëmijët tuaj adoleshentë kanë nevojë për po të njëjtën dashuri dhe vëmendje. Duket se është më e lehtë për nënat dhe baballartë që të shprehin dhe të tregojnë dashuri për fëmijët kur ata janë të vegjël, por kjo bëhet më e vështirë kur ata rriten. Përpiquni për këtë me lutje. Nuk ka pse të ketë një hendek mes brezave. Dhe çelësi për këtë është dashuria. Të rinjtë tanë kanë nevojë për dashuri dhe vëmendje, jo për t'iu plotësuar çdo dëshirë. Ata kanë nevojë për dhembshuri e mirëkuptim, jo për indiferecë nga ana e nënave dhe baballarëve. Ata kanë nevojë kohën e prindërve. Mësimet e dashura të një nëne dhe dashuria e mirëbesimi i saj tek një djalë ose vajzë adoleshente mund t'iu shpëtojë ata në kuptimin e vërtetë të fjalës nga një botë e ligë.

Nga një fjalim i Presidentit Benson në një mbledhje rreth vatrës më 22 shkurt 1987.

T'I MËSOJMË FËMIJËT NËPËRMJET SHEMBULLIT DHE UDHËZIMIT

12

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërën ose që të dy këto sugjerime.

- Mendoni për nevojat e fëmijëve tuaj ose nevoja e nipërve e mbesave, ose fëmijëve të tjerë që njihni. Planifikoni mundësi për t'i mësuar këta fëmijë nëpërmjet veprimeve dhe fjalëve tuaja.
- Rishikoni materialin mbi mësimdhënien në familje që gjendet *Teaching, No Greater Call* (36123),

faqe 127-43, dhe në *Librin Udhëzues të Familjes* (31180), faqe 3-7. Nëse jeni të martuar, lexoni dhe diskutoni këtë material me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikujt e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojini dhe diskutojini artikujt me bashkëshorten/bashkëshortin tuaj.

SFIDA MË E MADHE NË BOTË — TË JESH NJË PRIND I MIRË

Plaku Xhejms E. Faust
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Qenit Prind Është një Thirrje Hyjnore

Ndihem i prekur të diskutoj për një temë të cilën kam zgjedhur ta quaj si sfida më e madhe në botë. Kjo temë ka të bëjë me privilegjin dhe përgjegjësinë për të qenë prindër të mirë. Mbi këtë temë ka aq shumë mendime sa edhe prindër, e megjithatë ka pak prej tyre që pretendojnë t'i kenë të gjitha përgjigjet. Sigurisht unë nuk jam njëri prej tyre.

Mendoj se ka më tepër të rinj e të reja të jashtëzakonshme midis njerëzve tanë tani sesa kurrë më parë. Kjo presupozon se pjesa më e madhe e këtyre të rinjve të mrekullueshëm kanë ardhur nga familje të mira dhe kanë prindër të përkushtuar e të dashur. E megjithatë, prindërit më të vetëdijsëm ndjejnë se mund të kenë bërë disa gabime. Një herë, kur bëra diçka të pamenduar, më kujtohet se ime më bërtiti "Ku kam gabuar?"

Zoti na ka udhëzuar "T'i rrisni fëmijët tuaj në dritë e të vërtetë" (DeB 93:40). Për mua, nuk ekziston një përpjekje më e madhe njerëzore.

Të qenit një baba ose një nënë nuk është vetëm një sfidë e madhe, por edhe një thirrje hyjnore. Është një përpjekje që kërkon përkushtim. Presidenti David O. Mekei tha se të qenit prind është "besimi

më i madh që u është dhënë qenieve njerëzore" (*The Responsibility of Parents to Their Children* [pamphlet, n.d.] , 1).

Krijimi i Shtëpive të Suksesshme

Ndërsa pak sfida njerëzore janë më të mëdha se të qenit një prind i mirë, pak mundësi ofrojnë një potencial më të madh gëzimi. Sigurisht nuk ka asnjë punë më të rëndësishme në këtë botë sesa përgatitja e fëmijëve tanë për të qenë njerëz besimtarë, të lumtur, të ndershëm dhe punëtorë. Prindërit nuk do të gjejnë lumturi më të kënaqshme se lumturia që do të ndjejnë kur fëmijët do t'i nderojnë ata dhe mësimet e tyre. Kjo është lavdia e të qenit prind. Gjoni dëshmoi: "Nuk kam gëzim më të madh nga ky: të dëgjoj se fëmijët e mi ecin në të vërtetën" (3 Gjoni 1:4). Sipas mendimit tim, të mësuarit, rritja dhe edukimi i fëmijëve kërkon më tepër inteligjencë, mirëkuptim intuitiv, përvullësi, forcë, urtësi, shpirtshmëri, vendosmëri dhe punë sesa ndonjë sfidë tjetër që mund të kemi në jetë. Dhe kjo është veçanërisht e vërtetë në një kohë kur themelet e moralshme të nderit dhe sjelljes së hijshme po rrëzohen. Për të pasur shtëpi të suksesshme, duhen mësuar vlerat dhe duhet të ketë rregulla, duhet të ketë standarde dhe të vërteta absolute. Shumë shoqëri u japin prindërve shumë pak mbështetje në mësimin dhe nderimin e vlerave morale. Një numër i madh kulturash po zhvishen nga të gjitha vlerat dhe shumë nga të rinjtë në këto shoqëri po bëhen cinikë ndaj moralit.

Ndërsa shoqëritë në përgjithësi kanë degraduar dhe kanë humbur identitetin e tyre moral dhe shumë famije janë shkatërruar, shpresa më e mirë është ta kthejmë vëmendjen dhe përpjekjen më të madhe ndaj mësimit të brezit të ri — fëmijëve tanë. Për ta bërë këtë, duhet të përforcojmë së pari mësuesit kryesorë të fëmijëve. Të parët midis këtyre mësuesve janë prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe mjedisi më i mirë duhet të jetë shtëpia. Disi, në një farë mënyre, ne duhet të përpiqemi më shumë për t'i bërë shtëpitë tona më të forta që ato të qëndrojnë si vende të shenjta ndaj moralit të shthurur e depërtues të kalbëzimit që na rrethon. Harmonia, lumturia, paqja dhe dashuria në shtëpi mund të ndihmojë për t'u dhënë fëmijëve forcën e brendshme që i duhet për t'u përballur me sfidat e jetës. Barabara Bush, bashkëshortja e Presidentit të Shteteve të Bashkuara Xhorxh Bush, para disa muajve u tha të diplomuarve të Kolegjit Wellesley:

“Por në çfarëdo epokë, në çfarëdo kohë, një gjë kurrë nuk do të ndryshojë: Etër e nëna, nëse keni fëmijë, ata duhet të vijnë të parët për ju. Ju duhet t'u lexoni fëmijëve tuaj, ju duhet t'i përqaftoni dhe t'i doni fëmijët tuaj. Suksesi juaj si një familje, sukse- si ynë si një shoqëri, nuk varet nga ajo që ndodh në Shtëpinë e Bardhë, por nga ajo që ndodh brënda shtëpisë tuaj” (*Washington Post*, 2 June 1990, 2).

Të qenit një baba i mirë dhe një nënë e mirë kërk- kon që prindërit të shtyjnë plotësimin e shumë prej nevojave e dëshirave të tyre për të plotësuar nevojat e fëmijëve. Si pasojë e kësaj sakrifice, prindërit e kuj- desshëm zhvillojnë një fisnikëri të karakterit dhe mësojnë të vënë në praktikë të vërtetat vetëmohuese të mësuara nga Vetë Shpëtimtari.

Unë kam respektin më të madh për prindërit e vetëm që luftojnë e sakrifikojnë, duke u përpjekur kundër mundësive pothuajse superhumane për ta mbajtur familjen të bashkuar. Ata duhen nderuar dhe ndihmuar në përpjekjet e tyre heroike. Por dety- ra e çdo nënë e babai është shumë më e lehtë kur ka dy prindër që punojnë së bashku në një shtëpi. Fëmijët shpesh e sfidojnë dhe mendojnë forcën dhe urtësinë e të dy prindërve.

Sa Shpesh Lutemi Familjarisht?

Disa vite më parë, Peshkopi Steinli Smut u intervi- stua nga Presidenti Spenser W. Kimbëll. Presidenti Kimbëll e pyeti: “Sa shpesh luteni familjarisht?”

Peshkopi Smut iu përgjigj: “Përpiqemi të lutemi familjarisht dy herë në ditë, por arrijmë të lutemi vetëm një herë.”

Presidenti Kimbëll iu përgjigj: “Në të kaluarën, lutja familjare një herë në ditë mund të ketë qenë e mjaftueshme. Por në të ardhmen nuk do të jetë

e mjaftueshme, nëse duam t'i shpëtojmë familjet tona.”

Nuk e di nëse zhvillimi i mbrëmjeve familjare të paplanifikuara dhe të rralla do të jetë i mjaftueshëm në të ardhmen për të forcuar veten dhe fëmijët tanë me fuqinë e mjaftueshme morale. Në të ardhmen, studimi familjar jo i shpeshtë i shkrimeve të shenjta mund të jetë i pamjaftueshëm për t'i armatosur fëmi- jët tanë me virtytin e nevojshëm për t'i bërë ballë ka- lbjes morale të mjedisit ku jetojnë. Ku tjetër mund të mësojmë fëmijët dëlirësinë, integritetin, ndershmëri- në dhe mirësjelljen elementare njerëzore veçse në shtëpi? Këto vlera, sigurisht që do të përforcohen në kishë, por mësimi i tyre nga ana e prindërve është më i vazhdueshëm.

Prindërit Duhet të Japin Shembullin

Kur prindërit përpiqen t'u mësojnë fëmijëve të shmangin rrezikun, nuk do të ishte një përgjigje e mirë nga ana e tyre t'u thoshin fëmijëve: “Ne jemi me përvojë dhe të mësuar me udhët e botës dhe mund t'i afrohem më pranë buzës së shkëmbit se sa ju.” Hipokrizia e prindërve mund t'i bëjë fëmijët cinikë dhe mosbesues ndaj asaj që u mësohet në shtëpi. Për shembull, kur prindërit shikojnë ato filma të cilët ua ndalojnë fëmijëve, besimi tek prindërit humbet. Në qoftë se fëmijëve u kërkohet të jenë të ndershëm, prindërit duhet të jenë të ndershëm. Në qoftë se fëmijëve u kërkohet të jenë të virtytshëm, prindërit duhet të jenë të virtytshëm. Nëse prisni që fëmijët tuaj të jenë të ndershëm, ju vetë duhet të jeni të ndershëm.

Midis vlerave të tjera që duhet t'u mësohen fëmi- jëve janë respekti për të tjerët, duke filluar me respe- ktin e fëmijëve ndaj prindërve dhe familjes së tij; respekti ndaj simboleve të besimit dhe besimeve pa- triotike të të tjerëve; respekti ndaj ligjit dhe rendit; respekti për pronën e të tjerëve; respekti për autorite- tin. Pali na kujton se fëmijët duhet “të mësojnë më parë të tregojnë perëndishmëri ndaj atyre të familjes së vet” (1 Timoteut 5:4).

Disiplinimi i Fëmijëve

Një nga sfidat më të vështira prindërore është di- siplinimi i duhur i fëmijëve. Rritja e fëmijëve është shumë individuale. Çdo fëmijë është i ndryshëm dhe unik. Ajo që jep rezultate me njërin mund të mos japë rezultate me tjetrin. Nuk e di se kush mund të tregohet tepër i mençur për të thënë se cila lloj disi- pline është tepër e rëndë ose tepër e butë për fëmijët përveç prindërve që i duan aq shumë. Kjo është një çështje gjykimi plot lutje nga ana e prindërve. Sigurisht parimi dominues dhe mbështetës është se disiplinimi i fëmijëve duhet të motivohet më tepër nga dashuria sesa nga ndëshkimi. Brigam Jangu

këshilloi: “Nëse do t’iu duhet ndonjëherë të qortoni dikë, mos e qortoni kurrë më tepër sesa balsami që keni për t’ia shëruar plagën” (*Discourses of Brigham Young*, sel. John A. Widtsoe [1954], 278). Megjithatë drejtimi dhe disiplina, janë sigurisht një pjesë e domosdoshme e rritjes së fëmijës. Në qoftë se prindërit nuk i dispijlojnë fëmijët e tyre, atëherë shoqëria do t’i dispijlojë ata në atë mënyrë që prindërve nuk do t’u pëlqejë. Pa disiplinë fëmijët nuk do të respektojnë as rregullat e shtëpisë as ato të shoqërisë.

Qëllimi kryesor i disiplinës është të mësojë bindje. Presidenti David O. Mekei tha: “Prindërit që nuk arrijnë t’u mësojnë bindjen fëmijëve të tyre, nëse ata nuk zhvillojnë bindjen në shtëpinë e tyre, atëherë shoqëria do ta kërkojë dhe do ta arrijë atë. Prandaj është më mirë që familja, me dashamirësinë, dhemshurinë, dhe mirëkuptimin e saj ta edukojë fëmijën me bindje në vend që ta lërë pa mëshirë në duart e disiplinës brutale dhe të egër që shoqëria do të kërkojë prej tij, nëse familja nuk e ka kryer detyrën e vet” (*The Responsibility of Parents to Their Children*, 3).

Mësojini Fëmijët të Punojnë

Një pjesë thelbësore e mësimi të fëmijëve që ata të jenë të disiplinuar dhe të përgjegjshëm është të mësojnë të punojnë. Ndërsa rritemi, shumë nga ne janë si ai burri që tha: “Më pëlqen puna; më magjeps. Mund të ulem e ta shikoj për orë të tëra” (Jerome Klapka Jerome, in *The International Dictionary of Thoughts*, comp. John P. Bradley, Leo F. Daniels, and Thomas C. Jones [1969], 782). Përsëri, mësuesit më të mirë të parimit të punës janë vetë prindërit. Për mua, puna u bë një gëzim kur fillova të punoj për herë të parë përkrah tim eti, gjyshit dhe xhaxhallarëve dhe vëllezërve të mi. Jam i sigurtë se isha më tepër një ngatërrës për ta sesa një ndihmë, por kujtimet janë të ëmbla dhe mësimet që mësova të çmura. Fëmijët duhet të mësojnë përgjegjësinë dhe pavarësinë. A po bëjnë kohë prindërit për të treguar, demonstruar dhe shpjeguar në mënyrë që fëmijët, ashtu siç na mësoi Lehi, të mund “të veprojnë për veten e tyre dhe të mos detyrohen të veprojnë”? (2 Nefi 2:26).

Luther Burbak, një nga hurtikulturistët më të mëdhej të botës, tha: “Në qoftë se nuk do të kishim treguar më tepër vëmendje ndaj bimëve tona sesa vëmendja që kemi treguar ndaj fëmijëve tanë, tani do të jetonim në një xhungël barërash të këqija” (në *Elbert Hubbard’s Scrap Book* [1923], 227).

Sfidat e Veçanta të Prindërve

Fëmijët janë gjithashtu përfituesit e zgjedhjes së lirë morale nëpërmjet së cilës u është dhënë mundësia të përparojnë, të rriten e të zhvillohen. Ajo

zgjedhje e lirë i lejon gjithashtu fëmijët të ndjekin zgjedhjen e alternativës së egoizmit, shpërdorimit, kënaqësisë personale dhe vetë-shkatërrimit. Fëmijët shpesh e shprehin këtë zgjedhje të lirë kur janë ende shumë të vegjël.

Prindërit që kanë qenë të kujdesshëm, të dashur dhe të shqetësuar dhe që kanë jetuar parimet e drejtësisë aq mirë sa kanë mundur le të gjejnë ngushëllim duke ditur se ata janë prindër të mirë pavarësisht nga veprimet e disa prej fëmijëve të tyre. Vetë fëmijët kanë përgjegjësi për të dëgjuar, për t’u bindur, për t’u mësuar dhe për të mësuar. Prindërit nuk mund të përgjigjen gjithmonë për sjelljen e keqe të fëmijëve, sepse ata nuk mund të sigurojnë sjelljen e mirë të fëmijëve të tyre. Disa fëmijë do të sfidonin madje edhe urtësinë e Solomonit dhe durimin e Jobit.

Shpesh është një sfidë e veçantë për ata prindër që janë të pasur ose të prirur për t’u plotësuar të gjitha dëshirat fëmijëve. Në një farë mënyre, disa fëmijë në të tilla rrethana i mbajnë peng prindërit e tyre duke mos mbështetur rregullat e prindërve në qoftë se ata nuk do t’i pranojnë kërkesat e fëmijëve. Plaku Nill A. Maksuell ka thënë: “Ata që bëjnë më tepër se ç’duhet për fëmijët e tyre shpejt do të zbulojnë se nuk mund të bëjnë asgjë me fëmijët e tyre. Për disa fëmijë bëhet aq shumë sa që pothuajse shkatërrohen” (in Conference Report, prill 1975, 150; ose *Ensign*, maj 1975, 101). Duket të jetë në natyrën tonë njerëzore të mos i vlerësojmë plotësisht ato gjëra materiale që nuk i kemi fituar vetë.

Ekziston një farë ironie në faktin se disa prindër janë kaq të shqetësuar që fëmijët e tyre të pranohen nga shoqëria dhe të jenë të famshëm mes tyre; megjithatë po këta prindër kanë frikë se mos fëmijët tyre mund të bëjnë disa nga ato gjëra që bëjnë edhe shokët e tyre.

Ndihmojini Fëmijët të Përvetësojnë Vlerat

Përgjithësisht, fëmijë që marrin vendimin dhe kanë vendosmërinë të qëndrojnë larg drogës, alkoolit dhe seksit të paligjshëm janë ata që kanë pranuar dhe përvetësuar vlerat e shëndosha të familjes duke i jetuar ato së bashku me prindërit e tyre. Në kohën e vendimeve të vështira ata ka shumë mundësi të ndjekin mësimet e prindërve të tyre sesa shembullin e shokëve ose sofizmat e medias që reklamojnë përdorimin e alkoolit, seksin e paligjshëm, pabesinë, mungesën e ndershmërisë dhe vese të tjera. Ata janë si dy mijë të rinjtë e Helamanit të cilëve “nënat u kishin mësuar se, në qoftë se nuk do të dyshonin, Perëndia do t’i shpëtonte” nga vdekja (Alma 56:47). “Dhe më përsëritën fjalët e nënave të tyre, duke thënë: Ne nuk dyshojmë që nënat tona e dinin atë” (Alma 56:48).

Ajo që duhet të ndihmojë në forcimin e mësimeve dhe vlerave prindërore në jetën e fëmijëve është një besim i palëkundur në Perëndi. Kur ky besim bëhet pjesë e vetë shpirtit të tyre, ata fitojnë atë forcë të brendshme. Kështu pra, cila është gjëja më e rëndësishme që prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve? Shkrimet e shenjta na tregojnë se prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve "[besim] në Krishtin, Birin e Perëndisë së gjallë, dhe [pagëzimin] e [dhuratën] e Frymës së Shenjtë" dhe "doktrinën e pendimit" (DeB 68:25). Këto të vërteta duhen mësuar në shtëpi. Ato nuk mund të mësohen në shkollat publike, as nuk mund të nxiten nga qeveria ose nga shoqëria. Sigurisht, programet e Kishës ndihmojnë, por mësimdhënia më efektive ndodh në shtëpi.

Një Mijë Fijet e Dashurië

Çastet e mësimdhënies prindërore nuk është e thënë të jenë të mëdha ose dramatike ose të fuqishme. Këtë e mësojmë nga Mësuesi Mjeshtër. Çarls Henri Parkhërst tha:

"Bukuria e plotë e jetës së Krishtit qëndron vetëm në bukurinë e atyre akteve të thjeshta të bukurisë — biseda me gruan te pushi; . . . zbulimi i ambicies së fshehtë të të riut pasanik thellë në zemrën e tij që e mbante larg mbretërisë së Qiellit; . . . mësimi i një grupi të vogël dishepujsh si të luteshin; . . . ndezja e zjarrit dhe pjekja e peshqëve që dishepujt mund të kishin diçka për të ngrënë në mëngjes kur të ktheeshin në breg nga peshkimi, të ngrirë nga të ftohtët, të lodhur dhe të dekurajuar. Të gjitha këto gjëra, siç

e shikoni, na çojnë kaq lehtë drejt cilësisë dhe natyrës së vërtetë të interesave [të Krishtit], kaq specifike, kaq të drejtpërdrejta, kaq të dhëna pas gjërave të vogla, kaq të përfshira pas detajeve të imta" ("Kindness and Love," in *Leaves of Gold* [1938], 177).

Dhe kështu është me të qëniet prindër. Gjërat e vogla janë gjëra të mëdha të endura në pëlhurën e familjes me një mijë fijet e dashurisë, besimit, disiplinës, sakrificës, durimit dhe punës.

Fëmijë të Besëlidhjes

Ka disa premtime të mëdha shpirtërore që mund t'i ndihmojnë prindërit besnikë në këtë kishë. Fëmijët e vulosjeve të përjetshme mund të kenë mbi krye premtimet e bëra paraardhësve të tyre të guximshëm që i mbajtën me fisnikëri besëlidhjet e tyre. Besëlidhjet e kujtuara nga prindërit do të kujtohen nga Perëndia. Kështu fëmijët mund të bëhen përfituesit dhe trashëgimtarët e këtyre besëlidhjeve dhe premtimeve të mëdha. Dhe kjo, sepse ata janë fëmijë të besëlidhjes (shih Orson F. Whitney, në Conference Report, prill 1929, 110-11).

Perëndia i bekoftë prindërit e kësaj bote që mundohen, sakrifikojnë dhe jetojnë me ndershmeri. Uroj që Ai veçanërisht të nderojë besëlidhjet e mbajtura nga ata prindër besnikë midis njerëzve tanë dhe të kujdeset për këta fëmijë të besëlidhjes.

Nga një fjalim i Presidentit Faust në konferencën e përgjithshme të tetorit 1990 (shih Conference Report, tetor 1990, 39-43; ose *Ensign*, nëntor 1990, 32-35).

NJË TRYEZË E RRETHUAR ME DASHURI

Plaku Legrand R. Kurtis
i të Shtatëdhjetëve

Shumë është shkruar rreth rëndësisë së shtëpisë. Plaku Marion G. Romni na ka thënë se "në qendër të sëmundjes fatale të shoqërisë është paqëndrueshmëria e familjes"¹. E dimë se disa shtëpi janë të mëdha, të zgjedhura me kujdes, madje luksoze. Të tjerat mund të jenë të vogla dhe të thjeshta, me orendi të pakta. Megjithatë çdo "shtëpi mund të jetë një copëz qielli mbi tokë kur jemi të mbushur me dashuri, . . . është aty ku duam të jemi," siç na kujton edhe njëri nga himnet tona të dashura².

Një nga orenditë më të rëndësishme që gjendet në pjesën më të madhe të shtëpive është tryeza e kuzhinës. Ajo mund të jetë e vogël, mund të jetë e madhe, ose në formën e një banaku të vogël ku me zor gjen

një vend për të vendosur ushqimin dhe enët. Funkcioni i saj kryesor është të shërbejë si një vend ku anëtarët e ndryshëm të familjes ushqehen.

Në këtë ngjarje të veçantë dëshiroj t'ju drejtoj vëmendjen drejt një funksioni më të thellë e më të rëndësishëm të tryezës së bukës, ku mund të marrim shumë më tepër se ushqimin për mirëqenien tonë fizike.

Diskutimet mbi Ungjillin rreth Tryezës

Një familje zakonisht ka dy ose më tepër anëtarë të moshave të ndryshme, por familja duhet të takohet — mirë do të ishte jo vetëm për të ngrënë, por edhe për t'u lutur, për të biseduar, për të dëgjuar, për të mirëkuptuar, për të mësuar dhe për t'u rritur së bashku. Presidenti Gordon B. Hinkli e ka shprehur këtë kaq mirë:

“Lutja ime — dhe do të doja që të isha më eloku-ent për ta shprehur atë — është një lutje për të shpë-tuar fëmijët. Shumë prej tyre ecin me dhembje e frikë në vetmi dhe dëshpërim. Fëmijët kanë nevojë për dritën e diellit. Ata kanë nevojë për lumturi. Kanë nevojë për dashuri dhe kujdes. Kanë nevojë për mirësi, ripërtëritje dhe ngrohtësi. Çdo shtëpi, pavarësisht nga kostoja e shtëpisë, mund të sigurojë një mjedis dashurie që do të jetë edhe një mjedis shpëtimi”³.

Pjesa më e madhe e anëtarëve të familjes janë subjekt i shumë forcave të botës që gjenden jashtë shtëpisë, si edhe ndikimeve të fuqishme të radios, televizorit, videokasetave dhe shumë gjërave të tjera që sjellim brenda shtëpive tona.

Përfytyroni një familje të mbledhur rreth tryezës, ndoshta rreth tryezës së bukës, duke biseduar rreth ungjillit, mbledhjeve të sakramentit, mesazheve, duke biseduar rreth numrit të fundit të *Liahonës*, rreth shkollës e të gjitha gjërave që kanë të bëjnë me të, duke folur rreth konferencës së përgjithshme, rreth mësimave në Shkollën e së Dielës, duke dëgjuar muzikë të mirë, duke folur rreth Jezu Krishtit dhe mësi-meve të Tij. Lista mund të zgjatet. Jo vetëm prindërit, por të gjithë anëtarët e familjes do të bënin mirë t'i jepnin mundësi të gjithëve për të folur e për të qenë pjesë e bisedës.

Lutja Familjare rreth Tryezës

Mendoni rreth potencialit të një familjeje që gju-njëzohet rreth tryezës (me televizorin të fikur), duke u lutur, duke u përgjyruar për ndihmë, duke e falë-nderuar Atin tonë për bekimet — duke u mësuar të gjitha moshave rëndësinë e një Ati të dashur në Qiell. Lutja familjare me të vegjëlit mund të zhvillo-jë fare mirë të rritur që një ditë do të luten me fami-ljet e tyre.

Plaku Tomas S. Monson e shprehu mirë:

“Zoti na ka udhëzuar që të kemi lutje familjare kur tha: ‘Lutjuni Atit në familjet tuaja, gjithnjë në emrin tim, që bashkëshortet tuaja dhe fëmijët tuaj të jenë të bekuar.’ (3 Nefi 18:21.)

“Do të bashkoheni me mua për të hedhur një vështrim mbi një familje tipike shenjto-re e ditëve të mëvonshme që po i lutet Zotit? Babai, nëna dhe të gjithë fëmijët gju-njëzohen, ulin kokat dhe mbyllin sytë. Një shpirt i ëmbël dashurie, uniteti dhe paqeje mbush shtëpinë. Ndërsa babai dëgjon djalin e tij të vogël t'i lutet Perëndisë që babai i tij të bëjë atë që është e drejtë dhe të jetë i bindur ndaj urdhërimeve të Zotit, a mendoni se një baba i tillë do ta kishte të vështirë të nderonte lutjen e birit të tij të shtrenjtë? Ndërsa një vajzë adoleshente e dëgjon nënën e saj të

dashur t'i lutet Zotit që e bija të frymëzohet në zgje-dhjen e shokëve të saj, që ajo të përgatitet për mar-tesën në tempull, a nuk besoni se kjo vajzë do të përpiket ta nderojë këtë lutje të përu-lur e përgjyruar të nënës së saj që e do kaq shumë? Kur babai, nëna dhe secili nga fëmijët, luten me gjithë zemër që djemtë e mrekullueshëm të familjes do të jetojnë të denjë që kur të vijë koha të marrin një thirrje për të shërbyer si ambasadorë të Zotit në misionet e Kishës, a nuk fillojmë të shikojmë se si këta djem bëhen bu-rra me një dëshirë të jashtëzakonshme për të shërby-er si misionarë?”⁴

Siç kanë thënë shumë të tjerë: “Si është e mundur që t'i dërgosh prindërit dhe fëmijët në botë çdo ditë pa i mbledhur më parë së bashku për të folur me Zotin?” Prindërit e urtë do të analizojnë oraret e pla-net e tyre të paktën një herë në çdo ditë për ta mble-dhur familjen për bekimin e lutjes. Shumë shpejt, fëmijët do të mësojnë të luten me rradhë dhe të më-sojnë vlerat e çmuara që gjenden në lutjen familjare.

Bëjeni Shtëpinë një Vend të Lumtur

Siç thashë edhe më parë “shtëpia duhet të jetë një vend i lumtur, sepse të gjithë përpiqen për këtë. Thuhet se lumturia krijohet në shtëpi dhe ne duhet të përpiqemi t'i bëjmë shtëpitë tona vende të lumtu-rra e të këndëshme për ne dhe fëmijët tanë. Një shtë-pi e lumtur është një shtëpi që bazohet mbi mësimet e ungjillit. Një gjë e tillë kërkon përpjekje të vazh-dueshme e të kujdesshme nga të gjithë në familje”⁵.

Një adoleshent i ngarkuar me shumë detyra në një familje të madhe u ankua se lutja familjare kërkonte shumë kohë. Të nesërmen ndërsa nëna e mençur po lutej, ajo me qëllim nuk e përfshiu të riun në lutje. Kur lutja përfundoi, fëmija tha: “Mami, ti nuk më përfshive në lutje!” Nëna e dashur i shpjegoi se ajo thjesht po i përgjigjej ankesës së tij. Fëmija u ankua: “Mos më përjashto.”

Studimi i Shkrimeve të Shenjta rreth Tryezës

Përfytyroni një familje rreth tryezës me shkrimet e shenjta të hapura, duke diskutuar rreth të vërtetave e mësimave të shumta që duhen përvetësuar. Kjo është me të vërtetë një tryezë e rrethuar me dashuri!

Mësuesit e pranojnë se fëmijët duhet të lexojnë shumë më tepër jashtë shkolle. Ne mund t'i bekojmë fëmijët tanë duke lexuar shkrimet e shenjta me ta çdo ditë — në tryezën e bukës.

Të gjes kohë kur familja mblidhet rreth tryezës së bukës mund të kërkojnë ndryshime të konsiderue-shme dhe planifikim të kujdesshëm, por çfarë mund të jetë më e rëndësishme për unitetin e familjes, për rritjen shpirtërore të familjes, për ato ura që krijohen

midis anëtarëve të familjes ndërsa ata flasin, dëgjojnë, përgjigjen, të rrethuar me dashuri? Suksesi ynë më i madh është thjesht të përqipemi vazhdimisht.

Forconi Lidhjet Familjare

Ka shumë forca në botë sot që kërkojnë ta shkatërojnë familjen dhe shtëpinë. Prindërit e mençur do të përqipen të forcojnë lidhjet familjare, të rrisin shpirtshmërinë në shtëpi dhe të përqëndrohen te Jezu Krishtit dhe aktiviteti në tempull. Presidenti Hauard W. Hanter na ka thënë:

“Unë lutem që të mund ta trajtojmë njëri-tjetrin me më tepër mirësi, më tepër mirësjellje, me më tepër përlulësi, durim e falje . . .

Së dyti, dhe po në të njëjtin shpirt, ftoj gjithashtu anëtarët e Kishës ta vendosin tempullin e Zotit si simbolin e madh të anëtarësisë së tyre dhe vendin hyjnor për besëlidhjet e tyre më të shenjta. Do të ishte dëshira më e thellë e zemrës sime që çdo anëtar i Kishës të ishte i denjë për të hyrë në tempull”⁶.

Udhëzimi i dhënë nga Presidenti Hanter mund të përmirësohet dukshëm nga ajo që ndodh rreth tryezës së bukës.

Në shtëpitë tona ne duhet të praktikojmë si t’i trajtojmë të tjerët. Ashtu siç e tha aq mirë Gëtja: “Nëse e trajtoni [një individ] ashtu si është, ai do të mbetet ashtu si është, por nëse e trajtoni atë sikur ai tashmë të ishte . . . ashtu siç mund të bëhet, ai do [të bëhet i tillë]”⁷.

Bëjini Shtëpitë Vende Përkushtimi

Plaku Boid K. Paker tha: “Për të sjellë disa nga gjërat e qiellit në shtëpi duhet të bëjmë të mundur që anëtarët e familjes të përparojnë në pjesëmarrjen në kishë. Mbrëmja familjare sigurisht është e përkryer për këtë qëllim — një mbledhje në shtëpi që mund të organizohet për t’iu përshtatur çdo nevojë; dhe është shumë e ngjashme me një mbledhje kishë, ose mund të jetë e tillë, si mbledhjet e zhvilluara në ndërtesën e kishës”⁸.

Kjo këshillë gjithashtu mbështet atë çka na thotë Plaku Din L. Larsen: “Ndërtesat tona të kishës nuk janë të vetmet vende ku mund të adhurojmë. Shtëpitë tona duhet të jenë gjithashtu vende përkushtimi. Do të ishte mirë nëse çdo ditë mund të shkonim ‘për të pasur kishë në shtëpi.’ Nuk duhet të ketë asnjë vend tjetër ku Shpirti i Zotit të jetë më i mirëpritur dhe më i arritshëm sesa në vetë shtëpinë tonë”⁹.

Ndërsa punojmë për t’i përmbushur të gjitha këto në shtëpitë tona, do të bënim mirë të kujtonim thënien e rëndësishme të Presidentit Harold B. Li: “Mbani mend se puna më e rëndësishme e Zotit që ju [dhe unë] do të bëjmë ndonjëherë do të jetë . . . brenda mureve të shtëpive [tona]”¹⁰.

Lutja ime sot është që secili nga ne të shikojë me kujdes shtëpitë tona dhe tryezën e bukës dhe të përqipemi vazhdimisht të sjellim qiellin në shtëpitë tona dhe të vijmë te Jezu Krishti.

Nga një fjalim i Plakut Kurtis në konferencën e përgjithshme të prillit 1995 (shih Conference Report, prill 1995, 109-11; or *Ensign*, maj 1995, 82-83).

SHËNIME

1. “Scriptures As They Relate to Family Stability,” *Ensign*, shkurt 1972, 57.
2. “Home Can Be a Heaven on Earth,” *Hymns*, no. 298.
3. In Conference Report, Oct. 1994, 74-75; or *Ensign*, nëntor 1994, 54.
4. *Pathways to Perfection* (1973), 26-27.
5. In Conference Report, Oct. 1990, 13; or *Ensign*, nëntor 1990, 12.
6. In “President Howard W. Hunter: Fourteenth President of the Church,” *Ensign*, korrik 1994, 4-5.
7. In Emerson Roy West, *Vital Quotations* (1968), 171.
8. “Begin Where You Are — At Home,” *Ensign*, shkurt 1972, 71.
9. In Conference Report, Oct. 1989, 78; or *Ensign*, nëntor 1989, 63.
10. *Strengthening the Home* (pamphlet, 1973), 7.

T'U MËSOJMË FËMIJËVE PARIMET E UNGJILLIT

13

PJESA 1

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Lexoni Doktrina e Besëlidhje 68:25-28. Ndërsa lexoni, gjeni parimet dhe ordinancat që Zoti i ka urdhëruar prindërve t'u mësojnë fëmijëve të tyre. Planifikoni të bëni diçka për t'ua mësuar këto parime e ordinanca fëmijëve tuaj ose nipërve e mbesave, apo fëmijëve të tjerë që njihni.
- Ndërsa lexoni artikullin e mëposhtëm, zgjidhni të përqendrohemi në njërin prej dy sugjerimeve të dhëna nga Plaku Robert D. Hejells. Sipas mundësive të ndryshme që mund të lindin, përqendrohuni mbi sugjerime të tjera nga ky artikull.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojeni artikullin me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

FORCIMI I FAMILJES: DETYRA JONË E SHENJTË

Plaku Robert D. Hejells
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shpirti i Forcon Familjet

Forcimi i familjeve është detyra jonë e shenjtë si prindër, fëmijë, anëtarë të rrethit familjar, udhëheqës, mësues dhe anëtarë të Kishës.

Rëndësia e forcimit shpirtëror të familjes mësohet që në fillim të shkrimeve të shenjta. Ati Adami dhe Nëna Evë u mësuan bijëve e bijave të tyre ugjillin. Sakrifika e Abelit u pranua nga Zoti, të cilin ai e donte. Nga ana tjetër Kaini, "e donte Satanin më shumë se Perëndinë" dhe kreu mëkate serioze. Adami dhe Eva "vajtuan përpara Zotit, për shkak të Kainit dhe vëllezërve të tij," por ata kurrë nuk rreshtën së mësuar ungjillin fëmijëve të tyre (shih Moisiu 5:12, 18, 20, 27; 6:1, 58).

Ne duhet ta kuptojmë se secili nga fëmijët tanë vjen në botë me dhurata e talente të ndryshme. Disave, si Abeli, me sa duket u jepet dhurata e besimi qysh në lindje. Të tjerët e kanë të vështirë me çdo vendim që duhet të marrin. Si prindër, ne nuk duhet të lejojmë kurrë që kërkimi dhe përpjekjet për të gjetur të vërtetën nga ana e fëmijëve tanë të na lëkundin ose të na bëjnë të humbasin besimin tonë te Zoti.

Alma i Ri, kur ishte "i torturuar me mundim . . . [dhe] [i] ngacmuar nga kujtimi i mëkateve të [tij] të shumta," u kujtua se e kishte dëgjuar të atin të mësonte rreth ardhjes së "një Jezu Krishti, një Biri të

Perëndisë, për të shlyer mëkatet e botës" (Alma 36:17). Fjalët e të atit çuan në kthimin e tij në besim. Po në të njëjtën mënyrë, mësimet dhe dëshmia jonë do të kujtohen nga fëmijët tanë.

Dy mijë luftëtarët e rinj në ushtrinë e Helamanit dëshmuuan se nënat e tyre të drejta ua kishin mësuar me forcë parimet e ungjillit (shih Alma 56:47-48).

Në kohën e një kërkimi të madh shpirtëror, Enosi tha "fjalët që kisha dëgjuar shpesh atin tim të fliste në lidhje me jetën e përjetshme . . . më hynë thellë në zemrën time" (Enosi 1:3).

Në Doktrina e Besëlidhje Zoti thotë se prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve të tyre "të kuptojnë doktrinën e pendimit, të besimit në Krishtin, Birin e Perëndisë së gjallë, dhe të pagëzimit e të dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, kur janë tetë vjeç . . .

Dhe ata gjithashtu duhet t'i mësojnë fëmijët e tyre të lutën dhe të ecin drejt përpara Zotit" (DeB 68:25, 28).

Mësimi i Ungjillit Forcon Familjet

Ndërsa u mësojnë ungjillin fëmijëve nëpërmjet fjalës dhe shembullit, familjet tona fuqizohen dhe përforcohen.

Fjalët e profetëve të gjallë janë të qarta në lidhje me detyrën tonë të shenjtë për t'i forcuar shpirtërisht familjet tona. Në vitin 1995 Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve lëshuan një proklamata për botën duke shpallur se "familja është

thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përrjetshëm të fëmijëve të Tij . . . Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre . . . Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore, për t'i mësuar ata ta duan dhe t'i shërbejnë njëri-tjetrit, për të zbatuar urdhërimet e Perëndisë” (“Familja: Një Proklamim drejtuar Botës, *Ensign*, nëntor, 1995, 102 [shih 35602]).

Në shkurt të këtij viti, Presidencia e Parë u drejtoi një thirrje të gjithë prindërve “për t’ia dedikuar përpjekjet e tyre më të mira mësimi dhe rritjes së fëmijëve të tyre me parimet e ungjillit që do t’i mbajnë ata pranë Kishës. Shtëpia është baza e një jete të drejtë dhe asnjë mjet tjetër nuk mund të zerë vendin e saj ose të plotësojë funksionet thelbësore të saj në çuarjen përpara të kësaj përgjegjësie të dhënë nga Perëndia.

Në letrën e shkurtit, Presidencia e Parë na mëson se duke i mësuar dhe rritur fëmijët me parimet e ungjillit, prindërit mund t’i mbrojnë familjet e tyre nga elementët shkatërrues. Më tej ata i këshillojnë prindërit dhe fëmijët “t’i japin përparësinë më të lartë lutjes familjare, mbrëmjes familjare, studimit dhe udhëzimit të ungjillit dhe aktiviteteve të shëndetshme familjare. Sado të denja dhe të përshtatshme qofshin kërkesat ose aktivitetet e tjera, ato nuk duhet të lejohen të zëvendësojnë detyrat e caktuara hyjnore që vetëm prindërit dhe familjet mund t’i kryejnë ashtu si duhet” (Letër e Presidencisë së Parë, 11 shkurt 1999; cituar në *Church News*, 27 shkurt 1999, 3).

Me ndihmën e Zotit dhe të doktrinës së Tij, të gjitha efektet e dëmshme të sfidave që një familje mund të hasë mund të kuptohen dhe të kapërcehen. Cilatdo qofshin nevojat e anëtarëve të familjes, ne mund t’i forcojmë familjet tona ndërsa ndjekim këshillën e dhënë nga profetët.

Çelësi për të forcuar familjet qëndron në praninë e Shpirtit të Zotit në shtëpitë tona. Qëllimi i familjeve tona është të jenë në shtegun e ngushtë e të ngushtuar.

Ide për të Forcuar Familjet

Një mori gjërash të panumërta mund të bëhen brenda mureve të shtëpive tona për të forcuar familjen. Më lejoni të ndaj disa ide që mund të ndihmojnë për të identifikuar ato pika që kanë nevojë të forcohen në familjet tona. Këto ide i ofroj nën shpirtin e inkurajimit, duke e ditur se çdo familje — dhe çdo anëtar i familjes — është unik.

Shtëpitë Duhet të Jenë një Vend i Sigurtë

- Bëjini shtëpitë tuaja një vend të sigurtë ku çdo anëtar i familjes të ndjejë dashuri dhe një ndjenjë përkatësie. Kuptoni se çdo fëmijë ka dhurata dhe aftësi të ndryshme; secili është një individ që kërkon dashuri dhe kujdes të veçantë.
- Mbani mend, “përgjigjja e ëmbël e fashit zemërimin” (Fjalët e Urta 15:1). Kur gruaja ime e dashur dhe unë u vulosëm në Tempullin e Sollt Leik, Plaku Harold B. Li na dha një këshillë të urtë: “Kur ngrini zërin e zemërimit, Shpirti largohet nga shtëpia juaj.” Ne nuk duhet kurrë, që në zemërim e sipër, t’ua mbyllim derën e shtëpisë dhe të zemrës sonë fëmijëve tanë. Si djali plangprishës, fëmijët tanë duhet ta dinë se kur vijnë në vete mund të kthehen tek ne për dashuri dhe këshillë.
- Kaloni kohë individualisht me fëmijët tuaj, duke i lënë ata të zgjedhin aktivitetin dhe temën e bisedës suaj. Largoni çdo gjë që mund t’iu tërheqë vëmendjen.

U Mësoni Fëmijëve të Lutën, të Lexojnë Shkrimet e Shenjta dhe të Dëgjojnë Muzikë të Pastër

- Nxisni sjelljen fetare personale të fëmijëve tanë, të tilla si lutja personale, studimi personal i shkrimeve të shenjta dhe agjërimi për nevojat të veçanta. Matni rritjen e tyre shpirtërore duke vëzhguar, mënyrën e të sjellurit, fjalorin dhe sjelljen me të tjerët.
- Lutuni çdo ditë me fëmijët.
- Lexoni shkrimet e shenjta së bashku. Më kujtohet se prindërit e mi na lexonin shkrimet e shenjta, ndërsa ne fëmijët uleshim në dysheme dhe dëgjonim. Ndonjëherë ata na pyesnin: “Ç’kuptim ka ky shkrim për ju?” ose “Si ju bën të ndiheni ky shkrim?” Më pas na dëgjonin, ndërsa përgjigjeshim me fjalët tona.
- Lexoni fjalët e profetëve të gjallë dhe artikuj të tjerë frymëzues për fëmijët, rininë dhe të rriturit në revistat e Kishës.
- Ne mund t’i mbushim shtëpitë tona me muzikë të pastër, ndërsa këndojmë së bashku nga libri i himneve dhe *Children’s Songbook* (Libri i Këngëve të Fëmijëve).

Zhvilloni Mbrëmje Familjare dhe Mbani Këshilla Familjare

- Zhvilloni mbrëmje familjare çdo javë. Si prindër, ndonjëherë ne ndihemi paksa të zënë ngushtë t’i mësojmë dhe t’u dëshmojmë fëmijëve tanë. Kam qenë fajtor për këtë në jetën time. Fëmijët kanë nevojë që ne të ndajmë ndjenja shpirtërore me ta, t’i mësojmë e t’u dëshmojmë.

- Mbani këshilla familjare për të diskutuar planet dhe shqetësimet e familjes. Disa nga këshillat më efikase familjare janë ato individuale me secilin anëtar të familjes. Ndhimjoni fëmijët tanë të kuptojnë se idetë e tyre janë të rëndësishme. Dëgjojini dhe mësoni prej tyre.

Ndani Ungjillin, Mbështesni Udhëheqësit e Kishës dhe Merrni Pjesë si një Familje

- Ftojini misionarët të mësojnë miqtë tuaj më pak aktivë ose joanëtar në shtëpitë tuaja.
- Tregoni se ju i mbështesni dhe i përkrahni udhëheqësit e Kishës.
- Hani së bashku kur është e mundur dhe bisedoni me njëri-tjetrin gjatë kësaj kohe.
- Punoni së bashku si një familje, madje edhe nëse puna mund të mbarohet më shpejt dhe më lehtë nëse e bëni vetëm. Bisedoni me bijtë dhe bijat tuaja gjatë kohës që po punoni. Unë e kisha këtë mundësi çdo të shtunë me babain tim.

U Mësoni Fëmijëve të Jenë Miq të Mirë dhe të Përgatiten për të Ardhmen

- Ndhimjoni fëmijët tanë të mësojnë si të krijojnë miqësi të mira dhe t'i bëjnë miqtë të ndihen të mirëpritur në shtëpinë e tyre. Njihuni me prindërit e miqve të fëmijëve tuaj.
- U mësoni fëmijëve nëpërmjet shembullit si të administrojnë kohën dhe burimet. I ndihmoni ata të mësojnë mbështetjen e vetja dhe rëndësinë e përgatitjes për të ardhmen.

Ndani Trashëgiminë dhe Traditat Familjare

- U mësoni fëmijëve historinë e paraardhësve tanë dhe historinë e familjes tuaj.
- Krijoni tradita familjare. Planifikoni dhe kaloni pushime mbresëlënëse së bashku, duke marrë parasysh nevojat, talentet dhe aftësitë e fëmijëve tanë. I ndihmoni ata të krijojnë kujtime të lumtura, të përmirësojnë talentet e tyre dhe të ndërtojnë ndjesinë e vlerës personale.

U Mësoni Fëmijëve Rëndësinë e Bindjes ndaj Urdhërimeve dhe Marrjes së Ordinancave

- Nëpërmjet fjalës dhe shembullit, mësoni vlera morale dhe zotimin për t'iu bindur urdhërimeve.
- Pasi u pagëzova dhe u konfirmova, mamaja më tërhoqi mënjandë dhe më pyeti: "Çfarë ndjen?" Unë ia përshkrova me aq sa munda ndjenjën e ngrohtë të paqes, ngushëllimit dhe lumturisë që ndjeja. Mamaja më shpjegoi se ajo që po ndjeja ishte dhurata që sapo kisha marrë, dhurata e Frymës së Shenjtë. Ajo më tha se nëse do të jetoja i denjë për të, do ta kisha atë dhuratë me vete

vazhdimisht. Ky ishte një çast mësimi që më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës.

U mësoni fëmijëve tanë rëndësinë e pagëzimit dhe konfirmimit, rëndësinë e marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë, marrjes së sakramentit, nderimit të priftërisë dhe bërjes e mbajtjes së besëlidhjeve të tempullit. Ata duhet ta dinë rëndësinë e të jetuarit denjësisht për një rekomandim tempulli dhe për t'iu përgatitur për martesën në tempull.

- Nëse nuk jeni vulosur ende në tempull me bashkëshortin/bashkëshorten ose me fëmijët tuaj, punoni si familje për të marrë bekimet e tempullit. Vendosni familjarisht qëllime që kanë të bëjnë me tempullin.
- Vëllezër, jini të denjë për priftërinë që mbani dhe përdoreni atë për të bekuar jetën e familjes tuaj . . .

Jini në Dijeni të Veprimtarive në Komunitet, Shkollë e Kishë

Ekzistojnë burime që janë në dispozicionin tonë edhe jashtë shtëpisë. Përdorimi i mençur i tyre do t'i forcojë familjet tona.

- Nxitini fëmijët të shërbejnë në Kishë dhe komunitet.
- Flisni me mësuesit, këshilltarët, këshilluesit e fëmijëve dhe me udhëheqësit e Kishës rreth shqetësimeve dhe nevojave të fëmijëve.
- Jini në dijeni të asaj se me çfarë merren fëmijët tanë gjatë kohës së lirë. Ndikoni në zgjedhjen e filmave, programeve televizive dhe videove që ata shohin. Nëse janë në Internet, jini në dijeni se çfarë po bëjnë. I ndihmoni të kuptojnë rëndësinë e argëtimit të shëndetshëm.
- Nxisni veprimtari të vlefshme shkollore. Njihuni me atë çka po studiojnë fëmijët tanë. Ndhimjoni me detyrat e shtëpisë. Ndhimjoni të kuptojnë rëndësinë e shkollimit dhe përgatitjes për punësim dhe pavarësi personale.
- Të reja: Merrni pjesë në Shoqatën e Ndhimës kur të mbushni 18 vjeç. Disa nga ju mund të ngurrojnë për ta bërë këtë kalim. Mund të keni frikë se ndoshta nuk do të përshtateni. Motrat e mia të reja, nuk ndodh kështu. Shoqata e Ndhimës ka shumë për t'ju ofruar. Ajo mund të jetë një bekim gjatë gjithë jetës suaj.
- Të rinj: Nderojeni Priftërinë Aarone. Ajo është priftëria përgatitore, që ju përgatit për Priftërinë Melkizedeke. Jini plotësisht aktivë në kuorumin e pleqve kur të shuguroheni në Priftërinë Melkizedeke. Vëllazëria, udhëzimet që merrni në kuorum dhe mundësitë për t'iu shërbyer të tjerëve do t'iu bekojnë ju dhe familjet tuaja gjatë gjithë jetës.

Zoti na Dha Shembullin e Dashurisë — Ndiqeni Atë

Çdo familje mund të forcohet në një mënyrë ose në një tjetër nëse Shpirti i Zotit silltet në shtëpitë tona dhe ne mësojmë nëpërmjet shembullit të Tij.

- Veproni me besim; mos reagoni me frikë. Kur adoleshentët tanë fillojnë t'i vënë në provë vlerat e familjes, prindërit duhet t'i drejtohen Zotit për udhëheqje mbi nevojat specifike të secilit anëtar të familjes. Kjo është koha për të dhënë më tepër dashuri e përkrahje dhe për të përforcuar mësimet tuaja rreth mënyrës si të bëjmë zgjedhje. Është frikësuese t'i lejojmë fëmijët tanë të mësojnë nga gabimet e tyre, por gatishmëria e tyre për të zgjedhur udhën e Zotit dhe vlerat familjare është më e madhe kur zgjedhja vjen nga brenda se sa kur ne përpiqemi t'ua imponojmë me forcë këto vlera. Mënyra e Zotit për të dashur dhe pranuar është më e mirë nga mënyra imponuese dhe shtrënguese e Satanit, veçanërisht në rritjen e adoleshentëve.
- Mbani mend fjalët e Profetit Jozef Smith: “Asgjë nuk ka më tepër për qëllim t'i çojë njërëzitet në brakisjen e mëkatit sesa t'i marrësh ata për dore dhe të kujdesesh për ta me ngrohtësi. Kur njërëzitet tregojnë edhe mirësinë e dashurinë më të vogël ndaj meje, O ç'fuqi ka ajo në mendjen time, ndërsa e kundërta ka prirjen të nxisë të gjitha ndjenjat e vrazhda dhe të brengosë mendjen e njeriut” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, sel. Joseph Fielding Smith [1976], 240).

Fëmijët Plangprishës do të Kthehen

- Ndërsa mund të dëshpërohemi kur, pas gjithçkaje që kemi bërë, disa nga fëmijët tanë largohen nga shtegu i drejtësisë, fjalët e Orson F. Uitnit mund të na ngushëllojnë: “Megjithëse disa nga delet mund të enden, syri i Bariut qëndron mbi to dhe herët a vonë ato do të ndiejnë tentakulat e Providencës Hyjnore t'u afrohen dhe t'i tërheqin sërish në tufë. Qoftë në këtë jetë apo në jetën që do të vijë ata do të rikthehen. Atyre do t'u duhet të paguajnë borxhin e tyre ndaj drejtësisë; ata do të vuajnë për mëkatet e tyre; dhe mund të ecin përgjatë një shtegu me gjemba; por në qoftë se ky shteg më në fund do t'i çojë, ashtu si birin e penduar Plangprishës, drejt zemrës së dashur dhe gati për të falur të një [nënë], të një babai dhe të një shtëpie, përvoja e dhimbshme nuk do të ketë qenë e kotë. Lutuni për fëmijët [tanë] të pakujdesshëm dhe të pabindur; qëndroju prapë me besimin tuaj. Vazhdoni të shpresoni, të besoni deri sa të shikoni shpëtimin e Perëndisë” (duke cituar Joseph Smith, në Conference Report, prill 1929, 110).

Të Pamartuarit dhe Rrethi i Gjerë Familjar Mund të Japin Forcë

- Po nëse jeni të pamartuar ose nuk jeni bekuar me fëmijë? A duhet të interesoheni rreth këshillës për familjet? Po. Kjo është diçka që të gjithë duhet të mësojnë në jetën tokësore. Anëtarët e rritur të pamartuar shpesh mund t'i japin një lloj të veçantë force familjes, duke u bërë një burim i jashtëzakonshëm mbështetjeje, pranimi e dashurie për familjet e tyre dhe familjet e të tjerëve përrreth.
- Shumë anëtarë të rrethit të gjerë familjar kryejnë shumë detyra prindërore që u takojnë me të drejtë. Gjyshërit, hallat e tezë, xhaxhallarët e dajallarët, vëllezërit e motrat, nipërit e mbesat, kushurinjtë dhe anëtarë të tjerë të familjes mund të kenë një ndikim të madh mbi familjen. Dua të shpreh vlerësimin tim për ata të rrethit tim të gjerë familjar që më kanë udhëhequr me anë të shembullit dhe dëshmisë së tyre. Ndonjëherë anëtarët e rrethit të gjerë familjar mund të thonë disa gjëra që prindërit nuk mund t'i thonë pa filluar një grindje. Pas një bisede të gjatë e të ngrohtë me nënën e saj, një e re tha: “Do të ishte e tmerrshme të të thosha ty dhe babet se kisha bërë diçka të gabuar. Por do të ishte edhe më keq t'i thoja teze Suzanës. Nuk mund ta prijia në besë.”

Nuk Ka Familje të Përkryera

Duke e ditur se jemi këtu në vdekshmëri për të mësuar dhe zhvilluar besimin tonë, duhet të kuptojmë se duhet të ketë kundërshti në të gjitha gjërat. Gjatë një këshilli familjar në shtëpinë time, ime shoqe tha: “Kur mendon se dikush ka një familje të përkryer, do të thotë se nuk i njeh akoma mirë ata.”

Vendosni në Rregull Shtëpinë dhe Familjen

Vëllezër e motra, si prindër le t'ia vëmë veshin këshillës, madje qortimit, që Zoti i dha Jozef Smithit dhe udhëheqësve të Kishës në vitin 1833 “ti duhet të vendosësh në rregull shtëpinë tënde” (DeB 93:43). “Por unë ju kam urdhëruar t'i rrisni fëmijët tuaj në dritë e të vërtetë” (DeB 93:40). “[Vendosni] në rregull familjen [tonë] dhe [kujdesuni] që ata të jenë më të zellshëm dhe më të përfshirë në shtëpi dhe të lutën gjithmonë, ose ata do të largohen nga vendi i tyre” (DeB 93:50).

Profetët e kohës sonë u kanë dhënë prindërve një këshillë dhe paralajmërim për të vendosur në rregull shtëpitë e tyre. Qofshim të bekuar me frymëzim dhe dashuri për ta përballuar kundërshtimin me besim brenda familjeve tona. Atëherë do ta dimë se sprovat tona kanë për qëllim të na afrojnë më pranë Zotit dhe njëri-tjetrit. Uroj që të dëgjojmë zërin e profetit dhe t'i vëmë në rregull shtëpitë tona (shih 93:41-49). Familja forcohet kur ne afrohem më pranë Zotit dhe

secili anëtar i famijes forcohet ndërsa ngremë shpirtërisht, forcojmë, duam dhe kujdesemi për njëri-tjetrin. “Ti më ngri mua dhe unë do të të ngre ty, dhe së bashku do të ngjitemi lart” (proverb i besimit kuaker).

Uroj që ne të mund ta mirëpresim dhe ta ruajmë Shpirtin e Zotit në shtëpitë tona për të forcuar familjet

tona. Lutem që çdo anëtar i familjes të mund të qëndrojë në “[shtegun e ngushtë] dhe të ngushtuar që të çon në jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:18).

Nga një fjalim i Plakut Hejëlls në konferencën e përgjithshme të prillit 1999 (shih Conference Report, prill 1999, 39-44; or *Ensign*, maj 1999, 32-34).

T'U MËSOJMË FËMIJËVE PARIMET E UNGJILLIT

14

PJESA 2

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Si familje, planifikoni një aktivitet për të shërbyer së bashku.
- Bëni një punë shtëpie me një nga fëmijët ose nipërit e mbesat tuaja, ose një fëmijë tjetër në familjen tuaj. Flisni me fëmijën ndërsa punoni. Përfitoni nga mundësitë për ta mësuar fëmijën pa qenë kritikues ndaj përpjekjeve të fëmijës për të ndihmuar.
- Lexoni pjesët e mëposhtme në pamfletin *Për Forcën e Rinisë* (34285): “Media: Filmat, Televizori, Radio, Videokasetat, Librat dhe Revistat” (17-19), “Muzika dhe Vallëzimi” (20-21) dhe “Pastërtia Seksuale” (26-28).

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojeni artikullin me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

MËSOJNI FËMIJËT

Presidenti Boid K. Paker
President Veprues i Kuorumit
të Dymbëdhjetë Apostujve

Një numër i madh njerëzish që janë mbledhur këtu sonte dhe që po na ndjekin në vende të tjera pohojnë etjen e pashueshme për të vërtetën që e shoqëron anëtarësinë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Ndërsa u luta për të ditur se çfarë do t'ju vlente më shumë, u kujtova se pas tre javësh do të mbush 75-vjeç dhe do të kaloj në atë që unë kam zgjedhur ta quaj moshë mesatare e vonshme.

Kam punuar si mësues për 50 vjet. Sigurisht diçka nga ajo që kam mësuar do t'iu vlejë edhe juve.

Këtë e kam mësuar nga përvoja. Jeta do të na mësojë disa gjëra që nuk kemi menduar se do të donim t'i mësonim. Këto mësimet të vështira mund të jenë më të vlefshmet.

Mësova edhe diçka tjetër rreth të mësuar gjatë udhës drejt *moshës mesatare të vonshme*. Mendoni rreth kësaj bisede midis një mjeku dhe një pacienti.

Mjeku: “Si mund t’ju ndihmoj? Cili është problemi juaj?”

Pacienti: “Kujtesa, doktor. Lexoj diçka dhe më pas nuk mund ta kujtoj. S’mbaj mend pse hyra në një dhomë. Nuk mbaj mend se ku i vë gjërat.

Mjeku: “Më thoni, sa kohë ka që ju shqetëson kjo gjendje?”

Pacienti: “Sa kohë ka që më shqetëson cila gjendje?”

Tani, nëse kjo ju argëtoi, ose jeni nën të 60-tave ose po qeshni me veten.

Mësojini Fëmijët Kur Janë të Rinj

Kur plakeni, nuk mund të mësoni, nuk mund të mbani mend ose të studioni sikur të ishit i ri. Mund të jetë kjo arsyeja pse profeti Alma këshilloi: “Mëso urtësi në rininë tënde; po, mëso në rininë tënde të zbatosh urdhërimet e Perëndisë?”¹

Po bëhet shumë e vështirë për mua të mësoj përmendësh shkrime të shenjta dhe vargje poezie. Kur isha i ri i përsërisja gjërat një ose dy herë dhe i mbaja mend. Nëse e përsërisja disa herë dhe veçanërisht nëse e shkruaja, do të mbetej përgjithmonë e regjistruar në mendje.

Rinia është një kohë për të mësuar me lehtësi. Për këtë arsye mësuesit të fëmijëve dhe të rinisë kanë qenë një shqetësim i madh për udhëheqësit e Kishës që nga fillimi.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme t’ua mësosh ungjillin dhe mësimet e jetës fëmijëve dhe rinisë.

Zoti e vendos përgjegjësinë numër një mbi prindërit dhe i paralajmëron ata:

“Dhe përsëri, për aq sa prindërit kanë fëmijë në Sion, . . . të cilët nuk i mësojnë të kuptojnë doktrinën e pendimit, të besimit në Krishtin, Birin e Perëndisë së gjallë, dhe të pagëzimit e të dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, kur janë tetë vjeç, mëkati qoftë mbi kokat e prindërve”².

Është qëllimi kryesor i kësaj Kishe të mësojë rininë: së pari në shtëpi e më pas në kishë.

Ruani Dijen

Një gjë tjetër që kam mësuar ka të bëjë me të kujtuarit e asaj që kemi mësuar kur ishim të rinj. Njohuria e ruajtjes në mendjet e reja mund të presë aty për shumë vjet për çastin kur mund të nevojitet.

Më lejoni ta ilustruj. Jam shumë i shqetësuar rreth prirjes të anëtarëve për të mos ia vënë veshin këshillës së peshkopit, ose ekstremin tjetër, të qenit tepër të varur prej tij.

Vendosa të flas në konferencën e përgjithshme rreth peshkopit.

U përgatita me lutje dhe ndër mend më erdhi një bisedë nga 50 vite të shkuara. Kjo i shërbeu nevojës sime si mësues — i shërbeu më së miri. Po e citoj tani atë bisedë po ashtu siç bëra në konferencën e përgjithshme:

“Disa vite më parë shërbeva në këshillin e lartë të kunjit me Emeri Rait. Për 10 vjet Emeri kishte shërbyer si peshkopi i Lagjes Harper, një lagje në një zonë rurale. Bashkëshortja e tij, Lusill, u bë presidentja e Shoqatës së Ndihmës.

Lusill më tregoi se një mëngjes pranvere një nga fqinjët trokiti në derë dhe kërkoi Emerin. Ajo i tha se ai po plugonte. Atëherë fqinji foli tepër i shqetësuar. Herët atë mëngjes, duke kaluar pranë arës ai kishte vënë re se kuajt e Emerit po qëndronin në një brazdë gjysmë të përfunduar me frena të hedhura mbi parmendë. Emeri nuk dukej gjëkund. Fqinjit i doli krejt nga mendja deri shumë kohë më vonë kur kaloi përsëri pranë arës dhe kuajt nuk kishin lëvizur. Ai kapërceu gardhin dhe eci përmes arës në drejtim të kuajve. Emeri nuk gjendej askund. Ai shpejtoi drejt shtëpisë për të pyetur Lusillën.

Lusilla iu përgjigj me qetësi: ‘Oh, mos u bëni merak. Pa dyshim dikush ka një hall dhe ka ardhur të thërrasë peshkopin.’

Imazhi i kuajve duke qëndruar me orë të tëra në arë simbolizon përkushtimin e peshkopëve në Kishë dhe të këshilltarëve që qëndrojnë pranë tyre. Çdo peshkop dhe çdo këshilltar, në mënyrë figurative, i lë

kuajt e tij në një brazdë të papërfunduar kur dikush ka nevojë për ndihmë”³.

Nuk e kisha përdorur kurrë më parë atë përvojë në një bisedë — nuk më kishte shkuar kurrë në mendje.

Doja ta ngulisa mirë në mendje para se të flisja për të në konferencë, kështu që kontaktova me një nga vajzat e Emeri Rait. Ajo pranoi të më takonte në shtëpinë e tyre të vjetër dhe të më tregonte arën ku kishte qenë duke pluguar i ati atë ditë.

Një nga djemtë e mi më çoi atje një të dielë në mëngjes. Ai bëri shumë fotografi.

Ishte një mëngjes i bukur pranvere. Ara sapo ishte pluguar, ashtu siç kishte qenë shumë vite më parë. Pulëbardhat po ushqeheshin me dheun e freskët.

Ajo nxitje e kujtesës, të kujtuarit e asaj bisede, nuk është e pazakontë për mua. Kjo ripohon të vërtetën e shkrimit të shenjtë — një shkrim që rastësisht e mësova përmendësh në rininë time —

“As mos u shqetësoni që më parë se çfarë do të thoni; por mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës dhe do t’iu jepet në çastin e duhur ajo pjesë që do t’i shpërndalet çdo njeriu”⁴.

Ka një premtim për ata që mbledhin vazhdimisht si thesar dijen:

“Dhe kushdo që ju pranon ju, atje do të jem unë gjithashtu, sepse unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t’iu ngritur lart”⁵

Ky ishte një mësim i mirë për mua, por nuk mbaron me kaq.

Kur isha i ri kisha bërë disa piktura dhe gdhendje në dru. Në pjesën më të madhe të kohës mësoja vetë. Kur fëmijët po rriteshin, ia përkushtova kohën time për t’u mësuar ato gjëra që kisha mësuar për jetën, gdhendjen në dru dhe pikturën kur isha ende i ri.

Pasi ata u rritën, fillova të merresha sërish me gdhendje në dru si një mënyrë shlodhjeje. Gdhendja zogj dhe kaloja shumë kohë duke gdhendur. Kur më pyesin: “Sa kohë t’u desh për ta gdhendur këtë?” Gjithmonë i përgjigjesha: “Nuk e di. Po ta zbuloja, do të hiqja dorë.”

Gjatë atyre orëve duke punuar me duart e mia, menditoja rreth mrekullive të krijimit dhe frymëzimi rridhte si lumë. Ndërsa gdhendja drurin, gdhendja edhe biseda.

Gdhendja më shlodhte. Ndonjëherë kur isha paksa i stresuar dhe jo në humor të mirë, ime shoqe më thoshte: “Do të bëje mirë të filloje një tjetër punim në dru.”

Mendoj se nëse kujtesa e *moshës mesatare të vonshme* do të kthjellohej paksa, mund të tregojë më gisht njërën gdhendje dhe të thojë se cilën bisedë përfaqëson. Në ato çaste të heshtura mësova se mund të bëja dy gjëra në të njëjtën kohë.

Korrja nga Mësimdhënia

Nuk jam më në gjendje të bëj ato gdhendje. Ajo punë është tepër delikate për mua për shkak të syzeve tri-vatore dhe kyçeve që tani janë paksa të ngurtësuar nga poliomieliti i fëmijërisë. Përveç kësaj tensioni i madh i thirrjes sime ma kufizon kohën që mund t'ia dedikoj gdhendjeve në dru dhe përgatitjes së bisedave.

Aftësia për të punuar në dru tani pothuajse më ka humbur, por nuk është kështu për fëmijët tanë. Ne i mësuam që kur ishin të rinj.

Imazhi i atyre kuajve në mes të arës më mbeti në mendje. Mendova se ndoshta mund të bëja një pikturë të kuajve të peshkopit duke qëndruar në mes të arës me frena lëshuar mbi plug.

Ngurrova në fillim pasi kishin kaluar nëntë vjet që nuk kisha pikturuar. Dy miq me talent dhe frymëzim të pazakontë ofruan të më ndihmonin të pikturoja kuajt e peshkopit dhe korriku nuk ishte i ngarkuar me udhëtime, kështu që fillova nga puna.

Mësova shumë nga ata dy miq dhe në një mënyrë të vërtetë ata janë në pikturën time. Por djemtë e mi më ndihmuan më tepër. Një nga djemtë fotografoi arën e pluguar, sepse unë gjithmonë mundohem të jem tepër i saktë ku paraqes diçka në *dru* ose në *pëlhurë* ose me *fjalë*.

Ky ishte një mësim tjetër. Unë munda të risillja te fëmijët tanë diçka që ata e kishin mësuar që kur ishin të rinj.

Djali tjetër vendosi të bënte një skulpturë të kuajve të peshkopit në bronz për të shoqëruar pikturën time. Kaluam shumë orë të gëzueshme duke ndihmuar njëri-tjetrin.

Ai mori nga hangari ynë disa samarë të vjetër që kishin qëndruar ashtu të varur e të paprekur për mbi 50 vjet. I fshiu pluhurin dhe i mori me vete në shtëpi. E hodhi njërin nga samarët mbi një kalë shumë të duruar. Kali qëndroi në qetësi ndërsa ai i rregulloi samarin dhe bëri disa skica të hollësishme të tij.

Fqinji i tij kishte mbledhur disa parmenda të vjetra. Midis tyre ishte një parmendë e asaj periudhe, të cilën ai e skicoi gjithashtu.

Dhe kështu te djemtë tanë u rikthye ajo që u kishim mësuar në rininë e tyre. Ashtu si me fëmijët e tjerë, ata janë përmirësuar në atë që ne si prindër u mësuam që kur ishin shumë të vegjël. Dhë nëse ditët

tona zgjaten mbi tokë, do të vijë një korrje e dytë — nipërit e mbesat tona — dhe ndoshta një e tretë.

Rizgimi i Talenteve të Fjetura

Rimësova edhe diçka tjetër. Dikur kohë më parë kisha pikturuar një pikturë i frymëzuar nga komentet që kisha dëgjuar kur isha i ri. Piktura paraqiste Majat Uillard. Kisha dëgjuar të vjetrit t'iu referoheshin këtyre majave si *Presidencia*. Këto tri maja gjigande dhe solide që ngrihen drejt qiellit përfaqësojnë udhëheqësit e Kishës.

Kjo ndodhi nëntë vjet më parë. Im bir më çoi në Uillard, Juta dhe fotografuam majat. Shkuam përsëri një herë të dytë kur do të kishte më tepër dritë-hije dhe kontrast.

Pas atyre viteve m'u desh të rizgjoja atë që e kisha lënë të binte në harresë. Në fillim ishte një mundim i tmerrshëm. Kërcënova të hiqja dorë disa herë. Njëri nga miqtë e mi më nxiti duke më thënë: "Jepi! Fundi nuk vjen kollaj."

Nuk hoqa dorë, thjesht sepse ime shoqe nuk ma dha lejen. Tani jam i gëzuar për këtë. Ndoshta, tani dëshiroj t'i kthehem përsëri pikturës — kush e di — mbase një ditë do të bëjë një pikturë tjetër.

Mendoj se përpjekja për t'iu rikthyer pikturës nuk është shumë ndryshe nga dikush që ka qenë joaktiv në Kishë për shumë vite dhe vendos të kthehet në vathë. Është ajo periudhë përpjekjeje për të fituar ndjesinë e asaj që kishte rënë në gjumë, por që në të vërtetë nuk kishte humbur. Dhe të ndihmon së tepërmi të kesh një ose dy miq.

Ky është një parim tjetër i të mësuarit — të nxjerrësh mësim nga përvojat e zakonshme të jetës.

Piktura e *Kujave të Peshkopit* do të përfundohet së shpejti. Skulptura e tim biri ndodhet në fonderi për t'u hedhur në bronz.

Meqë ra fjala, skulptura e tij është shumë më e mirë se piktura ime. Dhe kështu duhet të jetë. Gishtërinjtë dhe mendja e tij e re reagojnë më me shkathtësi nga të miat.

Ndërsa shkojmë drejt *moshës mesatare të vonshme* mësojmë se kockat e vjetra nuk përkulen lehtë, kyçet e vjetër nuk lëvizim më aq shpejt. Nuk është më aq e lehtë të lidhësh këpucët pasi kalon mesin e të 60-tave — më pas ato varen për tokë.

Ja ku del përsëri ai mësim: "Mëso urtësi në rininë tënde; po, mëso në rininë tënde të zbatosh urdhërimet e Perëndisë"⁶.

"Lavdia e Perëndisë është inteligjencë ose, me fjalë të tjera, dritë dhe e vërtetë"⁷.

“Por unë ju kam urdhëruar t’i rrisni fëmijët tuaj në dritë e të vërtetë”⁸.

Dhurata hyjnore e Frymës së Shenjtë u jepet fëmijëve tanë ku janë vetëm tetë vjeç.

“Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë”⁹.

Vini re fjalët *mësojë* dhe *kujtojë*.

Mësimi i fëmijëve sjell shpërblimet e veta. A nuk e keni mësuar ende se kur mësoni fëmijët ju vetë mësoni më tepër nga ajo që ata mësojnë.

Mbështetja mbi Kujtimet Shpirtërore

Ka një ndryshim midis të fituarit të njohurisë tokësore dhe të fituarit e njohurisë shpirtërore. Studentët e mësojnë këtë ditën e provimit. Është tmerrsisht e vështirë të kujtosh diçka që në radhë të parë nuk e ke mësuar.

Kjo është e vërtetë për njohurinë tokësore, por shpirtërisht ne mund të mbështetemi mbi një kujtesë që shkon përtej lindjes. Ne mund të zhvillojmë një ndjesi ndaj atyre gjërave që nuk i kuptonim kur ishim më të rinj.

Poeti Uordsuorth ndjeu diçka rreth jetës para lindjes kur shkroi:

*Lindja jonë s’është veçse një gjumë dhe një harresë:
Shpirti që ngrihet me ne, Ylli i jetës sonë,
Diku tjetër ka lindur,
Dhe nga larg ka zbritur:
Jo krejt në harresë,
Dhe jo në lakuriqësi të plotë,
Si re të varura lavdie vijmë
Nga Perëndia, që është shtëpia jonë*¹⁰.

Këto vargje i nxorra nga kujtesa, ku i kisha ruajtur gjatë një ore të anglishtes kur isha në fakultet.

Mësimet më të rëndësishme vijnë nga ngjarjet e zakonshme të jetës.

Disa presin për përvoja bindëse shpirtërore për të konfirmuar dëshminë e tyre. Nuk ndodh kështu. Janë nxitjet dhe mbresat e heshtura të gjërave të zakonshme që na japin sigurinë e identitetit tonë si fëmijë të Perëndisë. Ne nuk jetojmë të denjë për privilegjet tona kur kërkojmë shenja dhe shikojmë “përtej shenjës”¹¹ për mrekullitë.

Ne jemi fëmijë të Perëndisë, sepse jetuam me Të në ekzistencën para lindjes. Herë pas here ajo perde hapet. Atëherë e kuptojmë se kush jemi dhe cili është vendi ynë në skemën e përjetshme të gjërave. Quajeni atë kujtesë ose ndriçim shpirtëror, por ajo është një nga ato dëshmi se ungjilli i Jezu Krishtit

është i vërtetë. Të tilla zbulesa vijnë kur mësojmë të tjerët.

Dikur e dëgjova Presidentin Marion G. Romni (1897-1988) të thoshte: “E ndjej gjithmonë se kur po flas nën ndikimin e Frymës së Shenjtë, sepse gjithmonë mësoj diçka nga ajo që kam thënë.”

Zoti u tha pleqve:

“Përsëri unë them, vini vesh ju pleq të kishës sime, që unë ju kam caktuar: Ju nuk jeni dërguar që të mësoheni, por t’u mësoni fëmijëve të njerëzve gjërat që i kam vënë në duart tuaja me anë të fuqisë së Shpirtit tim;

Dhe ju duhet të mësoheni nga lart. Shenjtëroni vetveten dhe do t’iu dhurohet fuqi, që të mund të jepni madje siç kam thënë unë”¹².

Edhe kur e korrura e të kthyerve në besim është e pakët për misionarët, atyre dhe Kishës u vjen një fuqi shpirtërore, sepse ata mësojnë nga mësimet e tyre.

Detyra e presidentit të kuorumit të dhjakëve është të ulet në këshill me ta¹³. Detyra e presidentit të kuorumit të pleqve është t’i mësojë ata në përputhje me besëlidhjet¹⁴.

Pali i tha Timoteut: “Ato që dëgjove nga unë përpara shumë dëshmitarëve, jepua njerëzve besnikë, që do të jenë të aftë të mësojnë edhe të tjerë”¹⁵.

Ai e shpjegon se si mësimi kthehet në shpërblimin e tij:

“Ti, pra, që mëson të tjerët, nuk mëson veten? Ti që predikon se nuk duhet vjedhur, vjedh?”

*Ti që thua se nuk duhet shkelur kurora, shkel kurorën?”*¹⁶

Ji një Nxënës i Zellshëm

Para disa ditësh mora një letër ndjese, siç ndodh shumë herë. Vinte nga dikush që nuk e njihja. Kjo letër tregonte se sa i zemëruar dhe i inatosur kish qenë me mua ai anëtar për një kohë të gjatë për shkak të një bisede që kisha dhënë. Ishte një kërkesë për falje.

Unë jam i shpejtë për të falur. Unë jam thjesht një mjet në dhënien e bisedës dhe të faljes.

Shkrimet e shenjta përmbajnë referenca të shumta që tregojnë sa “e rëndë”¹⁷ ishte për izraelitët dhe Nefitët të duronin mësimet e profetëve dhe apostujve. Është e lehtë t’i rezistosh mësimet dhe të urresh mësuesin. Ky ka qenë fati i profetëve dhe apostujve që nga fillimi.

Njëra nga Lumturitë na mëson:

“Lum ju kur do t’iu shajnë dhe do t’iu përndjekin dhe, duke gënjer, do të thonë të gjitha të zezat kundër jush, për shkakun tim.

Gëzohuni dhe ngazëllohuni, sepse shpërblimi juaj është i madh në qiej, sepse kështu i kanë përndjekur profetët që qenë para jush¹⁸.

Në këto letra ndjese është karakteristikë të shkruhet: “Nuk mund ta kuptoja pse e ndjetë nevojë të më binit të ndihesha aq në pozitë të vështirë dhe aq fajtor.” Më pas, në mes të mundimit të tyre, vjen një ndiçim, një frymëzim, një të kuptuar i shkaqeve dhe efekteve. Më në fund ata arrijnë të shikojnë dhe të kuptojnë pse ungjilli është ashtu siç është.

Po përmend një temë midis shumë të tjerave. Një motër më në fund mund të arrijë të kuptojë se pse në theksojmë se është e rëndësishme që nënat të rrinë në shtëpi me fëmijët e tyre. Ajo e kupton se asnjë shërbim tjetër nuk krahasohet me përsosjen që vjen nga amësia vetëmohuese. Ajo as nuk ka përse të heqë dorë nga përsosja intelektuale, kulturore ose shoqërore. Këto gjëra asimilohen — në kohën e duhur — sepse ato shoqërojnë virtytin e përjetshëm që vjen nga të mësuarit e fëmijëve.

Asnjë mësim nuk krahasohet, asnjë mësim nuk është më shpërblyes ose më ekzaltues sesa ai i një nëne që mëson fëmijët e saj. Një nënë mund të ndihet e pazonja në diturinë e shkrimeve të shenjta, sepse është e zënë duke mësuar familjen e saj. Ajo nuk do të marrë një shpërblim më të vogël.

Presidenti Grant Bangerter po zhvillonte një bisedë doktrinale me Presidentin Jozef Fillding Smith, i cili po vizitonte misionin e tij në Brazil. Motra Bangerter po dëgjonte dhe më në fund tha: “Presidenti Smith, unë kam rritur fëmijët dhe nuk kam pasur kohë të bëhem studiuese e shkrimeve të shenjta si ai. A do mund të shkoj në mbretërinë çelsetiale me Grantin?”

Presidenti Smith u mendua thellë për një çast dhe më pas tha: “Ndoshta po, nëse i bën një ëmbëlsirë.”

Një burrë duhet të mundohet shumë për ta arritur atë masë përsosmërie shpirtërore që i ndodh në mënyrë të natyrshme gruas së tij ndërsa ajo mëson fëmijët e tyre. Dhe nëse ai e kupton ungjillin, ai e di se nuk mund të ekzaltohet pa të¹⁹. Shpresa e tij më e madhe është të udhëheqë si një partner i kujdeshëm, i përgjegjshëm në mësimin e fëmijëve të tyre.

Bekimet e Mësuesve

Tani, mendoni për këtë premtim:

“I mësoni me zell dhe hiri im do të jetë me *ju* [mësues], që ju [mësues, nëna, baballarë] të udhëzoheni në mënyrë më të përsosur në teori, në parim, në doktrinë, në ligjin e ungjillit, në të gjitha gjërat që lidhet me mbretërinë e Perëndisë, të cilat janë të dobishme për ju [nëna, dhe baballarë] për t’i kuptuar²⁰.”

Vini re premtimi është për mësuesin dhe jo për nxënësin.

“Mësoni me zell dhe hiri im do të jetë me ju [që mësoni fëmijët tuaj, ose që mësoni në Filllore, Shkollën e së Dieles, te të Rejat, të Rinjtë, në priftëri, seminar, Shoqatën e Ndihmës],” që ju mund të arrini të dini:

Për gjërat si në qiell, edhe në tokë dhe nën tokë; gjërat që kanë qenë, gjërat që janë, gjërat që duhet të ndodhin së shpejti, gjërat që janë në vendin tuaj, gjërat që janë jashtë; luftërat dhe ngatërresat e kombeve dhe gjykimet që janë mbi tokën; dhe një dije gjithashtu për vendet dhe për mbretëritë —

Me qëllim që ju të mund të përgatiteni në gjithçka, kur unë t’ju dërgoj përsëri për të lartësuar thirrjen në të cilën ju kam thirrur dhe misionin me të cilin ju kam ngarkuar²¹.

Pali i profetizoi Timoteut të ri “në ditët e fundit do të vijë kohë të vështira²². Ai tha: “Njerëzit e keqij dhe mashtrues do të shkojnë keq e më keq, duke gënjer dhe duke u gënjer vetë²³.”

Por ne ende mund të jemi të sigurtë. Siguria jonë qëndron në mësimin e fëmijëve tanë.

“Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët²⁴.”

Pali e këshilloi Timoteun:

“Por ti qëndro në ato që mësove dhe u binde plotësisht, duke e ditur prej kujt i mësove,

Dhe se që nga *fëmijëria* i *njeh Shkrimet e shenjta*, të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezus²⁵.”

Kjo është Kisha e Jezu Krishtit. Kjo është Kisha e Tij. Ai është Shembulli ynë, Shëlbuesi ynë. Ne jemi urdhëruar të jemi “ashtu sikur është i drejtë ai²⁶.”

Ai ishte mësuesi i fëmijëve. Ai i urdhëroi disheputj e Tij në Jeruzalem “I lini fëmijët e vegjël të vijë tek unë, sepse atyre u përket mbretëria e qiejve²⁷.”

Në tregimin e shërbesës së Shpëtimtarit midis Nefitëve, mund të shikojmë më thellë në shpirtin e Tij ndoshta më shumë se në ndonjë vend tjetër:

“Dhe ndodhi që ai urdhëroi që të silleshin fëmijët e tyre të vegjël.

Kështu ata i sollën fëmijët e tyre të vegjël dhe i ulën përdhe rreth e përçark tij dhe Jezusi qëndroi në mes; dhe turma u hapi rrugë, derisa të gjithë u sollën pranë tij . . .

. . . Ai qau dhe turma e dëshmoi këtë gjë dhe ai i mori fëmijët e tyre të vegjël, një nga një, dhe i bekoj dhe iu lut Atit për ta.

Dhe pasi e bëri këtë gjë ai qau përsëri;

Dhe ai i foli turmës dhe u tha atyre: Vini re të vegjëlit tuaj.

Dhe si u kthyen të shikonin, ata hodhën sytë drejt qiellit dhe panë qiejt të hapen; dhe panë engjëj që po zbritnin nga qielli sikur të ishin në mes të një zjarri; dhe ata zbritën dhe rrethuan të vegjëlit e tyre, dhe ata qenë të rrethuar nga zjarri; dhe engjëjt u shërbyen atyre.

Dhe turma pa dhe dëgjoi, dhe dëshmoi; dhe ata e dinë se dëshmia e tyre është e vërtetë, pasi të gjithë ata panë dhe dëgjuan²⁸.

Unë dëshmoj se kjo dëshmi është e vërtetë. Unë dëshmoj për Të dhe ju bekoj të gjithëve ju që mësoni fëmijët në emrin e Tij.

Nga një fjalim i dhënë në një nga takimet shpirtërore gjatë Javës Arsimore në Universitetin Brigham Jang, 17 gusht 1999 (shih *Ensign*, shkurt 2000, 10-17).

SHËNIME

1. Alma 37:35.
2. Doktrina e Besëlidhje 68:25.
3. "The Bishop and His Counselors," *Ensign*, maj 1999, 57.
4. Doktrina e Besëlidhje 84:85.
5. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
6. Alma 37:35.
7. Doktrina e Besëlidhje 93:36.
8. Doktrina e Besëlidhje 93:40.
9. Gjoni 14:26; gërmat kursive janë shtuar.
10. "Ode: Intimations of Immortality," strofa 5.
11. Jakobi 4:14.
12. Doktrina e Besëlidhje 43:15-16.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:85.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:89.
15. 2 Timoteu 2:2.
16. Romakëve 2:21-22; gërmat kursive janë shtuar.
17. Shih Gjoni 660; 1 Nefi 16:22 Nefi 9:40; Helamani 14:10.
18. Mateu 5:11-12; shih gjithashtu Lluca 21:12; Gjoni 15:20; 3 Nefi 12:12.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 131:1-4, 132:19-21.
20. Doktrina e Besëlidhje 88:78; gërmat kursive janë shtuar.
21. Doktrina e Besëlidhje 88:79-80.
22. 2 Timoteu 3:1.
23. 2 Timoteu 3:13.
24. Fjalët e Urta 22:6.
25. 2 Timoteu 3:14-15; gërma kursive janë shtuar.
26. 1 Gjoni 3:7.
27. Mateu 19:14.
28. 3 Nefi 17:11-12, 21-25.

T'I UDHËHEQIM FËMIJËT NË MARRJEN E VENDIMEVE

15

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave tuaja, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Në detyrën e mëposhtme për lexim, Plaku M. Rasëll Ballard jep katër sugjerime “për të ndërtuar një fortesë besimi në shtëpitë tonë dhe . . . për të ndihmuar në përgatitjen e rinisë sonë për të qenë e pastër, e dëlirë dhe e kulluar, plotësisht të denjë për të hyrë në tempull.” Rishikoni sugjerimet e tij dhe bëni plane specifike për të ndjekur këto sugjerime në shtëpinë tuaj.
- Mendoni për vendimet që çdo fëmijë në familjen tuaj mund të ndeshë në shkollë, shtëpi dhe në vende të tjera. Mendoni se çfarë mund të bëni për ta ndihmuar secilin fëmijë të përgatitet për të marrë vendime të drejta.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikullin e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojeni artikullin me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

SI NJË FLAKË E PASHUESHME

Plaku M. Rasëll Ballard
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Gëzimi i Martesës në Tempull

Herë pas here kam privilegjin të kryej shërbesa në tempull kur dy të rinj të denjë martohen dhe vulosen në shtëpinë e Zotit. Këto janë kohë të veçanta për familjen dhe miqtë. Në të tilla raste ajo që ndihet është një përzierje e ëmbël dhe e gëzueshme e lumturisë tokësore dhe gëzimit të përjetshëm që duket në sytë e përplotur të nënave që janë lutur për këtë ditë më gjithë zemër. Atë e dallon në sytë e baballarëve të cilët, për herë të parë pas disa muajsh me rradhë, mendojnë për diçka tjetër përveç se si të paguajnë për të gjitha shpenzimet. Por këtë ndjenjë kryesisht e dalloni në sytë e nuses dhe dhëndrit të virtytshëm që kanë jetuar të vërtetë ndaj mësimave të ungjillit duke shmangur tundimet e botës. Ekziston një ndjenjë e veçantë dhe e pamohueshme tek ata që kanë qëndruar të pastër, të kulluar e të dëlirë.

Standardet e Moralit Janë Absolute

Shumë nga të rinjtë e të rejtat tona po i dorëzohen presioneve që shkaktohen nga një botë e bombarduar me mesazhe të liga dhe sjellje të pamoralshme. Luciferi i ka shpallur një luftë të ashpër shpirttrave të të rinjve dhe të vjetërve dhe numri i viktimave po

rritet. Standardet e botës kanë ndryshuar si rëra e një shkretëtire të rrahur nga era. Ajo që dikur ishte e padëgjuar ose e papranuar tani është bërë e zakonshme. Këndvështrimi i botës ka ndryshuar në mënyrë aq dramatike sa që ata që zgjedhin të ndjekin standardet tradicionale të moralit shikohen si të çuditshëm, pothuajse sikur t’iu duhet ta justifikojnë dëshirën e tyre për të mbajtur urdhërimet e Perëndisë.

Por një gjë është e sigurtë: urdhërimet nuk kanë ndryshuar. Le të mos gabohemi për këtë. E drejta mbetet ende e drejtë. E gabura ende mbetet e gabuar, pavarësisht sa me zgjuars maskohet me mirësjelljen ose korrektësinë politike. Ne besojmë në dlijësinë para martesës dhe besnikërinë pas saj. Ky standard është një standard absolut i së vërtetës. Ajo nuk është subjekti i sondazheve të opinionit publik as nuk varet nga situata ose rrethanat. Nuk është e nevojshme të debatohet rreth saj ose rreth standardeve të tjera të ungjillit.

Ndërtimi i Fortesave të Besimit në Shtëpi

Por ka një nevojë të dëshpërueshme për prindër, udhëheqës e mësues për ta ndihmuar rininë të mësojë të kuptojë, të dojë, të vlerësojë dhe të jetojë standardet e ungjillit. Prindërit dhe rinia duhet të qëndrojnë së bashku në mbrojtje ndaj një kundërshtari të zgjuar e dinak. Ne duhet të jemi po aq të përkushtuar, efektivë dhe të vendosur në përpjekjet tona për të jetuar ungjillin sa ç’është edhe ai në përpjekjet e tij për të shkatërruar atë mbrojtje — dhe ne.

Sfida që qëndron para nesh është e madhe. Shpirtat e pavdekshëm të atyre që i duam janë në rrezik. Më lejoni të sugjeroj katër mënyra për të ndërtuar një fortesë besimi në shtëpitë tona dhe veçanërisht për të ndihmuar në përgatitjen e rinisë sonë për të qenë e pastër, e dëlirë dhe e kulluar, plotësisht e denjë për të hyrë në tempull.

Mësojuni Fëmijëve Ungjillin

Së pari është informacioni mbi ungjillin. Informacioni më i rëndësishëm që të ndryshon jetën me sa di unë është dija se ne jemi me të vërtetë fëmijë të Perëndisë Atit tonë të Përrjetshëm. Kjo nuk është e saktë vetëm nga ana doktrimore, por është shpirtërisht jetësore. Shpëtimtari tha në lutjen e Tij të fuqishme ndërmjetësuese: “Dhe kjo është jeta e përrjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”(Gjoni 17:3). Të njohësh Atin Qiellor dhe të kuptosh marrëdhënien tonë me Të si Atin tonë dhe Perëndinë tonë do të thotë të gësh kuptim në këtë jetë dhe shpresë në jetën që do të vijë. Familjet tona duhet ta dinë se Ai është i vërtetë, se ne jemi në fakt bijtë e bijat e Tij dhe trashigimtarë të gjithçkaje që Ai ka tani e përgjithmonë. Duke qenë kështu të sigurtë në një njohuri të tillë, anëtarët e familjes nuk ka shumë të ngjarë që të kërkojnë për argëtime djallëzore dhe ka më tepër të ngjarë që ata të shikojnë te Perëndia dhe të jetojnë (shih Numrat 21:8).

Jetoni sipas Besëlidhjes, Jo sipas Volisë

Në një farë mënyre ne duhet të rrënjosim në zemrat tona dëshminë e fuqishme për ungjillin e Jezu Krishtit ashtu si paraardhësit tanë pionierë. Kujtoni kur Nauvu u shkatërrua në shtator të 1846-tës dhe kushtet e padurueshme të shenjtorëve në kampet e varfëra. Kur fjala arriti në Lagjet Dimërore, Brigam Jang i thirri menjëherë vëllezërit. Pasi u shpjegoi situatën dhe i kujtoi për besëlidhjen e bërë në Tempullin e Nauvusë që askush që dëshironte të vinte, pavarësisht sa i varfër ishte, nuk do të lihej mbrapa, u dha atyre këtë sfidë të mrekullueshme:

“Tani është koha për punë,” tha ai. “Zjarri i besëlidhjes që bëtë në Shtëpinë e Zotit, le të digjet në zemrat tuaja, si një flakë e pashueshme” (To the High Council at Council Point, 27 shtator 1846, Brigham Young Papers, Historical Department Archives, The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 1; gjerat kursive janë shtuar). Brenda pak ditësh, me gjithë kushtet pothuajse të një varfërie të madhe në Lagjet Dimërore, vagona të shumtë u nisën drejt lindjes për të shpëtuar shenjtorët në kampet e varfra përgjatë lumit Misisipi.

Dëgjojmë shpesh për vuajtje dhe sakrificën e atyre shenjtorëve të parë që duruan aq shumë dhe pyesim

veten: “Si ja dolën mbanë? Çfarë i dha kaq shumë forcë?” Një pjesë e përgjigjes gjendet në fjalët e fuqishme të presidentit Jang. Ata shenjtorë të parë kishin bërë besëlidhje me Perëndinë dhe ato besëlidhje digjeshin si një zjarr i pashueshëm në zemrat e tyre.

Ndonjëherë ne tundohe mi ta lemë jetën tonë të drejtohet më tepër nga volia sesa nga besëlidhja. Nuk është gjithmonë e vulltshme të jetosh standardet e ungjillit dhe të qëndrosh për të vërtetën dhe të dëshmosh për Rivendosjen. Zakonisht nuk është e vulltshme të ndash ungjillin me të tjerët. Jo gjithmonë është e vulltshme t’i përgjigjes një thirrjeje në Kishë, veçanërisht një thirrjeje që i sfidon aftësitë tona. Mundësitë për t’u shërbyer të tjerëve në mënyra të rëndësishme, ashtu si kemi besëlidhur të bëjmë, rrallë vinë në kohë të vulltshme. Por nuk ka fuqi shpirtërore në të jetuarit e vulltshëm. Fuqia vjen kur mbajmë besëlidhjet tona. Ndërsa shikojmë jetën e këtyre shenjtorëve të parë, vërejmë se besëlidhjet e tyre ishin forca kryesore e jetës së tyre. Shembulli dhe dëshmia e tyre ishin aq të fuqishme sa të ndikonin tek fëmijët e tyre brez pas brezi.

Mësojuni Fëmijëve Moralin

Ndërsa fëmijët tanë rriten, ata kanë nevojë për informacionin e mësuar nga prindërit në mënyrë më të drejtëpërdrejtë dhe të qartë rreth asaj që është dhe nuk është e duhur. Prindërit duhet t’u mësojnë fëmijëve të shmangin çdo fotografi ose histori pornografike. Fëmijët dhe rinia duhet të mësojnë nga prindërit se pornografia e çdo lloji është mjeti i djallit dhe nëse dikush luan me të, ai ka fuqinë ta skllavërojë, ta topisë dhe madje ta shkatërrojë shpirtin njerëzor. Ata duhen mësuar të mos përdorin fjalor vulgar dhe kurrë të mos e përdorin kot emrin e Zotit. Shakatë e ndyra që dëgjohen rastësisht nuk duhet të përsëriten kurrë. U mësoni anëtarëve të familjes të mos dëgjojnë muzikë që ka në qendër atë që është sensuale. U flisni qartë rreth seksit dhe mësimet e ungjillit në lidhje me dëlirësinë. Ky informacion le të vijë nga prindërit brenda shtëpisë në një mënyrë të përshtatshme. Të gjithë anëtarët e familjes duhet t’i dinë rregullat dhe të përforcohen shpirtërisht në mënyrë që t’i mbajnë ato. Dhe kur bëhen gabime, Shlyerja e mrekullueshme e Zotit Jezu Krisht duhet kuptuar dhe pranuar në mënyrë që me anë të procesit të plotë dhe ndonjëherë të vështirë të pendimit, mund të merret falja dhe shpresa e vazhdueshme për të ardhmen. Nuk duhet kurrë të heqim dorë nga kërkimi individual dhe familjar për jetën e përrjetshme.

Fatkeqësisht, shumë prindër në botën e sotme kanë hequr dorë nga përgjegjësia për t’ia mësuar fëmijëve të tyre këto vlera dhe doktrina të tjera të Kishës, duke besuar se të tjerët do ta bëjnë këtë: bashkëmoshatarët, shkolla, udhëheqësit dhe mësuesit e Kishës,

ose madje edhe media. Çdo ditë fëmijët tanë mësojnë, duke i mbushur mendjet dhe zemrat me përvoja dhe perceptime që ndikojnë thellë sistemet e vlerave personale.

Forconi Njëri-Tjetrin kundër Ligësisë

Vëllezër e motra, ne duhet ta udhëzojmë njëri-tjetrin dhe të rrënjosim një besim më të thellë në zemrat tona për të forcuar veten me kurajo për të mbajtur urdhërimet në një botë ku ligësia vjen duke u rritur. Ne duhet të transformohemi tërësisht në ungjillin e Krishtit që ai zjarr i besëlidhjes të digjet në zemrat tona si një flakë e pashueshme. Dhe me atë besim do të bëjmë ç'të jetë e nevojshme për të qëndruar të vërtetë dhe të denjë.

Komunikoni Hapur me Fëmijët

Së dyti është komunikimi. Asgjë nuk është më e rëndësishme në marrëdhënien midis anëtarëve të familjes sesa komunikimi i hapur dhe i sqartë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për prindërit që përpiqen t'u mësojnë parimet dhe standardet e ungjillit fëmijëve të tyre. Aftësia për të këshilluar rininë tonë — dhe ndoshta më e rëndësishmja, që të dëgjojmë shqetësimet e tyre — është themeli mbi të cilin ndërtohen marrëdhënie të suksesshme. Shpesh ajo që shikojmë në sy dhe ajo që ndiejmë në zemër do të komunikojë shumë më tepër nga çka dëgjojmë ose themi. Një fjalë për fëmijët tuaj: Mos u tregoni asnjëherë të pasjellshëm ndaj prindërve tuaj. Edhe ju duhet të mësoni të dëgjoni, veçanërisht këshillën e mamit dhe babit dhe të nxitjeve të Shpirtit. Ne duhet të jemi të vëmendshëm për të dalluar dhe për të përfituar nga çastet e volitshme për të mësuar që ndodhin brenda marrëdhënieve tona familjare dhe duhet të vendosim tani që të zhvillojmë mbrëmje familjare çdo të hënë pasdite.

Ndodhin çaste të fuqishme komunikimi gjatë lutjeve të zakonshme familjare dhe gjatë studimit familjar të shkrimeve të shenjta. Shkrimet e shenjta do të ndihmojnë në përcaktimin e vlerave dhe qëllimeve të familjes dhe diskutimi rreth tyre do t'i ndihmojë anëtarët e familjes të mësojnë të bëhen individualisht të sigurtë, shpirtërisht të fortë dhe të pavarur. Kjo kërkon kohë, prandaj duhet të këshillohemi së bashku për të vendosur sa televizor, sa filma, sa video, lojra me video, sa kohë në Internet dhe në aktivitetet jashtë shtëpisë duhet lejuar.

Prindërit dhe Udhëheqësit Duhet të Ndërhyjnë

E treta është ndërhyrja. Është detyra e prindërve të ndërhyjnë kur vënë re zgjedhje të gabuara. Kjo nuk do të thotë që prindërit u mohojnë fëmijëve dhuratën e çmuar të zgjedhjes së lirë. Duke qenë se zgjedhja e lirë është një dhuratë e dhënë nga Perëndia,

përfundimisht zgjedhja se çfarë do të bëjnë, si do të sillen dhe çfarë do të besojnë do të jetë gjithmonë zgjedhja e tyre. Por si prindër ne duhet të sigurohemi se ata e kuptojnë sjelljen e duhur dhe pasojat nëse ndjekin udhën e gabuar. Mbani mend se nuk ekziston një gjë e tillë si censura e paligjshme në shtëpi. Filmat, revistat, televizori, videot, Interneti dhe media të tjera janë aty si miq dhe duhet të mirëprehen kur janë të përshtatshëm për kënaqësinë e familjes. Bëjeni shtëpinë tuaj një qiell paqeje dhe drejtësie. Mos i lejoni ndikimet e liga të infektojnë mjedisin tuaj të veçantë shpirtëror. Jini të dashur, të kujdeshëm, të sjellshëm dhe mirëkuptues në ato që thoni dhe më mënyrën si e trajtoni njëri-tjetrin. Më pas qëllimet familjare të bazuara mbi standardet e ungjillit e bëjnë më të lehtë marrjen e vendimeve të mira.

I njëjti parim zbatohet për ju peshkopë, mësues dhe udhëheqës të tjerë në Kishë ndërsa punoni për të ndihmuar familjet. Ju nuk duhet të qëndroni duarkryq kur ata për të cilët jeni përgjegjës bëjnë zgjedhje të dobta morale. Kur një nga të rinjtë tanë qëndron në një udhëkryq moral në jetë, pothuajse gjithmonë gjendet dikush — një prind, një udhëheqës, një mësues — që do të sjellë një ndryshim duke ndërhyrë me dashuri e mirësi.

Jini një Shembull i Mirë për Fëmijët

Së katërti është shembulli. Po aq e vështirë sa është për një marinar të lodhur ta gjejë udhën përmes detërave të panjohur pa ndihmën e një busulle, është pothuajse po aq e pamundur që fëmijët dhe të rinjtë ta gjejnë udhën përmes detërave të jetës pa dritën udhërrëfyese të shembullit të mirë. Ne nuk mund të presim prej tyre që të shmangin ato gjëra që janë të papërshtatshme nëse ata i shikojnë prindërit e tyre të bien në kompromis mbi parimet dhe të dështojnë në të jetuarin e ungjillit.

Si prindër, mësues dhe udhëheqës, është detyra jonë solemne të japim një shembull të fuqishëm personal drejtësie, kurajoje, sakrifice, shërbimi vetmohues dhe vetëkontrolli. Këto janë karakteristikat që do ta ndihmojnë rininë tonë të kapet fort pas shufrës së hekurt të ungjillit dhe të qëndrojë në shtegun e ngushtë e të ngushtuar.

Të Jetuarit e Ungjillit Ndhimon në Shmangien e Gabimeve

Do të dëshiroja t'ju thoja se përqendrimi mbi informacionin, komunikimin, ndërhyrjen dhe shembullin do të rezultonte gjithmonë në një familje të përkryer me fëmijë të përkryer që nuk do të largohen asnjëherë nga standardet e ungjillit. Fatkeqësisht nuk është kështu. Por familjet që i njohin, mësojnë dhe jetojnë parimet dhe standardet e ungjillit ka më tepër mundësi t'ia kursejnë vetes dhembjen e gabimeve të rënda. Kur

modelet e vendosura për një kohë të gjatë të komunikimit pozitiv dhe shembullit besnik mbizotërojnë, është shumë më e lehtë të komunikojnë së bashku rreth problemeve personale dhe të bëjnë ndryshimet e nevojshme që do të bekojnë secilin anëtar të familjes.

Dëgjoni këshillën domethënëse të mbretit Beniamin:

“Dhe së fundi, unë nuk mund t’iu tregoj juve të gjitha gjërat që mund t’iu shtyjnë të bëni mëkat; pasi ka mënyra dhe mjete të ndryshme, madje aq shumë sa unë nuk mund t’i numëroj ato.

Por, kaq unë mund t’iu them, se në qoftë se ju nuk shikoni veten tuaj dhe mendimet tuaja dhe fjalët tuaja, dhe veprat tuaja dhe nuk respektoni urdhërimet e Perëndisë dhe nuk vazhdoni në besim për

çfarë ju keni dëgjuar në lidhje me ardhjen e Zotit tonë, madje deri në fund të jetës suaj, ju duhet të vdisni. Dhe tani, O njeri, mbaj mend dhe mos vdis” (Mosia 4:29-30).

Vëllezërit dhe motrat e mia, Perëndia e bekoftë secilin nga ne që ai zjarr i besëlidhjeve tona të mund të digjet në zemrat tona si një flakë e pashueshme. Qofshim të përgatitur shpirtërisht për të ripërtëritur besëlidhjet tona të shenjta çdo javë ndërsa marrim sakramentin. Lutem përlësisht që të nderojmë Zotin dhe të jemi të zellshëm të bëjmë pjesën tonë në këto ditë të mëdha e nga më të gëzuarat, për të ndërtuar Kishën e Tij duke forcuar familjet tona.

Nga një fjalim i Plakut Ballard në konferencën e përgjithshme të prillit 1999 (shih Conference Report, prill 1999, 111-15; ose *Ensign*, maj 1999, 85-87).

LUTJA FAMILJARE, STUDIMI FAMILJAR I SHKRIMEVE TË SHENJTA DHE MBRËMJA FAMILJARE

16

IDE PËR ZBATIM

Sipas nevojave dhe rrethanave, ndiqni njërin ose që të dy këto sugjerime.

- Në qoftë se familja juaj zhvillon rregullisht lutje familjare, studim familjar të shkrimeve të shenjta dhe mbrëmje familjare, me lutje mendoni se në ç'mënyrë mund të përmirësoheni në njërin prej këtyre. Nëse familja juaj nuk i bën këto gjëra, mendoni se çfarë do të bëni për të ndihmuar në zhvillimin e këtyre aktiviteteve në shtëpinë tuaj.
- Si një familje, planifikoni një aktivitet që mund të bëni së bashku.

DETYRA PËR LEXIM

Studioni artikujt e mëposhtëm. Nëse jeni të martuar, lexojini dhe diskutojini artikujt me bashkëshorten/ bashkëshortin tuaj.

BEKIMET E LUTJES FAMILJARE

Presidenti Gordon B. Hinkli
Këshilltar i Parë në Presidencinë e Parë

Apostulli Pal i shpalli Timoteut:

“Dhe dije këtë: në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira.

Sepse njerëzit do të jenë egoistë, lakmues parash, mburravecë, krenarë blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të paudhë.

Të padhembshur, të papajtuëshëm, shpifës, të papërmbytur, mizorë, që s'e duan të mirën,

Tradhtarë, kokëshkretë, fodullë, dëfrimdashës më fort se perëndidashës” (2 Timoteut 3:1-4).

Në kohën tonë duhet vënë një theks i ri mbi ndershmërinë, karakterin dhe integritetin. Vetëm nëse ndërtojmë në thelb të jetës sonë virtytet që janë qendra e qytetërimit të vërtetë atëherë do të ndryshojë edhe modeli i kohës sonë. Pyetja që ndeshim është “Nga t'ia fillojmë?”

Jam i bindur se duhet të fillojmë me njohjen e Perëndisë si Atin tonë të Përjetshëm, me marrëdhënien tonë me Të si fëmijët e Tij, me komunikimin me Të në njohje të pozitës së Tij sovranë dhe lutjen e vazhdueshme për udhëheqjen e Tij në punët tona.

Sugjeroj se një rikthim në modelin e vjetër të lutjes, lutjes familjare në shtëpitë e njerëzve, është një nga kurat më elementare që do të zmbarsnin sëmu-

ndjen e frikshme që po gërryen karakterin e shoqërisë sonë. Nuk mund të presim një mrekulli brenda ditës, por pasi të ketë kaluar një brez mrekullia mund të ndodhë.

Një ose dy breza më parë, lutja familjare në shtëpitë e të krishterëve në mbarë botën ishte po aq pjesë e atitvetit të përditshëm sa edhe e ngrëna. Ndërsa kjo praktikë po humbet, kalbja morale për të cilën flet Apostulli Pal ka filluar.

Jam i bindur se nuk ka asnjë zëvendësues të mjaftueshëm për praktikën e gjuhëzimit së bashku — babai, nëna dhe fëmijët çdo mëngjes e çdo mbrëmje. Kjo, më tepër se sexhadet e buta, më tepër se perdet e bukura, më tepër se kombinimi i ngjyrave, është ajo që do të sjellë shtëpi më të mira e më të bukura.

Ka diçka pikërisht në qëndrimin e gjuhëzimit që kontradikton qëndrimet e përshkruara nga Pali: “krenarë . . . kokëshkretë, fodullë.”

Ka diçka pikërisht në praktikën e gjuhëzimit së bashku të babait, nënës dhe fëmijëve që zbeh ato cilësi të cilat ai përshkroi: “ të pabindur ndaj prindërve; . . . të padhembshur.”

Ka diçka në aktin e të drejtuarit ndaj Hyjnisë që e kompenson prirjen drejt blasfemisë dhe drejt të bërit dëfrimdashës më fort se perëndidashës.

Prirja për të mos qenë i shenjtitë, ashtu siç Pali e shpjegoi atë, për të qenë mosmirënjohës, zhduket ndërsa anëtarët e familjes e falënderojnë Zotin për jetën, paqen dhe gjithçka që kanë. Dhe ndërsa ata

e falënderojnë Zotin për njëri-tjetrin, brenda familjes krijohet një vlerësim i ri, një respekt i ri, një dashuri e re për njëri-tjetrin.

Shkrimi i shenjtë shpall: “Ti do ta falënderosh Zotin Perëndinë tënd në të gjitha gjërat” (DeB 59:7). Dhe përsëri: “Dhe në asgjë nuk e fyen njeriu Perëndinë apo kundër askujt nuk ndizet zemërimi i tij, përveç atyre që nuk e pohojnë dorën e tij në gjithçka dhe nuk u binden urdhërimeve të tij” (DeB 59:21).

Kur kujtohen së bashku para Zotit, të varfërit, nevojtarët dhe të munduarit, krijohet pa vetëdije, por në mënyrë reale, një dashuri për të tjerët përtej vetes, një respekt për të tjerët, një dëshirë për t’u shërbyer nevojave të të tjerëve. Ne nuk mund t’i lutemi Perëndisë për ta ndihmuar një person në nevojë pa qenë të motivuar të bëjmë diçka vetë për ta ndihmuar atë person. Ç’mrekulli do të ndodhnin në jetën e fëmijëve të botës nëse ata do ta linin mënjane egoizmin e tyre dhe do ta humbisnin veten në shërbimin ndaj të tjerëve. Fara nga mund të rritet kjo pemë e mbrojtur dhe e frytshme mbillet dhe ushqehet më mirë në lutjet e përditshme të familjes.

Nuk njoh asnjë mënyrë më të mirë për të rrënjësuar dashurinë për atdheun sesa kur prindërit luten para fëmijëve të tyre për tokën në të cilën jetojnë, duke kërkuar bekimet e të Plotfuqishmit mbi të që të mund të ruhet në liri e paqe. Nuk njoh asnjë mënyrë më të mirë për të ndërtuar brenda zemrave të fëmijëve tanë respektin aq të nevojshëm ndaj autoritetit se sa kur në lutjet e përditshme familjare kujtohen udhëheqësit e vendeve tona përkatëse që mbajnë barrën e qeverisjes.

Më kujtohet një shprehje që pashë në një tabelë “Një komb që lutet është një komb në paqe.” Unë e besoj këtë.

Nuk di se çfarë tjetër mund të ndihmojë më shumë në lehtësimin e tensioneve familjare, që në një mënyrë të fshehur do të sjellë respektin për prindërit duke çuar kështu drejt bindjes, që do të prekë shpirtin e pendimit i cili do ta fshijë në një masë të madhe plagën e shtëpive të shkatërruara, sesa lutja e përbashkët, rrëfimi i dobësive së bashku para Zotit dhe të kërkuarit e bekimeve të Zotit mbi shtëpinë dhe ata që banojnë aty.

Ka kohë që më ka lënë mbresa të pashlyeshme një deklaratë e bërë nga dikush që ka kohë që ka vdekur. Xheims H. Moili i shkroi nipërve e mbesave të tij në lidhje me lutjen familjare në shtëpinë e tij. Ai tha: “Ne nuk binim të flinim para se të gjunjëzoheshim në lutje për të kërkuar udhëheqjen dhe miratimin hyjnor. Mosmarrëveshje mund të lindin edhe në familjet e qeverisura mirë, por ato do të davariten nga . . . shpirti i lutjes . . . Vetë psikologjia e saj

prirët të nxisë jetesën më të drejtë midis njerëzve. Ajo prirët drejt unitetit, dashurisë, faljes dhe shërbimit.”

Në vitin 1872, Koloneli Tomas L. Kein, miku i madh i njerëzve tanë në ditën e vuajtjeve të tyre në Ajua dhe në kohën e ardhjes së ushtrisë në Luginën e Sollt Leikut, u kthye përsëri në përditshme me bashkëshorten dhe dy djemtë e tij. Ata udhëtuan për në St. Xhorxh me Brigam Jangun, duke ndaluar çdo natë në shtëpitë e anëtarëve të Kishës gjatë rrugës. Znj. Kein i shkroi një varg letrash të atit që ndodhej në Filadelfia. Në njërën prej tyre ajo tha:

“Në çdo vend ku kemi qëndruar gjatë këtij udhëtimi kemi pasur lutje menjëherë pas darke dhe lutje përsëri para mëngjesit. Të gjithë ishin aty . . . Mormonët . . . gjunjëzohen në të njëjtën kohë, ndërkohë që kreu i shtëpisë, ose një mik i nderuar lutet me zë të lartë . . . Ata nuk ndalen shumë në lavde, por kërkojnë atë që u duhet dhe e falënderojnë Atë për atë që u ka dhënë . . . [Ata] e pranojnë si të mirfilltë faktin që Perëndia i di emrat dhe titujt tanë familjarë dhe kërkojnë një bekim mbi [një individ të caktuar me emër], . . . Pasi u mësova, kjo filloi të më pëlqente.”

Oh, uroj që ne si popull të mund të kultivojmë plotësisht këtë praktikë, që ishte aq e rëndësishme për paraardhësit tanë pionierë. Lutja familjare ishte po aq pjesë e adhurimit të tyre sa ishin edhe mbledhjet e zhvilluara në Tabernakull. Me besimin që vjen nga ato lutje të përditshme, ata shkulën ferrat, i drejtuan ujrat drejt tokës së tharë dhe e bënë shkretëtirën të lulëzojë si trëndafili, i drejtuan familjet e tyre me dashuri, jetuan në paqe me njëri-tjetrin dhe i bënë emrat e tyre të pavdekshëm, ndërsa e humbën veten në shërbim ndaj Perëndisë.

Familja është njësisht bazë e shoqërisë. Një familje që lutet është shpresa për një shoqëri më të mirë. “Kërkoni Zotin ndërsa mund të gjendet, e thirrni ndërsa është afër” (Isaia 55:6).

A mund t’i bëjmë shtëpitë tona më të bukura? Po, duke iu drejtuar si familje Burimit të gjithë bukurisë së vërtetë. A mund ta forcojmë shoqërinë dhe ta bëjmë atë një vend më të mirë për të jetuar? Po, duke forcuar virtytin e jetës sonë familjare duke u gjunjëzuar së bashku dhe duke iu lutur të Plotfuqishmit në emrin e Birit të Tij të Dashur.

Kjo praktikë, rikthimi në adhurimin familjar, duke u shpërndarë në mbarë vendin e në mbarë tokën, pas një brezi do të ketë lehtësuar plagën që po na shkatërron. Do të rivendosë integritetin, respektin reciprok dhe shpirtin e mirënjohjes në zemrat e njerëzve.

Mësuesi shpalli: “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet” (Mateu 7:7).

Unë ju dëshmoj se nëse e zbatoni sinqerisht lutjen familjare, nuk do të liheni pa u shpërblyer.

Ndryshimet mund të mos jenë të dukshme menjëherë. Ato mund të jenë tepër të fshehura. Por do të jenë të vërteta, sepse Perëndia “është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë” (Hebrenjve 11:6).

Uroj që të jemi besnikë në dhënien e një shembulli para botës për këtë praktikë dhe të nxisim të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.

Nga *Ensign*, shkurt 1991, faqe 2-5.

“SI REZULTAT U MËSOVA”

Elder L. Tom Peri
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Prindër të Mirë

Libri i Mormonit fillon me këto fjalë: “UNË, Nefi, duke qenë i lindur nga prindër të mirë, si rezultat u mësova disi në të gjithë diturinë e atit tim” (1 Nefi 1:1). Sa ndryshe do të ishte kjo botë nëse ditarët personalë të secilit prej fëmijëve të Atit tonë në Qiell mund të fillonin me një frazë të tillë — duke pasur prindër të mirë dhe duke u mësuar prej tyre.

Ne jetojmë në një kohë tepër të veçantë të historisë, një kohë kur ungjilli i Zotit është rivendosur në plotësinë e tij. Si kurrë më parë forcat tona misionare po rriten si në cilisi ashtu edhe në sasi, kështu ungjilli po u mësohet më tepër kombeve në më tepër gjuhë si dhe një numri edhe më të madh të atyre që janë gati për të dëgjuar. Ndërsa lagjet dhe kunjat po krijohen në shumë pjesë të botës, mendjet krijuese janë frymëzuar të zhvillojnë mjete komunikimi që mundësojnë sjelljen e udhëzimeve të profetëve në veshët e shumë e më shumë njerëzve. Lajmi i mirë i ungjillit tani mund të përhapet më shpejt për t’u sjellë paqe të përjetshme zemrave të njerëzimit.

Jeta Familjare në Krizë

Një nga mesazhet e mëdha të ungjillit është doktrina e natyrës së përjetshme të njësisë familjare. Ne i shpallim botës vlerën dhe rëndësinë e jetës familjare, por shumë nga pështjellimi dhe vështirësitë që ekzistojnë sot në botë zënë fill me shkatërrimin e familjes. Përvojat e shtëpive ku fëmijët mësohen dhe edukohen nga prindër të dashur po vijë duke u pakësuar.

Jeta familjare ku fëmijët dhe prindërit komunikojnë së bashku në studim, lojë e punë është zëvendësuar me një darkë të shpejtë të gatuar në mikrovalë dhe një pasdite para televizorit. Në vitin 1991 Shoqata Kombëtare e Konteve, që u mbledh në Sollt Leik Siti, shprehu mendimin se mungesa e ndikimit të shtëpisë ka arritur një pikë të tillë sa të bëhet alarmante në

kombin tonë dhe ata diskutuan në mbledhjet e tyre për këto shqetësime. Ata identifikuan pesë koncepte bazë që mund të rrisnin mundësitë e çdo familjeje për sukses.

Së pari, forconi marrëdhëniet nëpërmjet aktiviteteve familjare; së dyti vendosni rregulla dhe kërkesa të arsyeshme; së treti, ndërtoni vetë-respektin; së katërti, caktoni qëllime të arritshme; dhe së pesti, herë pas herë vlerësoni pikat e forta dhe nevojat e familjes.

Papritur zëri i ngutshëm dhe paralajmërues i profetëve tanë që nga fillimi i kohës po fiton një vëmendje të veçantë. Ashtu siç jemi këshilluar dhe inkurajuar, ne duhet të jemi të vëmendshëm ndaj familjeve tona dhe t’i përshpejtojmë përpjekjet për t’i sjellë të tjerët në njohurinë e së vërtetës dhe rëndësisë së njësisë familjare.

Adami dhe Eva Mësojnë Detyrat Prindërore

Që nga fillimi, udhëzimet që Zoti i dha Adamit dhe Evës e bënë të qartë përgjegjësinë e tyre si prindër. Rolet e tyre ishin të përcaktuara mirë. Pasi kishin marrë udhëzime nga Zoti, i gjejmë duke ndjekur këshillën e Tij dhe duke thënë këtë:

“Dhe në atë ditë Adami e bekoj Perëndinë dhe u mbush me Frymën e Shenjtë dhe filloi të profetizonte lidhur me tërë familjet e tokës, duke thënë: Bekuar qoftë emri i Perëndisë, sepse për shkak të shkeljes si me sytë e mi u hapën dhe në këtë jetë unë do të kem gëzim e përsëri në mish do ta shoh Perëndinë.

Dhe Eva, gruaja e tij, i dëgjoi të gjitha këto gjëra dhe u gëzua, duke thënë: Po të mos ishte për shkeljen tonë, ne kurrë nuk do të kishim patur farë dhe kurrë nuk do të kishim njohur të mirën dhe të keqen, dhe gëzimin e shëlbimit tonë, dhe jetën e përjetshme që Perëndia ua jep gjithë të bindurve.

Dhe Adami e Eva e bekuan emrin e Perëndisë dhe ua bënë të gjitha gjërat të njohura bijve dhe bijave të tyre” (Moisiu 5:10-12).

Mësoni dhe Edukoni Fëmijët

Po, që nga fillimi përgjegjësia e prindërve për të mësuar fëmijët e tyre ishte midis udhëzimeve që Zoti u dha prindërve tanë të parë tokësorë.

Zbulesat që u dhanë pasi Kisha u rivendos në këtë kohë përsëri i paralajmërojnë prindërit për detyrimin që kanë për të mësuar dhe edukuar fëmijët e tyre. Në seksionin e nëntëdhjetë e tretë të Doktrina e Besëlidhje, e gjejmë Zotin duke qortuar disa nga vëllezërit, për shkak se nuk i kishin kushtuar vëmendje përgjegjësive të tyre familjare. Shkrimi i shenjtë thotë:

“Por unë ju kam urdhëruar t’i rrisni fëmijët tuaj në dritë e të vërtetë . . .

Ti nuk i ke mësuar fëmijët e tu në dritë e të vërtetë, sipas urdhërimeve; dhe ai i ligu ka fuqi tashmë mbi ty dhe ky është shkak i mjerimit tënd.

Dhe tani një urdhërim të jap — në qoftë se dëshiron të çlirohesh, ti duhet të vendosësh në rregull shtëpinë tënde, sepse ka shumë gjëra që nuk janë siç duhet në shtëpinë tënde” (DeB 93:40, 42-43).

Rëndësia e Mbrëmjes Familjare

Disa vite më parë Kisha i këshilloi të gjithë prindërit të zhvillonin mbrëmje të përjavshme familjare. Sot ajo këshillë ka gjetur zbatim në shtëpitë e anëtarëve të Kishës. Pasditja e së hënës është caktuar si një pasdite që familjet të jenë së bashku. Asnjë aktivitet Kishe ose takime shoqërore nuk duhen organizuar këtë pasdite. Na janë premtuar bekime të mëdha nëse familjet tona do të jenë besnike në këtë drejtim.

Presidenti Harold B. Li një herë na këshilloi:

“Tani mbani mend këtë; se kur të kuptohet masa e plotë e misionit të Elias, zemrat e fëmijëve do t’u kthehen etërve dhe zemrat e etërve do t’u kthehen fëmijëve. Kjo gjen zbatim po aq shumë në këtë anë të velit sa edhe në anën tjetër. Nëse i lëmë pas dore familjet tona këtu duke mos pasur mbrëmje familjare dhe nuk e përmbushim përgjegjësinë tonë këtu, si do të duket qielli nëse humbasim disa prej tyre për shkak të shpërfilljes sonë? Qielli nuk do të jetë qiell derisa ne të kemi bërë çdo gjë që mundemi për të shpëtuar ata që Zoti ka dërguar nëpërmjet preardhjes sonë.”

Më pas ai vazhdoi:

“Kështu zemrat tuaja baballarë e nëna duhet të kthehen drejt fëmijëve tuaj duke filluar që tani, nëse ju keni shpirtin e vërtetë të Elias, duke mos menduar se ai i përket vetëm atyre që janë përtej velit. Le të kthehen zemrat tuaja ndaj fëmijëve tuaj dhe mësojini ata, por këtë duhet ta bëni ndërsa janë ende të rinj për t’u edukuar siç duhet. Dhe nëse po e lini pas

dore mbrëmjen familjare, po lini pas dore fillimin e misionit të Elias po aq sa po lini pas dore punën tuaj gjenealogjike” (në *Relief Society Courses of Study, 1977-78* [1977], 2; germat kursive janë shtuar).

Kam menduar shpesh për kohët e bukura që kaluan kur familja jonë ishte ende e re dhe fëmijët ishin në shtëpi. Kam bërë një rishikim mendor të atyre ditëve dhe kam menduar për ndryshimet që do të bëja në organizimin dhe drejtimin e familjes sonë po të kisha mundësinë ta jetoja përsëri atë periudhë. Do të vendosja të përmirësoja dy aspekte po të më jepej privilegji për t’i pasur fëmijët tanë të vegjël ende në shtëpi.

Së pari, do të doja të kalonim më tepër kohë si burrë e grua në një mbledhje të komitetit ekzekutiv familjar, për të mësuar, komunikuar, planifikuar dhe për t’u organizuar me qëllim që të përmbushim më mirë rolet tona si prindër.

Dëshira e dytë që do të doja, po t’i ktheja ato vite, do të ishte të kaloja më tepër kohë me familjen. Kjo përfshin më tepër mbrëmje familjare të vazhdueshme e kuptimplota.

Rinia Kontribuon në Sukses

Bara e plotë e planifikimit dhe përgatitjes për mbrëmjen familjare nuk duhet t’u lihet vetëm prindërve. Mbrëmjet më të suksesshme që kam parë janë ato kur të rinjtë e familjes marrin pjesë aktive në të.

Unë ju bëj thirrje ju dhjakëve, mësuesve dhe priftërinjve, vajzave të Koshereve, Mía Maid dhe Dafinave që të jepni një kontribut të madh në suksesin e mbrëmjes tuaj familjare. Në shumë shtëpi ju mund të jeni ndërgjegjia e familjes. Në fund të fundit ju jeni ata që do të përfitoni më tepër nga kjo përvojë. Nëse doni të jetoni në një botë paqeje, sigurie dhe mundësisht, familja ku ju kontribuoni, mund t’i shtojë mirëqenies, po, madje mirëqenies së mbarë botës.

Më kujtohet një shembull i kësaj që ndodhi një vit gjatë pushimeve të Krishtlindjes kur kishim nipërit e mbesat tona në një ekskursion me ne. Me qëllim që të kishim një përvojë të vërtetë afërsie me njëri-tjetrin, kishim marrë një furgon që të udhëtonim së bashku. Në furgon ishte gjyshi dhe gjyshja, im bir dhe tre fëmijët e tij më të mëdhej. Bashkëshortja e tij kishte qëndruar në shtëpi me anëtarët më të vegjël të familjes. Unë kisha zënë vendin në timon ndërsa ime shoqe që ishte ulur pranë meje ishte udhërrëfyesja jonë. Nga fundi i furgonit, dëgjova Audrin, fëmijën më të madh, të këshillohej me të atin. Ajo po thoshte: “Babi, një nga qëllimet tona këtë vit ishte të mbaronim Librin e Mormonit në studimin familjar. Kjo është dita e fundit e vitit. Pse të mos e mbarojmë tani që të jemi brenda planit?”

Ç'përvojë e veçantë ishte të dëgjoja tim bir dhe tre fëmijët e tij, që me rradhë lexuan me zë të lartë kapitujt e fundit të Moronit duke përfunduar kë-shtu qëllimin e tyre për të lexuar të gjithë Librin e Mormonit. Mbani mend se ky sugjerim erdhi nga një e re, jo nga prindërit.

Sfidë Rinisë

Ju jeni një brez i zgjedhur që është ruajtur për këtë kohë të veçantë në historinë e njerëzimit. Ju keni kaq shumë për të dhënë për të shtuar rritje dhe zhvillimin e familjeve ku bëni pjesë. Unë ju nxis të merrni stafetën në familjet tuaja me atë shpirt të veçantë entuziast të rinisë për ta bërë ungjillin të jetojë me të vërtetë në shtëpitë tuaja. Kujtoni këshillën e Presidentit Jozef F. Smith kur tha:

“Do të doja që fëmijët e mi dhe të gjithë fëmijët në Sion, të dinin se nuk ka asgjë në këtë botë që ka më tepër vlerë për ta sa njohuria për Ungjillin e rivendosur në tokë në këto ditë të fundit nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Asgjë nuk mund ta konpensojë humbjen e tij. Nuk ka asgjë në tokë që mund të krahasohet me përsosmërinë e njohurisë për Jezu Krishtin. Për këtë arsye, të gjithë prindërit në Sion le të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'u mësojnë atyre parimet e Ungjillit dhe të përpiqen me aq sa munden t'i shtyjnë të bëjnë detyrën e tyre — jo në mënyrë mekanike, sepse nxiten për ta bërë, por të përpiqen të rrënjosin në zemrën e fëmijëve të tyre shpirtin e së vërtetës dhe një dashuri të palëkundur për Ungjillin, që ata jo vetëm të bëjnë detyrën e tyre, sepse kjo i kënaq prindërit, por sepse i kënaq dhe ata vetë” (në Brian H. Stuy, comp., *Collected Discourses Delivered by President Wilford Woodruff, His Two Counselors, the Twelve Apostles, and Others*, 5 vols. [1987-92], 5:436).

Rigjallëroni Mbrëmjen Familjare

Mbrëmjet familjare janë për të gjithë, qoftë në një shtëpi me dy prindër, një shtëpi me një prind, ose në një familje që ka vetëm një anëtar. Mësues të shtëpisë, ne ju bëjmë thirrje që në vizitat tuaja të zakonshme të nxisni dhe të rigjallëroni zhvillimin e mbrëmjeve familjare.

Profeti ynë i tanishëm, Presidenti Ezra Taft Benson, na ka kujtuar përsëri nevojën për të zhvilluar mbrëmje familjare dhe elementët që përbëjnë një mbrëmje të suksesshme. Ai ka thënë:

“I hartuar për të forcuar dhe mbrojtur familjen, programi i Kishës për mbrëmjen familjare vendos që një pasdite çdo javë të caktohet që baballarët dhe nënat të mbledhin bijtë e bijat rreth tyre në shtëpi. Aty ofrohen lutje, këndohen himne dhe këngë të tjera, lexohen shkrimet të shenjta, diskutohen çështje familjare, shfaqen talentet, mësohen parimet e ungjillit dhe shpesh luhen lojra dhe shërbehen ushqime të përgatitura në shtëpi” (në Conference Report, Philippine Islands Area Conference 1975, 10)

Shpresojmë që secili nga ju t'i mbajë shënim secilin nga këto sugjerime që na jep profeti në lidhje me atë se çfarë duhet të përmbajë një mbrëmje familjare.

Më pas ai vazhdon: “Këto janë bekimet e premtuara nga një profet i Perëndisë për ata që zhvillojnë mbrëmje familjare çdo javë: ‘Nëse Shenjtorët i binden kësaj këshille, ne premtojmë se bekime të mëdha do t'u vijjnë. Dashuria në shtëpi dhe bindja ndaj prindërve do të rritet. Besimi do të zhvillohet në zemrat e rinisë së Izraelit dhe ata do të fitojnë fuqi për të luftuar ndikimet e liga dhe tundimet që i rrethojnë’” (në Conference Report, Philippine Islands Area Conference 1975, 10; shih gjithashtu *Improvement Era*, qershor 1915, 734)

Ne e nxisim secilin prej jush të ndjekë këshillën e profetit tonë. Në të gjitha njësitë familjare në mbarë Kishën, vlerësoni edhe një herë përparimin që po bëni në zhvillimin e rregullt të mbrëmjeve familjare. Zbatim i këtij programi do të jetë një mburojë dhe një mbrojtje për ju kundër të ligave të kohës sonë dhe do t'ju sjellë, individualisht dhe kolektivisht, një gëzim më të madh dhe më të begatë tani dhe në përjetësi.

Perëndia na bekoftë që të mund ta rigjallërojmë dhe forcojmë këtë program jashtëzakonisht të rëndësishëm, ndërsa këshillohemi së bashku si familje.

Nga një fjalim i Plakut Peri në konferencën e përgjithshme të prillit 1994 (shih Conference Report, prill 1994, 47-51; ose *Ensign*, maj 1994, 36-38)

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

ALBANIAN



4 02363 57101 0

36357 101